

Policimi në një shoqëri demokratike

Arqile Kosta 2002

Rruga që ka përshkuar njeriu në përpjekjet për të gjetur mënyrat më efikase të mbrojtjes së vetes dhe të pronës, përbën një nga momentet më interesante dhe impresionuese të historisë. Qysh nga kohët më të lashta faraonike, gjer në ditët e sotme, pavarisht si janë quajtur dhe mënyrat e veprimit të tyre, janë dashur gjithmonë grupe njerëzish, që të merren me kontrollin e zbatimit të normave dhe ligjeve të shoqërisë. Gjurmë të këtyre përpjekjeve gjenden në çdo shoqëri të organizuar, në sistemet e tyre të rregullave, normave, ligjeve e zakoneve, që synojnë mbrojtjen e rendit dhe qetësisë. Diku të organizuara si forca speciale të ushtrive, diku si grupe vullnetarësh dhe diku si organizime formale civile, njerëzit që kanë kryer këto detyra, kanë dhënë kontributin dhe gjakun e tyre në themelet e profesionit të policit.

1. Modelet dhe faktorët e zhvillimit të policimit.

Egzistojnë dy pikëpamje rreth mënyrës si policimi u shëndrua, nga një reagim spontan i individëve, grupeve dhe komuniteteve shoqërore ndaj frikës dhe kërcënimit që ndjenin nga krimi e nga çrregullimi, në një reagim të organizuar dhe institucional.

Pikëpamja e parë si zhvillim:

- **Policimi informal:** çdo anëtar i grupit social mban përgjegjësi sociale për të realizuar funksione kontrollit social.
- **Policimi tranzitor:** një përzjerje e modelit spontan me atë të organizuar.
- **Policimi i organizuar:** individë të veçantë ngarkohen me përgjegjësitë e policimit, si profesion primar i tyre.

Pikëpamja e dytë si zhvendosje:

- **Policim vullnetar:** përmbushje e funksioneve policore nga individë, të cilët nuk e kanë policimin profesion të parë.
- **Policim profesionist:** qytetarët pajtohen me pagesë të ushtrojnë funksionet policore. Ai ngjan policimin formal, sepse realizohet nga individë që kanë si profesion të parë punën e policit. (ndarja dhe diferencimi i punës)

Dy pikëpamjet, përveç dallimeve, tregojnë një nga zhvendosjet më të rëndësishme në evolucionin e policisë drejt konsolidimit të policimit si profesion dhe si shërbim publik.

Në momente të veçanta të historisë, në përputhje me kushtet social-historike, kulturore, ekonomike e politike, çdo shoqëri krijon lloje e forma të veçanta të punës policore. Secila nga këto forma, nga ana e vet zhvillohet pjesërisht, edhe si një zgjerim i specializimit të përgjithshëm të funksioneve sociale. Kjo do të thotë se një shoqëri, ashtu siç përpunon e ngre institucione apo organizata të veçanta për ekonominë, fenë, shëndetin, edukimin etj., po ashtu përpunon e ngre edhe institucionet e organizatat e saj të kontrollit social.

Krijimi i profesionit të policit imponon marrjen në konsideratë të faktit, se problemet e krimit dhe të rendit social nuk mund të zgjidhen me reagime episodike. Për të pasur një kontroll të përhershëm mbi krimin dhe një rend social të qëndrueshëm, nevojitet një profesion i veçantë dhe i specializuar policor, që ofron shërbime me kohë të plotë në kontrollin e zbatimit të rregullave dhe ligjeve të shoqërisë.

Policimi institucional, përfaqëson një transformim domethënës në marrëdhëniet shoqërore. Policimet informale dhe tranzitorë janë kryesisht vullnetarë e jetëshkurtër. Grupet e vullnetarëve, që thirren për të kryer detyra policimi, formohen si reagim ndaj problemeve që kishte rendi social, merren me to dhe, me t'i zgjidhur, shpërndahen. Pjestarët e kësaj "policie" shërbejnë vullnetarisht e në përgjithësi gjenden jashtë kontrollit të ligjit.

o Organizimi social dhe policimi

Tipi i policimit pasqyron drejtpërdrejt tipin e organizimit të shoqërisë. Shoqëritë janë organizuar dhe kanë funksionuar në dy mënyra kryesore: ose kanë qënë mekanistike, tradicionale, ose organike, të industrializuara. Sidoqë, në historinë e shoqërisë vrehen periudha, kur ajo kalon nga një formë organizimi në një tjetër, ose të ashtuquajturat "shoqëritë në tranzicion", ato nuk përbëjnë një model organizimi, por një gjëndje kalimtare, të shoqëruar me një sërë problemesh dhe krizash të modelit, të

cilat duhen kapërxyer, për të arritur organizimin dhe funksionimin sipas modelit të ri. Shoqëria e sotme shqiptare është shëmbull i një shoqërie në tranzicion, pasi ndodhet në “*gjëndjen sociale*” të zgjidhjes së problemeve dhe të krizave të kalimit nga modeli i mëparshëm diktatorial (*që nuk mundi të dalë nga caqet e një organizimi mekanistik tradicional, pasi u bazua tek vlerat, besimet dhe qëndrimet ideologjike e jo tek organizimi racionalo-ligjor*). Për këtë arsye, shoqëria e sotme shqiptare nuk përfshihet në asnjë nga modelet e organizimit social, jo si përjashtim, por sepse ndodhet në gjendjen e kërkimit të rrugëve dhe mjeteve për tu zhvendosur nga shoqëria mekanistike në atë organike:

- ⇒ *Mekanistik* ose tradicional është organizimi, në të cilin pjestarët e shoqërisë kanë të njëjtën kulturë shpirtërore dhe ndajnë me njeri tjetrin të njëjtat vlera, besime dhe qëndrime. Shoqëritë tradicionale janë homogjene nga pikpamja kulturore dhe kanë aftësi për të arritur konsensus për veprimet kolektive që i nevojiten. Ky tip organizimi rrjedh nga bashkësia e interesave që formon “*vetëdijen kolektive*”, dhe qeverisen nga normat e moralit dhe nga e drejta zakonore.
- ⇒ *Organik* është organizimi në të cilin antarët e shoqërisë ndërveprojnë për shkak se detyrat e shoqërisë janë të specializuara e të veçanta. Shoqëri të tilla në mënyrë tipike janë shoqëritë e industrializuara dhe ato që kanë marrëdhënie të ngushta me to. Në një shoqëri të tillë gjithmonë ndjehet pamjaftueshmëri që të gjithë të kryejnë të gjitha detyrat që dalin dhe roli ndikues i vetdijes kolektive nuk është aq i madh sa të mjaftojë për të mbajtur me vullnet një rend social të pranueshëm nga i gjithë komuniteti.

Ndryshimi kryesor midis organizimit mekanistik dhe atij organik të shoqërisë qëndron tek ndarja e punës, tek specializimi dhe diferencimi social. Në një organizim mekanistik individët janë të pavarur e për këtë arsye “*vetëdija kolektive*” përbën bazën e identitetit të grupit. Në një organizim organik ndërvartësia e individëve nga njeri tjetri për plotësimin e nevojave jetike, bëhet themeli mbi të cilin formohet kohezioni social.

Shoqëritë mekanistike, konsiderohen primitive, të pazhvilluara e preindustriale. Në grupe të tilla, individët nuk varen nga njeri tjetri për plotësimin e nevojave jetike, sepse secili i arrin brenda ekonomisë të fermës individuale, të gjahut, grumbullimit e tregëtisë familjare. Ajo që i bën këta individë të pamvarur të formojnë një shoqëri është eksperiencia dhe besimet e përbashkëta mbi natyrën, njeriun, jetën e të mbinatyrshmen. Kontrolli social dhe instrumentat e tij, ndërtohen e përdoren për t’i mbrojtur këto besime. Për këtë shkak për këto shoqëri ka pëk dallim nëse individët çenojnë normat tabu të kulturës morale, besimet fetare apo janë keqsjellje të atilla, që historikisht janë konsideruar krime.

Nga ana tjetër shoqëritë organike konsiderohen të zhvilluara, të progresiste e industriale. Në to, njerëzit merren me detyra të veçanta e të dallueshme. Dikush kultivon tokën, dikush ndërton ndërtesa, dikush makina, dikush tregëton mallra e dikush tjetër kryen detyra të shërbimit publik. Kjo i bën individët të kenë eksperiencia e besime të ndryshme, por nga ana tjetër çdokush ka nevojë për të tjerët në plotësimin e nevojave jetike. Kontrolli social dhe instrumentat e tij përdoren për të garantuar që këto marrëdhënie të jenë të parashikueshme, të rregulluara dhe të sigurta. Megjithëse ka përputhje për një numur sjelljesh, përsëri egzistojnë dallime në kuptimet që i jepen shkëljes së normave të moralit shoqëror dhe sjelljeve që konsiderohen krim dhe që trajtohen gjithnjë e më shumë si keqsjellje ligjore. Për më tepër kontrolli social fillon të aplikohet në mënyra të diferencuara për grupe të ndryshme sociale, duke u bërë gjithnjë më kompleks dhe i specializuar.

Një shoqëri e organizuar sipas modelit organik në mënyrë të natyrshme kërkon një organizim policor të specializuar, zyrtar e profesionist, që i nevojitet për të garantuar rendin dhe sigurinë e qytetarëve. Për ta arritur një synim të tillë cakton e trainon njerëz të posaçëm për këtë rol dhe përpunon një proces të ndarjes së punës në sektorët e tjerë të funksioneve sociale, që i përshtat si kontroll social.

Nëse historia e shoqërisë kuptohet si një lëvizje e përgjithëshme drejt rritjes së kompleksitetit dhe ndarjes së punës, ndërtimi i policimit formal dhe profesionist mund të shpjegohet vetëm si pjesë përbërëse e këtij procesi. Policia dhe legjisllacioni formal si një e tërë, zhvillohen në përgjigje të ndryshimeve ekonomike të shoqërisë. Sa më tepër domethënie të industrializuar e të specializuar të

ketë prodhimi dhe sa më tepër të kufizohen burimet e prodhimit në shoqëri, aq më tepër ka të ngjarë të gjejmë ligje formale dhe një polici profesioniste.

○ **Ndikimi i përfytyrimit publik mbi krimin dhe çregullimin**

Faktor i rëndësishëm për të kuptuar evolucionin e policisë në shoqëri është niveli real dhe përfytyrimi që krijon publiku mbi krimin. Ky faktor lidhet direkt me interesat sociale, sepse është interpretimi që i bën shoqëria problemit të krimit, si tregues i nivelit të normalitetit, përtej të cilit mungesa e rregullit dhe krimi bëhen të patolerueshëm dhe për këtë arsye shoqëria ndërton, financon e nxit reformimin profesional të policisë.

Ndërtimi i një policimi profesionist dhe mbajtja e policisë, nuk ndodhin ngaqë qytetarët perceptojnë kërcënime reale nga çrregullimi eventual i rendit social dhe krimi, por për shkak të frikës që kanë prej pasojave të mundëshme. Në përgjigje të kësaj nevojë sociale, Policisë i kërkohet dhe i bëhen presione të reagojë e ndërhyjë që në perceptimet e para të prishjes së mundëshme të rendit, për të rikthyer nivelin normal të *status quosë* sociale. Kur shoqëria dhe strukturat e saj janë të interesuara të ndodhin ndryshime sociale, politike dhe ekonomike, jo vetëm nuk reagon, por i lejon ngjarjet të rrjedhin në drejtimin e tyre, duke marrë masa që situatat të mos dalin jashtë kontrollit. Edhe veprimtaria e policisë, qëndron brenda këtyre kufijve. Shkaqet më të thella sociale të qëndrimeve të tilla, shpjegohen nëse mbajmë parasysh rolin e dyfishtë të shkeljes së normës prej individëve dhe grupeve shoqërore

Tepërimi i pasionit, qoftë edhe në mbrojtjen legjitime, bëhet shkas për emigrimin e “së drejtës” tek kundërshtari yt, i cili, duke u përgjigjur me të njëjtën mënyrë, bëhet shkas për breznitë të tëra krimesh që shoqërojnë breznitë njëzore. ... kjo është një këmbanë alarmi për t’i paralajmëruar njerëzit se çdo shkelje e “së drejtës” do të kërkojë përherë shpagimin e saj.

Ismail Kadare “Eskili, ky humbës i madh”

Sado paradoksale të duket, sot pranohet që shmangia nga normat, përfshirë edhe krimin, nuk është vetëm një dukuri negative që duhet eliminuar nga jeta sociale apo një problem që duhet zgjidhur. Ajo gjithashtu është funksionale përsa i përket kontributit që sjell në rendin social. Këto efekte mund të shfrytëzohen në mënyrë të dobishme, nëse njihen funksionet e saj kryesore:

1. *Shmangia dhe një nivel i caktuar kriminaliteti qartësojnë caqet morale dhe afirmojnë normat ligjore të shoqërisë.* Idetë e një shoqërie rreth asaj se si duhet të sillen, veprojnë dhe mendojnë pjestarët, përbëjnë kufijtë moralë dhe ligjorë të saj. Veprimi shmangës apo kriminal, i sfidon këto caqe dhe duke i kërkuar atij të mbajë përgjegjësi për veprimet e kryera dhe për dëmet e shkaktuara, ne afirmojmë normat e shoqërisë duke bërë dallim të qartë midis *konformitetit e sjelljes shmangëse*.
2. *Shmangia nxit unitetin social.* Afirmimi i caqeve moralë të shoqërisë duke reaguuar ndaj devijancës e krimit zhvillon më tej ndjenjën e bashkësisë sociale midis pjestarëve të shoqërisë.
3. *Shmangia dhe krimi nxitin ndryshimin social.* Grupet sociale jo gjithmonë mund të jenë dakord me atë se si detyrohen të sillen e veprojnë brenda mënyrave të pranuar të sjelljes, duke përkrahur e nxitur një këndvështrim të ri të pranueshëm. Kjo sjellje çënon kufijtë morale egzistuesë e bëhet nxitje që grupi i tërë apo shoqëria të rishikojë dhe të ripërcaktojë kufijtë morale dhe mënyrat e saj zakonore apo ligjore të rregullimit të mardhënieve.

Ky argument tregon se një nivel i caktuar i krimit dhe çrregullimit në shoqëri, janë vlerësuar gjithmonë si të natyrëshme, të pashmangëshme e bashkëudhëtare të qytetërimit dhe për këtë arsye kanë qënë e do të jenë, krahas reagimit të institucionalizuar e të orgnizuar nga policia, është edhe objekt i formave episodike të policimit që bëjnë vetë qytetarët. Sa kohë që çrregullimi dhe krimi qëndrojnë të çorganizuar e sporadikë, nuk ndjehet nevoja e policimit formal profesionist. Kur këto fenomene bëhen problematikë në frekuencë dhe seriozitet; kur ato rrezikojnë realizimin e funksioneve sociale, lind nevoja për një reagim policor formal.

Niveli i çrregullimit e krimit, nëse i referohemi funksionit të tretë të devijancës, ndërsa sfidon caqet moralë egzistuesë, duke nxitur për ndryshime social-politike, vë në pikpyetje edhe pushtetet e elitës

sociale. Kjo gjëndje kontradiktore zgjidhet në drejtimin e duhur të ndryshimit vetëm kur elita, në vënd të forcojë dhe të riorganizojë format e policimit për të mbajtur nën kontroll “klasat e rrezikëshme sociale”, u hap rrugën këtyre ndryshimeve sociale duke zgjeruar e modifikuar caqet normativë. Në analizë të fundit elita sociale pushtetmbajtëse i friksohet më tepër nga kaosi dhe revolucioni, sesa nga krimi dhe çrregullimi.

Analiza e situatave të viteve ‘60 -‘70 në Europën perëndimore apo situatat e viteve ‘90, në Europën lindore dhe në Shqipëri, tregon se elita social-politike e këtyre vëndeve, u hapi rrugë ndryshimeve sociale, kur e kuptoi dhe u bind se përmasat e çrregullimit dhe tensionet sociale që i sfidonin pushtetet, nuk mund të mbaheshin dot nën kontroll, as me një policim formal të fortë. Ndryshimi social nuk ndodhi, ngaqë policia ishte e paaftë të kryente funksionet e veta, por sepse përçapjet për të rivendosur ekuilibrat e mëparshëm socialë, duke mbajtur *status quo*-në sociale, vetëm do ta rëndonin problemin, në vënd që ta zgjidhnin.

Të tri faktorët: organizimi social, interesat e elitës dhe perceptimet problemit të krimit dhe çrregullimit - janë në korrelacion me zhvillimet që ndodhin në organizimin formal të policive. Duke u kombinuar dhe alternuar me njeri tjetrin, ato krijojnë kushtet e domosdoshme sociale, që institutojnë policimin profesionist, dobite e të cilit peshojnë më tepër sesa efektet e mundëshme negative të tij.

o Evolucion i policimit

Në format e veta më të herëshme, kontrolli social dhe policimi si pjesë e tij ishte produkt i reagimit për vetmbrojtjen individuale e kolektive. Kompensimi apo vënia në vënd e dëmit të shkaktuar ishte një çështje krejt personale. Nëse dikush vidhte, sulmonte apo kalonte nga një vënd në një tjetër brenda kufijve të një prone, personi i dëmtuar ishte përgjegjës për të kërkuar drejtësi.

Më shpesh kjo drejtësi arrihej në forma personale të shpagimit (me vetgjqësi) në të njëjtën mënyrë, ose me dëmshpërblim. Kështu, personi i dëmtuar ishte moralisht i justifikuar të kërkonte dëmshpërblimin personalisht, me kërcënim ose duke përdorur forcën për ta marrë atë. Nëse viktimat nuk ishte në gjëndje të kërkonte dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar, askush nuk përzihej në atë çështje. Me përjashtime të rralla (*vetëm për shkeljet e tabuve apo normave fetare*) zgjidhja e mosmarveshjeve të tilla mund të ishte objekt i interesit e shqetësimit të grupit social.

Një nga rezultatet më të pakëndshme të sistemit të shpagimit personal (sistemi i vetgjqësisë), ishte prirja për ta tepruar me hakmarrjen ndaj dëmtuesit, duke krijuar një zinxhir të pafund hakmarrjesh. Nëse dikush vjedh dhe i dëmtuari kërkon dëmshpërblimin, kur ky nuk mund të merret i dëmtuari, mund ta vrasë vjedhësin, duke hapur një linjë të re shpagimi. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar shpërndahet shpejt nga individi mbi tërë familjen e tij. Kjo situatë nuk mund të zgjidhej pa një arbitër të jashtëm. Fenomeni nuk është tjetër veçse hakmarrja klasike e përgjakëshme, e cila, sikurse dëshmon historia jonë, u synua të mbahej nën kontroll përmes përpunimit të një sistemi rregullash e arbitrimesh të përfshira në të ashtuquajturën “*e drejtë zakonore orale*” e kodifikuar në kanune si ai i Skënderbeut, i Lek Dukagjinit, i Mirditës dhe i Labërisë, të cilësua shpesh si monumente të kulturës juridike të popullit shqiptar.

Në këto treva kulturore, synohej që zinxhiri i hakmarrjeve dhe i shpagimit me vetgjqësi, të zgjidhej duke përcaktuar rregulla standarde për natyrën, procedurat dhe llojet e dëmshpërblimeve nën mbikqyrjen e një personi i caktuar nga kanuni, si kujdestar i gjakut. Përpjekjet për ta

Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

Kushtetuta e RSH Neni 1 dhe 15

“Kanuni kurdoherë don ndreqje e jo vrasje. ... Kanuni thotë: “Mos vra” sado dam të madh të bani kush, sado keq të ngau... “Kush vret do të vritet”, ...Gjaku ndal gjakun,...Ndërmjetësinë e katundit a të bajrakut s’mund ta prishë askush, ... Për gjak burri vret burrë, fëmija e plaku nuk vriten për gjak”

E drejta e marrjes së gjakut -“Gjaku lahet me gjak”-Kanuni i Skënderbeut, pjesa VI dhe IX dhe neni 3006

kontrolluar vetgjqësinë dhe prirjen për ta shtrirë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar pa kufij brenda familjes, në këto kode zakonore, i gjejmë tek përjashtimi nga vrasja e fëmijëve dhe grave dhe zëvendësimi i shpagimit prej tyre me dëmshpërblime materiale, me procedurave të rrepta të gjakmarrjes, dhe tek zakoni “i dhënies së Besës”.

○ **Policimi në një shtet të centralizuar.**

Skica lidhur me faktorët, influencat dhe problemet e zhvillimit të policimit, jep një përshkrim të thjeshtuar të modeleve paramoderne të policimit. Ajo jep pamjen e përgjithëshme të faktorëve që influencojnë mbi strukturën dhe funksionet e policisë dhe variacionet e saj nga shoqëria në shoqëri.

Megjithë ngjashmëritë në shumë aspekte, policitë ndryshojnë nga njera tjetra. Përshkrimi më i detajuar i çdo force policore do të tregonte influencën e fortë të traditës kulturore të çdo vendi mbi zhvillimet e policisë së vet.

Në të gjitha rastet, policitë formale paraqiten si produkt i konsolidimit të pushtetit të qeverisjes qendrore sepse: 1) pjestarët e forcave policore zgjidhen, trainohen e paguhen nga qeverisja qendrore; 2) agjentët e policisë ja përkushtojnë besnikërinë e tyre jo grupeve me lidhje gjaku apo udhëheqësve lokalë, por qeverisjes qendrore dhe 3) në çdo rast, policia krijohet për të mbrojtur dhe për të demonstruar pushtetin shtetëror. Në këtë mënyrë policia ngarkohet me mbrojtjen e rendit social dhe duke vepruar për ta realizuar këtë detyrë, ajo në fakt realizon pushtetin shtetëror qendror dhe mbajtjen nën kontroll të popullsisë. Duke iu referuar shëmbullit të Francës, një studiues shprehet se policia shërben si “...një qeverisje e përditëshme”. Kjo, sepse qeverisja politike mund të shkëmbehet periodikisht midis forcave politike, kurse organizata policore është e qëndrueshme dhe garanton vazhdimësi në funksionet e rëndësishme të kontrollit social.

Në terma të përgjithshëm, policitë profesioniste formohen si pjesë e ndryshimit të gjerë social që përfundon me krijimin e një shteti të centralizuar dhe një rikonceptim të strukturave klasore të shoqërisë. Sikurse modelet e organizimit social zhvendoseshin nga lidhjet e gjakut dhe vasaliteti feudal drejt krijimit të identiteteve kombëtare, edhe koncepti i policimit ndryshoi nga policimi informal në policim si një formë dhe pjesë e organizimit të pushtetit shtetëror. Për më tepër modelet e vjetra të organizimit social nuk e vinin theksin tek liritë individuale, por bazoheshin në një sistem klasor të strukturuar sipas rregullit: një pakicë e fuqishme (*paterfamilias* dhe feudalët) gëzonin pozicione të privileguara dhe të balancuara midis tyre, ndërsa shumica e popullsisë (bujkrobërit, argatët) u shërbente.

Thelbi i ndryshimeve sociale që ndodhën nuk kishin të bënin aspak me dhënien e më shumë të drejtave individëve apo me zgjerimin e liritë të tyre, por me konsolidimin më të madh e përqëndrimin e pushtetit (social, politik dhe ekonomik) në një dorë të vetme.

Kjo do të thoshte se qytetarët mbetën përsëri si më parë; marrëdhëniet e tyre me pushtetin nuk ndryshuan. Ata mbetën sërish shërbëtorë të pakicës, që sundonte dhe rrezik potencial i pushtetit të tyre. Për këtë arsye policia përveç pushteteve klasike mori edhe atë të shtrëngimit

1. Në 1800 krijohet prefektura e policisë së Parisit dhe Ministria e Policisë, nga Bonaparti
2. Në 1829, Sër Robert Peel, formulon 9 parimet e policimit profesionist, të cilat përbëjnë edhe sot themelin e filozofisë së policimit demokratik.
3. “Filozofia themelore e policisë britanike është të veprojë e të funksionojë me miratimin e publikut”. Ai (polici) duhet të tregohet i sjellshëm dhe t’u shërbejë njerëzve të çdo klase dhe të çdo shkalle shoqërore”, “Rregullorja e parë e Policisë Metropolitane të Londrës”.
4. Në vitin 1902 fillon në SHBA lëvizja profesionaliste e inicuar dhe frymëzuar nga August Volmer, shefi i policisë së Berklit, Kaliforni. Kjo lëvizje vazhdoi deri në vitet ’30, kur ajo u shndërua në modelin e reformës së policisë në SHBA e në vendet e tjera demokratike
5. 1976 përkufizohen përgjegjësitë sociale të Polcisë në demokraci:
① të mbrojnë jetën e pronën private; ② të mbajnë e të mbrojnë qetësinë dhe sigurinë publike; ③ të parandalojnë krimin; ④ të zbulojnë e të arrestojnë shkelësit e ligjit; ⑤ të shtrëngojnë zbatimin e ligjeve; ⑥ të mbrojnë e të respektojnë të drejtat themelore universale të individit;

Këto zhvillime, shtruan nevojën e ndryshimeve në organizim, në strategji dhe në pranimin në polici të njerëzve të shkolluar, duke e orientuar më shumë drejt publikut të gjerë.

mbi qytetarët në emër të qeverisjes qendrore. Më parë ky pushtet ushtrohej në emër të udhëheqësve lokalë. Duke u shndëruar në agjentë të një autoriteti qeverisës qendror të krijuar rishtazi, policisë iu dhanë attribute të gjera arresti, rregullimi e investigimi dhe u strukturua që ta kishte theksin mbi aktivitetet “antiqeverisëse”.

Policia i kushtonte vëmendje të posaçme mbajtjes nën kontroll dhe investigimit të armiqëve politikë të qeverisjes aktuale. Kjo përfshinte që nga grumbullimi i informacionit dhe provave, arrsimet, kontrollin e veprimeve subversive e sipas rastit censurimin dhe propagandën.

Përveç këtij përdorimi politik të policisë, ajo ngarkohej edhe me larmitet detyrash që kishin të bënin me shëndetin dhe rregullin publik, si pjesë të detyrave të mbajtjes nën kontroll të krimit konvencional. Ky rikonceptim i rolit të policisë, si element i qeverisjes politike dhe në shërbim të pushtetit, shpjegon faktin pse ky organizim kontrolli social u quajt për herë të parë “*police*” në epokën napoloniane, si jehonë e origjinës greko-romake të termit.

Roli i ri, atributet dhe emri vinin në sinkron me statusin social të policisë, si komponent qendror i politikave të centralizuara qeverisëse. Në këto shoqëri, policia atashohet në mënyrë tipike pranë një entiteti qendror qeverisës, siç ishte *Ministria e Brendëshme*, dhe ka përgjegjësinë të përmbushë një numur të madh funksionesh rregulluese, që nisin me kujdesin për ndriçimin e rrugëve e shkonin gjer tek shërbimet e shëndetit publik: Policia rregjistronte lindjet e vdekjet, lëshonte dokumenta identifikimi dhe i kontrollonte ato, organizonte dhe ofronte shërbimet e mbrojtjes nga zjarri si dhe shërbime qeverisëse të nivelit vendor. Në këtë mënyrë ajo tregohet si një komponent integral i qeverisjes dhe hyn në kontakte e ndërveprime të vazhdueshme me qytetarët. Për këtë arsye ajo përqëndrohej më tepër në ato probleme e çrregullimeve të rendit socialpolitik dhe krimit, që perceptoheshin si më shqetësuese për pushtetin qendror e lokal, në emër të shoqërisë.

Nga ana tjetër, duke u zhvilluar brenda realiteteve social-historike, organizimet e forta dhe të centralizuara policore përfaqësojnë një produkt kulturor të shoqërisë në të cilën ato u formuan. Psh kur krahasohen modele e policimit të shoqërive me një qeverisje të centralizuar me policitë e vendeve federative apo konfederative, vihet re një ndryshim i dukshëm. Policitë e kontinentit europian kanë struktura më të centralizuara dhe kanë më tepër attribute në jetën e përditëshme, në krahasim me ato të shteteve federale apo me vendet e traditës kulturore anglofone. Kjo vëret faktin kushtet social historike dhe traditat kulturore të ndryshme në shoqëri të ndryshme kanë kushtëzuar larminë e modeleve policore dhe se shoqëritë e formojnë sistemin e vet policor sipas portretit të tyre social kulturor.

• **Koncepti “Polici” në këndvështrimin e shoqërisë demokratike**

Termi “**polici**” ka lidhje me fjalën e vjetër greke *politeuein*, që nënkupton të qënien qytetar ose angazhimin në aktivitetin politik, dhe *polis*, që i referohet qytetit shtet të asaj kohe. Këto përcaktime theksojnë rëndësinë që ka individi, procesi politik dhe shteti: Si janë njerëzit që do të qeverisen dhe do të mbahen nën kontroll me anë të ligjit? Cilët janë ata që do të qeverisin dhe do të kërkojnë zbatimin e ligjit? Të gjitha llojet e qeverisjes vishen me autoitetin policor, për të rregulluar çështjet e shëndetit publik dhe të parandalimit të krimit, të sigurisë dhe të rendit, të zbatimit të ligjit dhe të moralitetit, sepse shoqërisë i duhen në mënyrë të domosdoshme edhe struktura, edhe rendi publik, për plotësuar përmes funksioneve të saj nevojat për mbijetesë, për siguri, nevojat ekonomike dhe nevojat sociale të pjestarëve të saj. Policia si organizatë dhe sistemi i zbatimit të ligjit si institucion, përbën një nga shprehjet më të rëndësishme të pushteteve policore (që i referohen domethënies të origjinës së termit) në shoqëri.

Veprimet dhe sjelljet e policisë dhe të punonjësve të saj, pjesërisht përvcaktohen nga tipi i qeverisjes ku ata bëjnë pjesë. Në më të shumtën e qeverisjeve totalitare, pushteti është në duart e një personi (psh të diktatorit), të një numuri të vogël

Të ndërtojmë një demokraci kushtetuese, në të cilën ushtrimi i pushtetit, ka si premisë bazë e të vetme “Shtetin Ligjor”, që nënkupton:

“Ne qeverisemi e duhet të qeverisemi nga ligjet dhe jo nga njerëzit”

personash, ose të një partie politike. Në vijim të ushtrimit të pushtetit totalitar, ligjet, rregullat dhe politikat e ndjekura për të kontrolluar të gjitha aspektet e jetës kanë tendencë të mbajnë dhe të mbrojnë interesat e këtyre pushteteve, kurse rendi social mbrohet duke u paguar me çmimin e të drejtave dhe lirive të individit. Shoqëritë dhe qeverisjet demokratike bazohen në idenë e “pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes në qeverisje.” Qytetarët e një shoqërie demokratike, ose marrin pjesë direkt në marrjen e vendimeve dhe në nxjerrjen e ligjeve (me referendume), ose zgjedhin përfaqësues të tyre për të marrë këto vendime në institucionet ligjvënëse (në parlament).

Democritë përqëndrohen në detyrimin shoqëror për të garantuar liritë dhe të drejtat për qytetarët e tyre, e nga ana tjetër vendosin kufizime ndaj përdorimit të pushteteve policore prej qeverisjes. Ky përbën shqetësimin kryesor të çdo demokracie, qysh kur ajo harton kushtetutën e saj. Kushtetuta shërben për një qëllim themelor: të përcaktohet natyra dhe karakteri i qeverisjes duke identifikuar dhe shpallur parimet bazë që do të nënvizojnë çdo lloj qeverisje, të çdo krahu apo orientimi politik. Për këtë arsye ajo identifikon dhe shpall funksionet e qeverisjes dhe paketën e të dejtave që gëzojnë qytetarët dhe që qeverisjet e ndryshme mund dhe duhet t’i respektojnë në çdo situatë dhe rrethanë. Ne priremi të ndërtojmë një demokraci kushtetuese në të cilën ushtrimi i pushtetit ka si premisë bazë “Shtetin Ligjor”, i cili nënkupton se ne qeverisemi dhe duhet të qeverisemi nga ligjet dhe jo nga njerëzit, apo nga organizata si policia. Teorikisht, ligjet që krijohen nëpër një rrugë demokratike janë më të arsyeshme dhe ka më tepër gjasa që të jetë të mirëpritura nga qytetarët, në krahasim me ligjet e krijuara nga një njeri, nga disa apo nga njerit me më tepër influencë në shoqëri. Dhe megjithëse, qeveritë demokratike, jo gjithmonë veprojnë në këtë mënyrë, tashmë është e qartë se zbatimi në praktikë i shtetit ligjor e bën qeverisjen dhe institucionet e administratës së shtetit të jenë më pak tiranike e autokratike dhe më tepër përfaqësuese e intersave dhe shqetësimeve të qytetarëve. Nja nga arsyet më madhore pse shteti ligjor konsiderohet si i domosdoshëm në një shoqëri demokratike është se ata që aspirojnë për demokracinë, si sistemi më i mirë i qeverisjes së shoqërisë, janë të bindur dhe sjellin argumenta se përqëndrimi i pushtetit tek disa individë pasohet nga abuzimi me këtë pushtet (psh sillen dhe veprojnë në mënyra autokratike) sepse nuk kontrollohen nga kushtetuta, nga ligjet e përpunuara në mënyrë demokratike, si dhe nga struktura apo organizata të posaçme shtetërore.

Forma republikane e qeverisjes, nënkupton një shtet të centralizuar që lejon dhe priret të zgjerojë pjesëmarrjen e njerëzve në qeverisje dhe në sistemin politik dhe nga ana tjetër vendos kufij të qartë për pushtetin politik të njerëzve të zgjedhur organet e shtetit përmes proceseve elektorale. Një veçori tjetër mjaft e rëndësishme organizative e shtetit në Shqipëri është “Ndarja e pushteteve,” që nënkupton ndarjen e qartë me ligj kushtetues të pushtetit shtetëror në tri komponentë: ekzekutiv, juridik dhe legjislativ. Kjo ndarje e pushteteve ka për qëllim të garantojë një sistem qeverisës që funksionon mbi bazën e rregullit “kontroll dhe balancë” në mënyrë që çdo komponent përbërës i shtetit të mos ketë më tepër sesa duhet pushtet apo të bëhet më i pushtetshëm se të tjerët. Zbatimi i ligjit dhe aplikimi i shtrëngimit ligjor është përgjegjësi e pushtetit ekzekutiv. Po ashtu me ligj, një përgjegjësi e tillë i delegohet policisë së shtetit.

Kushtetuta e Shqipërisë, shpall:

Neni 1

1. Shqipëria është republikë parlamentare.
2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.
3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhesh të lira të barabarta, të ndershme, të përgjithëshme dhe periodike

Neni 7

Sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor

Qeveria dhe ligjet krijohen përmes proceseve ose sistemeve politike të kontrolluara po me ligje. Të qënë në politikë, për shoqërinë demokratike, nënkupton përfshirjen në përpjekjet për të influencuar në mënyrat sesi do të përdoren burimet shtetërore (psh., fondet, teknologjia, nëpunësit e administratës shtetërore dhe njohuritë, aftësitë dhe vendimmarrja e tyre) dhe çfarë ligje e politika do të përpunohen për të udhëhequr vendimmarrjen qeverisëse, si psh cilat do të jenë orientimet dhe

direktivat në përdorimin e forcës dhe të shtrëngimit ligjor nga policia. Votuesit, grupet me interesa të veçanta dhe të zgjedhurit, në këtë mënyrë janë e bëhen pjesëmarrës aktivë në proceset qeverisëse të shtetit.

Këto koncepte mbi raportet e shtetit demokratik me ligjin dhe policinë (me zbatimin e ligjit) trajtohen në një numur teorish dhe këndvështrimesh, ndër të cilat, disa janë më të përqëndruara mbi praktikën e qeverisjes, kurse disa të tjera mbi raportet midis komponentëve të ndryshëm të qeverisjes së shoqërisë demokratike. Teoritë e vendimmarrjes politike në demokraci përfshijnë si këndvështrimet pluraliste ashtu edhe ato elitariste ose klasore. Këndvështrimi pluralist argumenton se duhet të jetë debati, marrëveshjet e konsensusit politik dhe kompromiset, që të përcaktojnë mënyrat dhe rregullat e përdorimit të burimeve, ligjeve dhe politikave dhe jo imponimi apo autoritarizmi. Kjo do të thotë se, megjithse në shoqëri ka shumë intetresa të ndryshëm dhe shumë grupe, asnjë prej tyre nuk duhet të jetë mbizotërues. Këndvështrimi elitist, ose klasor argumenton se vetëm një numur i kufizuar personash (psh, njerëzit e pasur ose grupet me interesa të veçanta) kanë ndikim real mbi proceset politike në shoqërinë demokratike. Ndërtimi i politikave qeverisëse mbi bazën e një këndvështrimi të tillë teorik çon në trajtime preferenciale për më të pushtetëshmit dhe në diskriminimin e atyre njerëzve apo grupeve shoqërore që nuk kanë influencë, pasuri apo pushtet. Ajo që e bën të dukshëm aplikimin e këndvështrimeve elitariste në shoqëri dhe problemet që e bashkëshoqërojnë, është shpeshësia në të cilën policia dhe punonjësit e saj trajtojnë në mënyrë preferenciale disa individë ose grupe, duke diskriminuar e keqtrajtuar disa të tjerë. Kjo sjellje përbën një arsye serioze për faktin pse përpjekjet dhe rezultatet për të përcaktuar vendin dhe rolin e policisë në një shoqëri demokratike janë të ndryshme, disa herë kontradiktore, pikërisht sepse nisen nga këndvështrime të ndryshme lidhur me atë se cilat duhet të jenë qëndrimet, veprimet dhe sjelljet që do të konsiderohen të përshtatshme për policinë një shoqëri.

○ Konflikti Demokraci-Polici

“Demokracia është gjithmonë e rreptë dhe kritike ndaj Policisë”. Policia, në teori dhe në praktikë, është në konflikt me disa nga karakteristikat më themelore të shoqërisë demokratike. Policia përfaqëson forcën ligjore të shtetit, që përdoret për të detyruar dhe për të shtrënguar qytetarët, nëse është e nevojshme, t’i binden ligjeve, të cilat, së paku teorikisht, janë hartuar dhe miratuar nga shumica për të qeverisur shoqërinë. **Policim** do të thotë të mbash nën kontroll dhe të mbikqyrësh me anën e policisë, komunitetet, zonat e banuara, hapësirat publike, me qëllim që në to të garantohet rendi kushtetues dhe zbatimi i ligjit.

Për të qënë e suksesëshme dhe e realizuar plotësisht, demokracisë i duhet të bazohet mbi konsensusin e interesave të ndryshëm të të gjithë qytetarëve. Kur ky konsensus dështon, policia dhe punonjësit e saj janë shpesh të parët përfaqësues të shtetit, që reagojnë. Psh, një nga parimet më të zakonshme në demokraci është paprekshmëria dhe e drejta e pronës private. Kur një person i vjedh pronën apo pasurinë një tjeri, kjo pasqyron një dështim në arritjen e konsensusit rreth respektimit të kësaj vlere. Një nga arsyet kryeore për të cilën është krijuar dhe mbahet policia, së paku pjesërisht, është ideja se ky konsensus nuk mund të arrihet plotësisht, në çdo kohë dhe nga të gjithë qytetarët. Në këtë këndvështrim policia dhe ekzistenca e saj në shoqërinë demokratike, shihet si një zgjidhje për shkak të pamundësisë për konsensus dhe jo si një komponent organik i shoqërisë.

Një konflikt tjetër potencial demokraci-polici ka të bëjë me rolin e qeverisjes. Qeverisja në një demokraci ndërtohet dhe ekziston për të përfaqësuar dhe për tu shërbyer qytetarëve të vet. Megjithatë, policia, si një pjesë përbërëse e administratës shtetërore parashikon të ofrojë shërbime që shumë njerëz nuk do t'i dëshironin (psh vendos gjoba në qarkullimin rrugor, ndalon ose areston personat që krejnë vepra penale apo devijon rrugëkalimet nga qarkullojnë njerëzit për të lejuar disa të tjerë të manifestojnë etj.), megjithatë që nuk mund të shmangen. Megjithatë në një kënvështrim abstrakt, qytetarët janë dhe duhet të jenë dakord me qeverisjen që kanë zgjedhur vetë, në praktikë ka mjaft raste kur ata i rezistojnë kërkesave të ligjit që qeveris dhe ndërhyrjeve të njerëzve që e përfaqësojnë (përfshi edhe punonjësit e policisë).

Demokracia gjithashtu nënkupton një shkallë të caktuar të lirisë të individëve. Ndërkohë që liria absolute konsiderohet e dëmshme për çdo shoqëri, demokracia, së paku i lejon qytetarët të marrin pjesë aktivisht dhe relisht për të vendosur sëbashku si dhe kur do të kufizohen liritë e individit. Shpesh ky konflikt, në shoqëritë demokratike është quajtur edhe *“tensioni midis lirisë dhe rendit”*. Megjithatë, politikat dhe procedurat e policisë si dhe vendimet e punonjësve të veçantë të policisë, jo gjithmonë mund dhe duan, t'i përfshijnë qytetarët në hartimin dhe marrjen e këtyre vendimeve. Për pasojë, ushtrimi i autoritetit policor ka prirje të reflektojë një orientim autoritarist përkundrejt shoqërisë *“së lirë”*. Policia dhe punonjësit e saj janë kujtesa kontante e faktit se liria në shoqëri demokratike nuk është e pakufishme.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme në demokraci është vëmendja dhe vlerësimi i barazisë. Teoria e kontratës sociale të shtetit bazohet në besimin se shtetet dhe qeveritë demokratike ndërtohen dhe ngrihen mbi themelet e një kontrate sociale, në të cilën të gjitha palët bien dakord dhe konsiderohen si të barabarta. Megjithatë, qytetarët dhe punonjësit e policisë nuk janë të barabartë në praktikë për shumë shkaqe objektive dhe subjektive. Kjo më e dukshme është në raportet që ata krijojnë me ligjin dhe të drejtat që gëzojnë. Sipas teorisë kontraktuale, kur merr jetë një kontratë sociale, e mishëruar dhe e pasqyruar në ligjet dhe kushtetutën e shtetit, realizimi i saj në praktikë duhet mbikëqyrur dhe kontrolluar, me qëllim që të gjitha palët të respektojnë përgjegjësitë dhe angazhimet e tyre në raport me palët e tjera. Nëse nuk ndodh një gjë e tillë, pra nëse palët nuk i mbajnë premtimet dhe nuk realizojnë përgjegjësitë e tyre, policia dhe punonjësit e saj kanë për detyrë të garantojnë dhe të sigurojnë respektimin e kushteve ligjore të kontratës sociale, të garantojnë se qytetarët do t'u binden kërkesave të ligjit, madje edhe duke përdorur ndëshkimin, forcën dhe shtrëngimin nëse është e nevojshme. Pikërisht kjo tregon se pozicioni i policisë dhe i punonjësve të saj, në raport me qytetarët dhe organizimet e tyre nuk është i barabartë, madje policia dhe punonjësit e saj, më tepër sesa palët në kontratën sociale, janë ndërmjetës dhe vëzhgues të respektimit të kushteve të saj.

Të gjithë këta faktorë argumentojnë pse e kundërta e një shteti demokratik shpesh quhet shtet policor. Demokracia përfaqëson konsensusin, lirinë, pjesëmarrjen dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe njeri tjetrit; kurse policia përfaqëson frenimin e kufizimin e këtyre vlerave të demokracisë, si dhe imponimin e autoritetit të shtetit dhe ligjit mbi individët qytetarë. Kjo është

Qeverisja në një shtet demokratik ndërtohet dhe ekziston për të përfaqësuar, për të mbrojtur dhe për t'iu shërbyer qytetarëve të vet:

Kushtetuta e Shqipërisë

Neni 2

- Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit
- Populli e ushtron sovranitetin e tij nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti

Neni 4.

- E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit

Neni 11.

- * Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj

Neni 15

1. Të dretat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre

Neni 30.

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë

arsyeja pse policia, shpesh ndeshet me një lloj armiqësie e mospranim, me kundërshtime dhe kritika lidhur me efektivitetin dhe drejtësinë që duhet të tregojë. Konfliktit midis demokracisë dhe policisë i duhet drejtuar në disa mënyra dhe duhet analizuar me kujdes, me qëllim që përpjekjet e demokracisë për të bashkëjetuar me ushtrimin e autoritetit shtetëror nëpërmjet vënies së theksit mbi rëndësinë e shtetit ligjor.

o Demokracia dhe Shteti Ligjor

Rëndësia e Shtetit Ligjor për Demokracinë dhe Policinë:

Liria nuk varet dhe asnjëherë nuk ka qënë e ndërvarur nga ndonjë formë e veçantë e organizimit policor. Ajo varet nga epërsia që ka dhe që duhet të ketë Shteti i së drejtës në krahasim me të gjitha format e tjera të shtetit. Kriteri më i përkryer (për të përcaktuar nëse ka apo jo shtet policor) është verifikimi nëse policia dhe punonjësit e saj në të gjitha nivelet janë llogaridhënës e të përgjegjshëm para ligjit dhe në fund të fundit para një qeverie të zgjedhur e formuar në mënyrë demokratike. Në vendet ku ekziston shteti policor, pushtetet e policisë kontrollohen nga një qeverisje (totalitare) që nuk njihet si e zgjedhur në mënyrë demokratike (me zgjedhje të lira dhe të ndershme) dhe ku qytetarët nuk mundin që t'i drejtohen realisht e të mbështeten tek ligji për tu mbrojtur.

Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e policisë dhe punonjësve të saj në kryerjen e funksioneve të ngarkuara me ligj, të vendimeve dhe veprimeve ndaj shtetit ligjor është një nga tradicionet më të rëndësishme të shoqërive demokratike. Bazat e policimit demokratik, sipas një tradite të tillë, gjenden tek ligjet dhe tek veprimet e arsyeshme dhe humane të atyre që i zbatojnë këto ligje.

Ka mjaft mënyra për të klasifikuar ligjet; për shëmbull ato mund të jenë ligje të natyrës civile ose ligje të natyrës penale, mund të jenë ligje organike ose ligje proceduriale. Ligje të natyrës civile janë ato që merren me marrëdhëniet midis individëve (psh, kontratat, shumë nga transaksionet dhe marrëveshjet e shitblerjes në fushën e biznesit, marrëdhëniet familjare); ligje të natyrës penale janë ato që merren e rregullojnë marrëdhëniet midis individëve dhe shtetit. Në thelb dhe në fokusin e ligjeve penale janë ato sjellje që paraqesin kërcënim për rendin, sigurinë publike, për jetën dhe pasurinë e qytetarëve (psh., kontrabanda, trafiket e narkotikëve dhe qenieve njerëzore, vjedhjet, grabitjet, përdhunimet dhe vrasjet etj, konsiderohen krime në kodin penal). Akuza dhe ndjekja penale për një krim të kryer apo të mbetur në tentativë bëhet në emër të qytetarëve dhe të ligjit nga një nëpunës i shtetit (psh., prokurorët dhe punonjësit e policisë gjyqësore). Sidoqë që për policinë është e zakonshme të ketë të bëjë me të dy llojet e ligjeve, si ato civile, edhe ato penale, puna dhe problemi parësor i saj është përqëndrimi tek ligji penal.

Në praktikë dhe në imazhin publik mbi policinë, ky përqëndrim është aq i fortë, saqë shpesh anashkalohet fakti se mjaft nga detyrat e policisë kanë të bëjnë me ligjet civile, psh me detyrimin për të ndërmjetësuar mosmarrëveshjet dhe konfliktet civile midis individëve; bashkëpunimet me inspektoriatet dhe policitë e tjera për zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjësme, për zbatimin e vendimeve të gjykatave civile dhe të përmbartimit; në shërbimet që duhet të kryejë në emergjencat civile; në shërbimet për mbajtjen e rendit dhe rregullit në grumbullime publike, në rregullimin e qarkullimit të mjeteve dhe njerëzve në rrugë (jo kur shkelen rregullat, por për të garantuar të drejtën e barabartë civile të të gjithë qytetarëve) etj.

Duke shqyrtuar këto detyra institucionale të Policisë së Shtetit, vihet re se ajo shpenzon mjaft kohë e burime, për t'u marrë edhe me zbatimin e ligjeve civile. Megjithatë, kryesore mbeten ato detyra që e ngarkojnë me zbatimin e ligjit penal. Ajo, me atributet (pushtetet policore) e saj, reagon kryesisht në shkeljet e tij dhe për llogari të vënies në vënd të drejtësisë penale (psh, duke rivendosur me forcë rendin e prishur, sigurinë publike të rrezikuar apo duke ndjekur, zbuluar e kapur keqberësit dhe autorët e veprave penale)

Në sferën e ligjit penal, ligje të natyrës organike janë ato që identifikojnë llojet e sjelljeve, që lejohen ose ndalohen, si dhe ndëshkimet respektive që parashikohen në kodin penal për shkeljen e normave penale. Psh, ngarja e makinës në gjëndje të dehur konsiderohet e ndaluar dhe një sjellje e tillë ndëshkohet me gjobë, me heqje të të drejtës për të drejtuar automjetet, me shoqërim në komisariat ose me të gjitha bashkë, apo përvetësimi (vjedhja) fshehtas dhe pa pëlqimin e pronarit të ligjshëm të një pasurie apo pronës private, konsiderohen veprime të rrezikshme e të ndaluara (kundravajtje penale ose krime) dhe për to parashikohen ndëshkime me gjoba, me ndalimin dhe heqjen e lirisë të keqbërësit etj.

Ligjet e natyrës procedurale rregullojnë si do të veprojë policia dhe punonjësit e saj hap pas hapi për të zbatuar ligjet organike, çka do të thotë, të procedohet në një mënyrë vendosmërisht demokratike për të ushtruar autoritetin ligjor dhe dhënien e drejtësisë për të gjithë. Korniza ligjore më e rëndësishme e referencës për kodin e ligjin procedural penal është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Pjesa e dytë – “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”), Kodi i sjelljes i zyrtarëve të zbatimit të ligjit i OKB, Kodi European i Etikës Policore, Kodi i Etikës i Policisë së Shtetit, Ligji për Policinë e Shtetit dhe Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, që orientojnë, rregullojnë dhe përcakton në mënyrë më specifike “*në ç’mënyrë, në ç’kohë, në ç’vend dhe për ç’arsye*” do të përdoret çdo proçedurë e veçantë.

Kur policia kërkon zbatimin e një ligji organik (sidomos kur ai është ligj penal), veprimet e saj kufizojnë dhe frenojnë sjelljet e qytetarëve. Për këtë arsye këto veprime të policisë perceptohen shpesh si shkelje e të drejtave demokratike prej qytetarëve dhe opinionit publik. Sadoqë shpeshherë kjo pasqyron konfliktin demokraci-polici, publiku ka të drejtë të preokupohet dhe të friksohet për vënien e kufizimeve të tilla, sepse praktika (sidomos përvoja me ligjet penale të diktaturës) dëshmon për raste të paragjykitimit, diskriminimit dhe abuzimit. Kur policia dhe punonjësit e saj zbatojnë ligjin penal, duhet dhe kërkohet me forcë dhe rreptë të repektohet ligji procedural, i cili ka qëllim kryesor të vendosë limite në ushtrimin e attributeve dhe të reduktojë në maksimum mundësitë e abuzimit me pushtetin me të cilin janë veshur këta punonjës të policisë.

Nga ana tjetër ligji procedural jo vetëm që parashikon kornizën, brenda së cilës duhet të organizohen e kufizohen vendimet dhe veprimet policore, por kërkon e vendos kushte për këto veprime, që të kenë një shkak të provuar (psh., “një dyshim të arsyeshëm” ose “një shkak të besueshëm”) për të ndërhyrë në jetën private të qytetarëve.

Në këndvështrimin e shoqërisë demokratike dhe parimeve të shtetit ligjor, shtrëngimi ligjor konsiderohet si më pak i rëndësishëm në raport me repektimin e të drejtave të individit dhe një shqetësim se qeverisja dhe sistemi i institucioneve të saj mund të abuzojnë me këto të drejta..

Madje, edhe kur policia e ka autoritetin e duhur ligjor dhe është e justifikuar ligjërisht për reagimet dhe ndërhyrjet e veta, punonjësit e saj jo gjithmonë janë në gjëndje të zbatojnë me korrektësi dhe pa lëshime ligjin, për shkak të burimeve njerëzore e materjale të kufizuara, për shkak të pritjeve të publikut (nivelit të mirëbesimit), për shkak të prioriteteve organizative (psh policia ka si prioritet luftën

V. Orientime për veprimin/ ndërhyrjen policore

35. Policia dhe të gjithë operacionet e policisë duhet të respektojnë të drejtën e individit për jetën.
36. Policia nuk duhet të bëjë, të nxisë, ose të tolerojë asnjë akt torture ose trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor ose poshtërues në çfarëdo rrethane.
37. Policia mund të përdorë forcën vetëm kur është rreptësisht e nevojshme dhe vetëm në atë shkallë që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.
47. Hetimi policor, si minimum, duhet të bazohet në një dyshim të arsyeshëm, për një shkelje apo krimi të mundshëm.

VI. Përgjegjëshmëria dhe kontrolli i policisë

59. Policia duhet të jetë e përgjegjshme ndaj shtetit, qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Ajo t'i nënshtrohet një kontrolli të efektshëm nga jashtë.
60. Kontrolli shtetëror ndaj policisë duhet të bëhet nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.
61. Autoritetet publike duhet të sigurojnë proçedura të efektshme dhe të paanëshme për ankesa kundër policisë.

“Kodi European i Etikës Policore” 2002

kundër krimit të organizuar dhe trafikeve, ndërkohë që është po detyrë e saj të luftojë me krimin konvencional) dhe të preferencave që kanë vetë punonjësit e policisë. Për më tepër, edhe policia si organizatë, edhe punonjësit e saj përdorin një shkallë të madhe maturie profesionale. Kjo do të thotë se shpesh është në dorën e tyre (dhe madje është mjaft e vështirë të mbikëqyret e të kontrollohet) që të përzgjedhin sipas preferencave dhe sipas përvojës profesionale, cili ligj apo nen i një ligji do të zbatohet dhe se si do të bëhet kjo në një rast konkret. Ajo që tërheq vëmendjen dhe bëhet mjaft shqetësuese në këtë shkallë të lartë diskrecioni është fakti se edhe kur një punonjës policia ndodhet brenda caqeve të lejuara nga ligji organik, për të reaguar dhe vepruar gjatë kryerjes së detyrës, mund të ndodhin abuzime ose të cënohen të drejtat e individit (psh barazia e qytetarëve para ligjit, kur ndërmjet dy qytetarëve që kanë bërë të njëjtën shkelje, njeri ndëshkohet e tjetri jo).

Ka një numur të madh faktorësh objektivë dhe subjektivë, që ndikojnë në përdorimin e diskrecionit. Ndaj veprimit dhe efekteve negative të tij, nuk mund të veprohet me metoda administrative, disiplinore dhe organizative, pasi është mjaft vështirë të mbahet nën kontroll. Ndërkohë shqyrtimi i çdo veprimi dhe ballafaqimi i sjelljeve të punonjësit të policisë me kërkesat e ligjit procedural dhe me procedurat standarde të kryerjes së detyrës do të lehtësonte dhe parandalonte mjaft gabime dhe keqsjellje ndaj qytetarëve.

○ Sistemi i policimit në Shqipëri

Teorikisht, dallohen katër forma të policimit në një shoqëri demokratike: policimi që kryhet nga qytetarët (vetpolicimi i komunitetit), policimi nga policitë private, policimi prej policisë publike dhe policimi i policisë publike brenda kapaciteteve private. Sado që të gjitha këto forma janë hasur e mund të hasen nga koha në kohë, veç e veç ose të kombinuara, do të përqëndrohemi më tepër tek forma e policimit që kryhet nga policia publike, sepse ky jo vetëm është objektivi i këtij manuali, por edhe sepse juridiksioni ku e zhvillon veprimtarinë Policia e Shtetit është forma më e shtrirë dhe më e përhapur e policimit: në të gjithë hapësirën publike të shtetit dhe, sipas rastit e me autorizim ligjor, edhe në hapësirat private. Ndërkohë format e tjera të policimit në përgjithësi janë më të kufizuara në attribute dhe më pak të shtrira në hapësirë.

Nga ana tjetër, në shoqëritë demokratike, nuk është e pazakontë që njerëzit të marrin pjesë aktivisht dhe drejtpërdrejt në procesin dhe në sistemin e policimit, përveç forcave dhe shërbimeve, private e publike të ngarkuara nga ligji për të policuar në shoqëri:

Qytetarët-policë, në formën e vet më të herëshme, kishte pamjen e vetpolicimit të komuniteteve nga banorët për vetmbrojtje. Në ditët e sotme kjo formë haset në ato raste kur qytetarët reagojnë duke vetvepruar, për të kapur personat që kryejnë krime apo që prishin qetësinë në zonat e tyre të banimit. Kur qytetarët konstatojnë një krim të kryer soe në kryreje e sipër dhe njoftojnë policinë, duke vijuar të bashkëpunojnë më tej në procesin investigues, ata sërish në rolin e qytetarëve-policë, marrin pjesë aktive në policim.

Një tip tjetër i përfshirjes së qytetarëve në proceset dhe sistemet e policimit, reflekton doktrinën ligjore të *posse comitatus*, sipas të cilës qytetarët mund të thirren të ndihmojnë punonjësit e policisë publike, në kryerjen e detyrave të tyre. Kjo përfshirje, mund të risjellë në kujtesë imazhet e AGBV-e të periudhës totalitare, gjithashtu edhe grupet e bashkëpunimit qytetarë–sherif, që tregohen në filmat western. Megjithatë ai në fakt është më tepër se kaq; ai përfshin të gjithë qytetarët (jo vetëm grupe të përzgjedhura), që tregohen të gatshëm për të ndihmuar punonjësit e policisë, nëse u kërkohet një gjë e tillë.

Vigilantizmi është një shëmbull tjetër i pjesmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e zbatimit të ligjit. Historikisht, vigjiluesit kanë qënë më shpesh pjesarë të komuniteteve (psh, qytetarë, liderë biznesi ose fetarë) ose grupe njerëzish që kanë marrë në duart e tyre përgjegjësinë për zbatimin e ligjit dhe të normës shoqërore. Këto grupe zhvillohen si pasojë e perceptimit publik se sistemet egzistuese të zbatimit të ligjit kanë qënë të papërshtatshëm ose janë prishur dhe duke mos qënë efektive nuk i shërbejnë dot më tej intersave të vigjiluesve. Megjithse ky lloj pjesmarrje ka qënë

karakteristikë për shekujt e mesjetës së vonë dhe më dukshëm gjatë shekullit të 19, ai vazhdon të shfaqet herë-pas-herë edhe në ditët e sotme. Shëmbull tipik është “marrja në dorë” e situatës së rendit dhe patrullimi me blinda i i liderëve të grupeve të interesit dhe qytetarët e armatosur në rrugët e Tiranës, gjatë trazirave të vitit 1997.

Në formë të institucionalizuar me ligj, më shpesh ndeshen dy tipet më të përhapura të policimit - policia publike dhe policia private. Në Shqipëri, këto dy forma kryesore, u zhvilluan mbas viteve '90, me një larmi derivatesh:

Nga pikpamja e misionit, të gjitha policitë (në këtë pikpamje nuk ka dallim thelbësor as shërbimi informativ shtetëror) kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit (civil ose penal), me garantimin e sigurisë publike dhe shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për të gjitha është i domosdoshëm respektimi rigoroz i procedurave ligjore. Megjithatë ato ndryshojnë mjaft përsa i përket atributit të përdorimit të forcës. Edhe pse disa prej tyre, me ligj konsiderohen si shërbime të pajisura me mjete të ushtrimit të forcës dhe të armatosura me armë, e drejta për t'i përdorur këto mjete për qëllimin e zbatimit të ligjit është shumë e kufizuar.

Polici publike, quhen institucionet e administratës së shtetit dhe njerëzit e punësuar në to, të cilëve u delegohet me ligj e drejta e përgjithshme e përdorimit të forcës dhe armës, për të shtrënguar zbatimin e ligjit, brenda territorit të shtetit

Policia e Shtetit bën dallim, sepse në fakt është e vetmja që e gëzon këtë atribut të shtetit në të gjithë territorin dhe mbi të gjithë qytetarët. Atributi i policisë gjyqësore, më tepër sesa tipar dallues, është një angazhim ligjor i këtyre shërbimeve, për të zbatuar e respektuar ligjin procedurial dhe qëllimin e tij për balancimin dhe minimizimin e pabarzinë midis agjensive shtetërore dhe individit që shkel ligjin. Tipari që i dallon më tepër “policitë” në Shqipëri është juridiksioni i veprimtarisë së tyre. Me përjashtim të Policisë së Shtetit, të gjitha policitë e tjera kanë juridiksione ngushta e të preçizuara qartë. Në lidhje me tiparin e juridiksionit, ato afrohen më tepër me policitë private, sesa me policinë publike.

Polici publike quhet institucioni i administratës publike të shtetit, që punëson individë, të cilët përzgjidhen, aftësohen profesionalisht, grupohen, specializohen dhe paguhen me kohë të plotë; dhe që kanë si mision t'u shërbejnë interesave të të gjithë qytetarëve. Teorikisht, policia publike në shoqëritë demokratike mund të haset në forma të strukturave ushtarake (“Xhandarmëria” franceze, “Karabinieri” italiane, etj.) ose të organizimeve të shërbimit publik (psh “Policia e Shtetit” në Shqipëri, “Polizia di Stato” në Itali, “Police Nationale” në Francë etj.). Këto dy forma organizimi nuk prekin aspak karakterin demokratik të tyre, jo vetëm për faktin që ato formohen e kontrollohen nga ligji, por edhe për faktin se për policinë, natyrën dhe rolin e saj në demokraci, nuk ka aq rëndësi detyra që kryen sesa mënyra si e kryen detyrën e saj. Mënyra mund të jetë demokratike ose diktatoriale, mund të respektojë parimet demokratike të të drejtave themelore të njeriut ose mund t'i shkelë ato pa u ndëshkuar dhe pa kufizim.

Polici private janë ato organizata dhe punonjësit e tyre që ngarkohen dhe paguhen për të shërbyer në detyra dhe qëllime specifike, brenda fushës së zbatimit të ligjit. Punonjësi i policisë së shtetit, punonjësi i policisë bashkiake, punonjësi i policisë së shërbimit pyjor etj, janë punonjës të policisë publike, ndërsa policët që ruajnë bankat, një magazinë të një ndërmarrje prodhimi apo tregëtie, një dyqan bizhuterish, roja e një diskoteke apo pub, bodigardi i një biznesmeni apo një popstari etj janë policë privatë. Ka edhe raste, kur punonjësit e policisë publike, punojnë (kur e lejon ligji mbi dypunësimin) me kohë të pjesëshme, jashtë kohës së tyre të punës në sektorin publik, në kapacitete private. Më shpesh këta gjenden nëpër qendrat tregëtare, në klubet e natës, në dyqanet e bizhuterive dhe në diskoteka. Policia publike është pjesë e komponentit ekzekutiv të shtetit. (Ligji për Policinë e shtetit e konsideron si pjesë e administratës shtetërore ekzekutive).

1.1.1. Struktura dhe organizimi

Ashtu si kudo, edhe Policia e Shtetit, për shkak të natyrës së detyrave, të juridiksionit dhe të pritjeve të publikut, ka prirjen të ndjekë hap pas hapi strukturën e ndarjes administrativo-politike dhe gjeografike të shtetit. Çdo nivel i qeverisjes (qëndrore, rajonale, bashkiake apo komunale) ka forca policore, që i korrespondojnë organizimit dhe strukturimit administrativ gjeografik të shtetit, edhe në formën e organizimit dhe të shpërndarjes gjeografike të forcave të Policisë së Shtetit, edhe në formën e policive bashkiake ose të komunave (sikurse parashikon Ligji për Policinë Bashkike). Por megjithëse ndjek konfigurimin administrativ dhe ka një ndarje kompetencash në nivelet e ndryshme të organizimit policor nga njera anë, dhe të raporteve që krijon Policia e Shtetit me policitë e tjera, ajo ndjek shpesh edhe një linjë tjetër, si ajo e organizimit sipas tipit të problemeve dhe e specializimit të diferencuar në struktura që i korrespondojnë aspekteve të veçanta të zbatimit të ligjit. Është kjo arsyeja që Policia e Shtetit, gati përsërit strukturën administrative shtetërore, në nivele lokale dhe rajonale (psh ka një drejtori policie për çdo prefekturë, ka komisariate e posta policie për çdo bashki, edhe si një prirje e përgjithëshme e shoqërisë demokratike për decentralizimin e pushtetit tek qytetarët, edhe për një mbulim total me polici të territorit të shtetit, edhe për ta personalizuar policimin sipas problemeve dhe shqetësimeve të komuniteteve, edhe për tu demokratizuar më tej duke aplikuar parimin e delegimit të kompetencave në bazë). Ajo krijon gjithashtu edhe një larmi strukturash të ndërmjetme integruese për të reaguar sipas problemeve e shqetësimeve të përgjithëshme dhe sipas sferave të zbatimit të ligjit, të cilat ruajnë, në një farë mënyre, strukturimin tipik të çdo policie në një shtet të centralizuar (psh aplikon linjat vertikale të veprimit “nga qendra në bazë” në luftën kundër trafikëve, kontrabandës, krimit të organizuar; krijon taskforca integrale me policitë e tjera, për t’u përqëndruar në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta në shkallë shoqërie)

Veçori tjetër e Policisë së Shtetit është se ajo, megjithëse ka ngjashmëri në pikpamje të strukturës me çdo organ tjetër shtetëror të zbatimit të ligjit, ndryshon prej tyre nga tipi i veprimatrive dhe operacioneve që ka atributin të kryejë. Këto diferenca dhe veprime të ndryshme janë, së paku pjesërisht, pasojë e juridiksionit (statusi i shtrirjes ligjore) që ka policia e shtetit në çështjet e luftës kundër krimit dhe të mbajtjes së rendit. Edhe në pikpamje të atributit të policisë gjyqësore, sikurse vihet re edhe nga përshkrimi dhe krahasimi që bëme në tabelën më sipër midis policive, punonjësit e policisë së shtetit me ligj zenë segmentin më të gjerë të kësaj hapësire të zbatimit të ligjit.

Policia e Shtetit është në fakt organi më i përgjithëshëm i administratës shtetërore për zbatimin e ligjit, sepse ajo ngarkohet të investigojë pothuaj të gjitha shkeljet e ligjit penal në territorin e shtetit, me përjashtim të disa shkeljeve që i ndejk sëbashku me policitë e specializuara, ose i janë kaluar organeve të tjera shtetërore të specializara në fusha specifike. Një arsye tjetër e karakterit të përgjithëshëm të veprimatrisë dhe shumëllojshmërisë së shërbimeve që policia e shtetit ofron për qytetarët, është fakti se qoftë për traditë, qoftë për mundësitë praktike të shtrirjes në të gjithë territorin, Policia e Shtetit është në fakt i vetmi organ i administratës shtetërore, i disponueshëm 24 orë në 24 orë (*non stop*) si në nivelin qëndror, ashtu edhe në nivel qëndrash të banuara.

Komisariati i policisë ka përgjegjësinë ligjore për situatat e mbajtjes së rendit, të parandalimit dhe luftës kundër krimit, të rregullimit të qarkullimit të mjeteve dhe njerëzve në rrugët nacionale e lokale, në nivel njësie administrative vendore. Në relizimin e detyrave të veta ai bashkëpunon sipas raporteve të përcaktuara në ligje të veçanta, në akte nënligjore apo me taskforca me organet vendore të prokurorisë, të policive të tjera, me inspektoriatet, me shërbimin zjarrfikës për zbatimin e ligjit në nivelet vendore të qeverisjes.

○ Koncepti i “Rolit” të Policisë në Demokraci

Njohja e rolit dhe problemeve të policisë në shoqërinë demokratike, na pajis me kornizën e domosdoshme konceptuale për të shpërhaput mjegullën e keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve rreth tij dhe sidomos faktin që përmëndëm edhe më lart se policia e shtetit ka qënë dhe do të mbetet organi shtetëror më i gjerë në pikpamje të juridiksionit në zbatimin e ligjit dhe në gamën e shërbimeve

Problemi më kryesor i Policisë të një shoqërie demokratike, nuk është aq sasia e detyrave që jo kryen apo llojshmëria e shërbimeve që i ofron ajo publikut, sesa mënyra si i kryen ajo detyrat e ngarkuara ngaligji dhe si respekton e mbron standardet demokratike të shtetit ligjor, të drejtat dhe liritë e individit

që ofron. Për të arritur deri në një kuptim të tillë konceptual të rolit, janë përdorur vazhdimisht disa metoda sistematike e shkencore identifikuese.

Policia dhe policët janë përfaqësuesit kryesorë dhe më të dukshmit e sistemit të zbatimit të ligjit, në veprimet dhe marrëdhëniet me qytetarët. Policia dhe punonjësit e saj, gjatë kryerjes së detyrave, bëjnë njihen, të përshtaten dhe të zbatohen standardet ligjore, sipas kërkesave dhe pritjeve të publikut, me anën e të drejtës që punonjësit e policisë e zotërojnë sipas ligjit, për të marrë vendime në përputhje me situatën konkrete dhe njerëzit konkretë. Ata gjithashtu janë krahu, forca kryesore dhe mbështetja e komunitetit, në kohë krizash personale, ndërpersonale dhe publike. Për realizimin dhe përmbushjen e mandatit të saj, punonjësve të policisë u vihet në dispozicion me ligj monopoli i përdorimit të forcës ligjore. Policia plotëson gjithashtu edhe mjaft nevoja të shtetit, të qeverisjes dhe të shërbimeve sociale.

Gjatë kryerjes së detyrës, policia dhe punonjësit e saj, shpesh krijojnë marrëdhënie më të veçanta e specifike me disa qytetarë të komuniteteve të caktuara. Punonjësit e policisë, si rregull, merren ose me persona të rrezikshëm ose me persona që kanë nevojë për mbrojtje; me njerëz të zëmëruar ose të frikësuar; me qytetarë të dëshpëruar ose të dehur; me persona të dhunëshëm ose që e ndajnë veten të turpëruar dhe të fyer. Gjithashtu veprimet ose operacionet policore mund të ndikojë mbi dinjitetin dhe nderin e dikujt, mund të cënojnë të drejtën e jetës, të drejtën e privacisë ose të drejtat të tjera kushtetuese të çdo individit.

Në ditët e sotme, për shumë arsye, në mënyrë të posaçme për shkak të presioneve që bëjnë grupet shoqërore të interesit, për më tepër efikasitet nga Policia, vrehet një prirje për ta parë rolin e policisë në shoqëri, brenda detyrave të saj institucionale (p.sh., parandalimi, reduktimi dhe lufta kundër krimit në përgjithësi, mbajtja e rendit dhe të llojeve të veçanta të shërbimeve që duhet të kryejë në përgjigje të shqetësimeve më problematike), duke anashkaluar vlerësimin e mënyrave dhe mjeteve që ajo përdor për t'i realizuar detyrat: nëse ato janë të përshtatëshme apo kanë tendencën ta veçojnë policinë nga qytetarët dhe nga agjensitë e tjera shtetërore; nëse ato respektojnë vlerat dhe parimet e demokracisë apo i shkelin dhe i cënojnë ato.

Punonjësit e policisë janë të autorizuar nga ligji të përdorin forcën për të shtrënguar qytetarët t'i binden kërkesave të ligjit ose për t'i detyruar të përballen me pasojat e keqsjelljeve apo të krimeve dhe për vlerësimin e veprimtarisë së tyre nuk ka rëndësi ajo që bëjnë, por ajo se si e bëjnë punën e tyre, si i respektojnë ligjet dhe të drejtat e qytetarëve.

Çdo grup shoqëror ka nënkulturën e vet (një gjuhë specifike, një sistem vlerash dhe normash morale, tradita e zakone, mënyra jetese, kuptime mbi jetën dhe të tjerët si dhe kulturë materjale – orendi, bizhuteri, stile ndërtimi specifike).

Kultura dhe nënkulturat janë modele të vizioneve, besimeve, përfytyrimeve, perceptimeve dhe mjeteve të jetesës, që njerëzit i shpikin, i zbulojnë ose i prodhojnë me qëllim që t'i përdorin në zgjidhjen e problemeve të integritetit të brendshëm të grupeve, për forcimin e solidaritetit të tyre dhe për tu përshtatur me problemet e mjedisit rrethues social e natyror. Ky model provohet të jetë aq i dobishëm sa që grupet ua përcjellin brezave si mopedelin e tyre të bashkëjetesës në shoqëri

Teorikisht policia përkufizohet:

Tërësia e punonjësve dhe institucioni, të cilëve u është deleguar me ligj e drejta e përgjithëshme për të ushtruar shtrëngimin dhe forcën brenda territorit të shtetit, për zbatimin e ligjit dhe për të reaguar ndaj konflikteve individuale e grupore që shoqërohen me sjellje të paligjëshme. Natyrisht që përdorimi i shtrëngimit dhe forcës, nuk është mënyra dhe mjete i vetëm që përdor policia. Ajo ka në dispozicion dhe përdor edhe mjaft mjete e mënyra të tjera, por është pikërisht kjo e drejtë e përgjithëshme që i dallon nga organe e agjensi të tjera shtetërore dhe nga punonjësit e tyre. Më poshtë po përcjellim disa nga aspektet më kryesore të rolit të policisë në shoqëri: pritjet shoqërore të pajtueshme dhe konfliktuese, debatet periodike publike mbi rolin e policisë, vlerat, qëllimet, objektivat dhe strategjitë.


1.1.2. Modeli Pritje-Integrim

“Roli” i Policisë është “pjesa që pritjet të luajë ajo në një shoqëri demokratike”. Ka të paktën tri burime kryesore nga të cilat përcaktohen pritjet e rolit në lidhje me atë që duhet të bëjë dhe si duhet ta bëjnë detyrën punonjësit e policisë: mjedisi social, organizata policore dhe ligji. Figura paraqet një përshkrim të modelit **pritje-integrim**. Secili kuadrat i brendashkruar tregon një shkallë të ndryshme të integritimit të mundshëm: *thelbësor, i pjesëshëm ose minimal*. Në vartësi të shkallës në të cilën janë integruar pritjet e rolit midis këtyre tri burimeve (nëse ato janë të përbashkëta ose konfliktojnë me njera tjetrën), është edhe shtrirja e konflikteve të rolit të policisë – në rritje ose në ulje. Kur pritjet janë të përputhëshme në të tri burimet, ka pak ose aspak vështirësi për të përcaktuar se çfarë duhet dhe si duhet ta bëjë punën e vet policia.

1.1.3. “Pritjet” mjedisore

Ajo çfarë presin (ose “pritjet”) qytetarët dhe ligji, tendencat dhe problemet sociale në përgjithësi dhe ato që lidhen me çdo komunitet në veçanti, krijojnë një mjedis social. Tendencat e ndryshimit social dhe ekonomik dhe problemet që ka shoqëria e në veçanti komuniteti, shpesh herë influencojnë dukshëm mbi policinë. Të tilla mund të jenë rritja e shpejtë e popullsisë, rënie të karakterit ekonomik, probleme lidhur me drogën apo me trafiket, shtimi i rasteve të dhunës dhe i grindjeve midis të rinjëve në shkolla, sjelljet e rrugaçerisë nga të rinjtë nëpër rrugë dhe në lagjet e banimit etj. Megjithëse këto prirje dhe probleme sociale, në vetvete nuk përbëjnë pritje për rolin e policisë, vetëdija kolektive dhe ndërgjegjësimi i policisë ose i qytetarëve për çështje të tilla shqetësuese mund të shkaktojë rritje të interesimit dhe debatit rreth faktit sesi duhet të reagojë policia.

Mjedisi komunitar përmban në vetvete probleme mjaft specifike, që variojnë nga komuniteti në komunitet: të tjera probleme kanë organizatat private e të tjera ndeshin organizatat publike dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit; të tjera probleme perceptojnë liderët e zgjedhur e të emëruar dhe grupet e interesit; të tjera probleme kanë banorët në zonat e banimit në lagjet e qyteteve dhe të tjera banorët nëpër fshatra, madje problemet dhe shqetësimet ndyshojnë nga individ në individ. Edhe vetë koncepti “**komunitet**” merr kuptime të ndryshme, jo vetëm si hapësira administrative të përfshira ligjërisht në një qytet apo fshat, por edhe si individë që jetojnë në të njëjtën lagje apo zonë, që punojnë



në të njëjtën organizatë biznesi, grupet dhe kategoritë sociale (psh pjesëtarët e një grupi etnik, grupet fetare, të rinjtë, gratë dhe të moshuarit), etj.

Paralel me proceset demokratike, qytetet e mëdha shiptare po bëhen gjithnjë e më të ndryshëm dhe më heterogjenë, si rezultat i zhvendosjes individuale dhe grupe të njerëzve nga fshtati drejt qyteteve dhe nga një qytet periferik drejt metropolit. Për këtë shkak policia po haset në probleme sociale specifike, që e kanë burimin në këtë karakter multikulturor të zonave të banuara qytetëse dhe periferike. Ndryshimet në gjuhë dhe në dialekte, diferencat në këndvështrimet nënkulturore kanë sjellë nevojën për ndryshime substanciale në policinë e shtetit. Ajo nuk mund të reagojë më me ato mjete dhe mënyra siç reagonte në lagjet dhe periferitë homogjene e të strukturuar qartë të periudhës së diktaturës. Pengesat dhe kufizimet, që vendoste diktatura për zhvendosjen e popullsisë, kishin konfiguruar një mjedis social pak a shumë të qëndrueshëm e homogjen nga pikpamja kulturore. Banorët e një lagje apo blloku banimi e njihnin të gjithë njeri tjetrin, ndjeheshin “fqinjë”, kishin marrëdhënie të ngushta me njeri tjetrin dhe ndanin bashkë hidhërimet e gëzimet.

Sot, mbas 15 vjetësh transformimesh dhe lëvizjesh demografike, është vështirë të hasësh blloqe apo zona banimi me një konfigurim të tillë (ato mund t'i gesh ende vetëm në disa fshatra). Në një situatë të tillë të mjedisit social, policisë i duhet të ndërveprojë me efektivitet me të gjitha këto grupe e individë kaq të ndryshëm, dhe jo vetëm kaq, por i duhet të manaxhojë e të përpiqet të ndikojë në zgjidhjen e konflikteve midis këtyre grupeve.

Shpesh punonjësve të policisë u duhet të merren me konflikte të pronës midis banorëve të një zone banimi apo me problemet e dhunës familjare, që shpërthejnë herë pas herë në ato zona. Nuk është e thënë që konflikte të tilla ta kenë burimin tek traditat e mbartura, (shumë konflikte familjare e ndërfamiljare, kulturat homogjene i zgjidhin brenda grupeve me mjetet e tyre morale, ndërsa në mjediset e reja të banimit, të ardhurit nuk e kanë më atë kontroll të institucioneve morale të grupit, të mjedisëve të tyre të origjinës), ato zakonisht lindin si një përplasje nënkulturash midis të ardhurve apo me vendasit, jo vetëm për probleme të rëndësishme jetike si prona, por edhe për shkaqe mjaft banale.

Një nga problemet më të rëndësishme me të cilat ndeshet policia në mjedisin e sotëm urban, është marrëdhënia e policisë me ato komunitete që, sipas këndvështrimit policor, kanë në përbërjen e tyre një numur të madh të personave të dyshuar apo të individëve që mbajnë qëndrime armiqësore, kritike apo indiferente ndaj policisë dhe veprimeve të punonjësve të saj. Ky tip konflikt midis policisë dhe komunitetit është më i ndjeshëm në zonat periferike të mbipopulluara me të ardhur dhe në zonat ku banojnë minoritete etnike apo racore.

Çdo komunitet është i kompozuar nga individë qytetarë, pritjet e të cilëve ndaj policisë, përcaktohen sfondi i tyre arsimor dhe edukativ, nga eksperiencat personale, nga eksperiencia e familjes, nga miqtë, nga përkatësia politike, racore e fetare, nga media etj. Secili prej tyre hyn në kontakte dhe në marrëdhënie me punonjësit e policisë të paktën në gjashtë mënyra: ① si një i dyshuar për shkelje të ligjit, ② si viktimë, ③ si informues apo si njeri që lajmëron policinë për shkeljen e ligjit, ④ si dëshmitar okular, ⑤ si një kureshtar apo spektator, ose ⑥ si një qytetar që është i interesuar të influencojë në politikat dhe praktikat e policisë. Në secilin nga këto gjashtë role, pritjet e qytetarëve ndaj policisë mund të kenë diferenca të shumta dhe të mëdha, psh pritjet e viktimës ndryshojnë nga ato të të dyshuarit, prijët e dëshmitarit ndryshojnë nga ato të kureshtarit. Më tej akoma, pritjet e qytetarëve mund të paraqiten si qëndrime të arsyeshme të njerëzve të mirëinformuar rreth detyrave dhe rolit të policisë, ose mund të prezntohen si pritje të njerëzve të painformuar, që i besojnë më shumë vetgjësisë e vetshërbimit apo të mbushur me paragjykime.

1.1.4. Pritjet organizative

Pritjet organizative burojnë kryesisht nga dy drejtime brenda organizatës policore, edhe nga aspekti formal (zyrtar) i saj, edhe nga aspekti i saj informal (shoqëror e miqësor). Pritjet formale rrjedhin nga drejtuesit e policisë, nga përgjegjësitet dhe shefat sektorialë, nga programet e shkollimit profesional,

nga qëllimet, objektivat, politikat, procedurat dhe rregulloret e policisë. Pritjet informale rrjedhin nga presionet dhe shkëmbimi i eksperiencave midis kolegëve dhe miqëve si dhe nga grupet e punës. Punonjësit e policisë influencohen në një masë të konsiderueshme nga eksperiencia e tyre e punës dhe nga mënyrat se si përshtasin kërkesat e tyre emocionale, psikologjike, fizike dhe intelektuale me kërkesat e punës, me vështirësitë e detyrave dhe me njeri tjerin. Atyre u duhet të përpiqen ta bëjnë punën e tyre, në atë mënyrë, që të jetë e pranueshme edhe nga aspekti zyrtar e ligjor i policisë, edhe nga shokët dhe kolegët; atyre u duhet të përpiqen të mos dëmtohen, të mos plagosen ose të mos vriten dhe më tej akoma u duhet që sjellja dhe qëndrimet e tyre të mos provokojnë ankesa nga qytetarët.

Të gjitha sëbashku, pritjet organizative (formale dhe informale), influencojnë dukshëm në krijimin e kulturës organizative që përkufizohet si “modeli i supozimeve, i vlerave, i besimeve dhe normave themelore të një grupi të dhënë [policia], që shpiken, zbulohen ose përpunohen, përgatiten dhe transmetohen përmes proceseve të të mësuarit dhe trainimit, me qëllim që të përdoren si mënyra dhe zgjidhje të gatëshme, për të përballuar problemet e përshtatjes me mjedisin publik rrethues dhe me problemet e integritetit të brendshëm, dhe që në përgjithësi konsiderohet i pranueshëm, i dobishëm dhe funksional”.

Vlerat dhe besimet e kësaj kulture kanë të bëjnë me atë që punonjësit e policisë konsiderojnë si më të rëndësishme dhe me qëndrimet që duhet të mbajnë ndaj punës dhe organizatës policore. Normat që respektojnë punonjësit e policisë gjatë punës së tyre, së bashku me vlerat dhe besimet bëhen bazat mbi të cilat ndërtohet gjithë matura e tyre profesionale në vendimmarrje. Në praktikën e punës së përditëshme, jo të gjitha pritjet organizative formale (ato që rrjedhin nga standardet etike dhe nga ligji) dhe që kanë të bëjnë me arritjen e një rezultati të përshtatshëm në kryerjen e detyrave janë të inkuorpuara dhe të përveçësura si vlera, besime dhe norma nga punonjësit e policisë. Kjo përbën një nga shkaqet kryesore të ndryshimit që ekziston midis prirjeve organizative formale me sjelljet reale të punonjësve.

Vleftëshmëria dhe efikasiteti i pritjeve formale, institucionale (për të qënë me të vërtetë të përveçësueshme nga të gjithë punonjësit e policisë) duhet të “testohen” së pari në realitetin e “rrugës”. Përvojat më të përparuara tregojnë se pritjet organizative formale jo gjithmonë e kalojnë këtë testim të realitetit. Si përfundim duhet theksuar se sjelljet e punonjësve të policisë influencohen jo vetëm nga ajo që pret policia prej tyre (edhe pse në përgjithësi pritjet organizative formale marrin forma detyruese, shtrënguese dhe ndëshkuese, të cilat në testin e realitetit nuk bëjnë tjetër veçse nxisin fantazinë dhe mënyrat e parregullta për t’iu shmangur ndëshkimeve), por të gjithë komponentët, me të cilët ndërtohet kultura e organizatës policore.

Studimet e viteve 1991–1995 në Gjermani, Kanada, Austri, Belgjikë e SHBA, treguan se koha e përdorur për ndalime dhe shoqërime, zë vetëm ½ e aktiviteteve të kryera gjatë një muaji nga policia. Sipas studimit, shansi që një punonjës policie të jetë pjesmarrës në një veprim kriminal imediat, është shumë i ulët.

Sipas British Home Office, një punonjës policie në Londër, i duhet të presë një herë në tetë vjet, për t’u ndodhur brenda rrezes 100m, të një vjedhje me thyerje.

Në Belgjikë, më pak se 20% e të gjithë ndërhyrjeve të policisë, është kohë e shpenzuar për veprime proaktive, krahasuar me veprimet reaguese, ndaj kërkesave të publikut dhe autoriteteve lokale për ndërhyrje nga policia.

Në Gjermani, është rutinë e përditëshme që policia të jetë e pranishme në tipe të ndryshëm aksidentesh, ngjarjesh dhe shkeljesh të rregullve të qarkullimit rrugor. Përqindja varion midis 25% dhe 60%, sipas qyteteve. “Flagranca”, ndodhja e policisë në vendin e ngjarjes është midis 16% dhe 28%. Grindjet dhe zënkat kanë një shtrirje gati të njëjtë me rreth 25%.

Aktiviteti që zë përqindjen më të madhe të kohës në marrëdhëniet me qytetarët është shkëmbimi i informacionit: ① qytetarët japin informacione që nuk kanë të bëjnë me krimin (16%), ② qytetarët i kërkojnë policisë informacion (23%). Njoftimet për veprime kriminale zënë vetëm 18% të arsyeve për të kontaktuar me policinë.

Nga të dy funksionet e policisë: zbatimi i ligjit dhe mbajtja e rendit, në realitet, funksioni i rendit luan një rol mbizotërues. Megjithatë, në publik, në media dhe diskutimet politike, vënë më tepër në dukje funksionin e “zbatimit të ligjit”, veçanërisht në lidhje me demonstrimet, terrorizmin, trafiket, krimin e organizuar etj.,

Një përbërës i rëndësishëm i kulturës organizative (pjesa informale e saj) janë pritjet e grupeve të miqëve që formohen midis punonjësve të policisë, në të cilat vendin kryesor e zënë pritjet individuale. *Pritjet individuale* kanë të bëjnë me këndvështrimet personale të punonjësve të policisë në lidhje me shkallën në të cilën trajtohen dhe merren në konsideratë nevojat e tyre nga organizata dhe mjedisi i tyre i punës. Të gjithë punonjësit e policisë, si çdo punonjës tjetër në administratën publike apo në biznesin privat, presin të trajtohen me ndershmëri, pa paragjykime, me paanësi, si dhe të shpërblehen në mënyrë të përshtatëshme për punën që kryejnë. Në përputhje me këto pritje, ata përpunonjë opinionet e tyre mjaft të forta dhe të qëndrueshme rreth asaj se si duhet bërë puna në polici, pra cilat ligje duhen zbatuar dhe si duhen zbatuar: si dhe ku do të përdoret diskrecioni profesional, e kështu me radhë. Pritjet e çdo individi dhe grupi të punonjësve, me nevojat dhe opinionet e tyre, së bashku me pritjet formale organizative, kombinohen së bashku për të krijuar kulturën organizative. Është kjo kulturë organizative terreni ku lindin, përpunohen dhe aplikohen vlerat bazë dhe qëndrimet rreth rolit të policisë, strategjitë dhe metodat e policimit efektiv dhe standardet e sjelljeve etikologjore.

1.1.5. Pritjet ligjore (sistemi legjislativ)

Pritjet ligjore i vijnë policisë nga ligjet organike, nga ligji proçedural penal dhe nga kërkesat ligjore të çështjeve civile (psh ekzekutimet e vendimeve gjyqësore civile, kërkesat apo marrëveshjet për bashkëpunim me policinë e tjera). Këto përbëjnë kornizën bazë ligjore mbi të cilën vepron Policia e Shtetit. Por, në praktikë, punonjësit e policisë nuk u referohen gjithmonë e në mënyrë strikte ligjeve, ngaqë shpesh përdorin diskrecionin profesional, duke vendosur vetë cilat ligje apo nene të ligjit do të zbatohen dhe si do t'i zbatohen. Për më tepër, përvoja dhe studimet tregojnë se vendimet e bazuara në diskrecionin profesional, jo gjithmonë janë të përputhura me ato që pret ligji, organizata dhe komuniteti. Megjithatë punonjësit e policisë mund të mos e ndjekin gjithmonë pikëpërpikë dhe në mënyrë eksplicite ligjin, pritjet ligjore kanë influencën thelbësore në atë çfarë bëjnë dhe si sillen punonjësit e policisë. Ata përgatiten teorikisht dhe praktikisht për një influencë të tillë.

Përpjekjet për të integruar pritjet mjedisore, organizative dhe ligjore kanë çuar në një sërë debatesh e diskutimesh rreth rolit të policisë në shoqërinë demokratike. Tri nga debatet më të përhapura trajtohen më poshtë.

- **Debatet rreth rolit të policisë në shoqërinë demokratike**

Tri kanë qënë debatet më kryesore që janë zhvilluar e zhvillohen rreth “rolit” të policisë në shoqërinë demokratike. Palët e përfshira në secilin prej këtyre debave kanë pasur influencën e tyre në përkufizimin e rolit të policisë dhe në aplikimin e modeleve të ndryshme që i korrespondojnë përfundimeve të arritura; forca dhe shtrirja e kësaj influence ka ndryshuar në vartësi të shoqërisë, të komunitetit dhe të periudhave të kohës kur është aplikuar.

1.1.6. Ligjor apo Politik?

Cila është mënyra më e mirë për ta integruar rolin e policisë në shoqërinë demokratike? Në ekstremet e debatit vrehen dy alternativa: mënyra e orientuar sipas ligjit dhe mënyra reaguese mbi bazën e përgjegjësive politike dhe e individualizuar. Mënyra më e herëshme është këndvështrimi ligjor (ose burokratik, ose gati-ushtarak, ose profesionist, ose reformues), kurse këndvështrimi politik është i mëvonshëm.

Koncepti mbi rolin e policisë i ndërtuar brenda këndvështrimit ligjor nënkupton që drejtësia është rezultat i aplikimit të qëndrueshëm të ligjeve, të linjave të përgjithëshme të veprimit, të prioritetëve dhe proçedurave policore. Teorikisht, ligjet, politikat dhe proçedurat janë të pëpunuara në mënyrë racionale dhe të çliuara nga çdo lloj paragjykimi, njëanëshmërie dhe ndikimi, të cilat do t'i bënin të mos përputheshin plotësisht me parimet themelore të shoqërisë demokratike.

Këndvështrimi politik ndërtohet mbi njerën nga dy hipotazat: ① ligji dhe policia para së gjithash u shërbejnë interesave të grupeve apo personave me influencë të shoqërisë ose komunitetit. Persona apo grupe të tilla konsiderohen sipas kësaj hipoteze, të jenë mbi ligjin, ndërkohë që për të tjerët

kërkojnë të trajtohen me rreptësi nga ligji dhe policia. Kjo pikpamje, pa dyshim çon në ndërtimin e politikave të policimit diferencuese dhe diskriminuese. ②Hipoteza e dytë vendos theksin mbi përgjegjshmërinë dhe individualizimin. Përkrahësit e kësaj pikpamje argumentojnë se zbatimi strikt i ligjeve (fjalë për fjalë dhe pa dallime) nuk merr në konsideratë karakterin specifik të problemeve dhe të nevojave mjaft të veçanta e të dallueshme që kanë qytetarët, grupet e banorëve dhe komunitetet specifike. Sipas këtij këndvështrimi, qëndrimet konsekuente e strikte nuk janë të nevojshme dhe problemet që mund të shkaktohen nga trajtimet preferenciale dhe diskriminuese mënjanojnë, nëse punonjësit e policisë janë profesionistë të mirëpërgatitur për të kryer detyrat e tyre. Më tej argumenti lidhet me kërkesën që reagimet policore duhet të jenë plotësisht të bazuara tek ligji dhe në funksion të kontekstit social të ngjarjes, të vlerave dhe normave morale të komunitetit, kur është fjala për të ndërhyrë e reaguar ndaj problemeve të atij komuniteti specifik.

Ky debat midis këndvështrimeve ligjore e politike të rolit të policisë pasqyron e nxjerr në pah tensionin e vjetër të shoqërive demokratike – atë të shtetit ligjor përballë pritjeve të komuniteteve të veçanta. Në një ekstrem qëndron polici burokrat i pandjeshëm, që nuk devijon asnjëherë nga rregullat dhe që nuk kërkon opinione nga askush për të përcaktuar se cilat ligje janë të rëndësishme dhe si duhen zbatuar ato. Burokrati ka prirjen t'i zbatojë rregullat gjithmonë njëjloj, pavarësisht nga qytetarët dhe nga rrethanat. Në anën tjetër qëndron rregulli i turmës (turma është gjithmonë zoti i rrugës).

Teorikisht, pakënaqësia publike rritet gjithmonë në periudha ndryshimesh sociale. Por në shoqërinë demokratike pluraliste, ku interesat janë gjithmonë konkurrese dhe ku plotësimi i tyre me shërbime i kërkohet shtetit, ndryshimet mund të duan një kohë të konsiderueshme. Nga ana tjetër mund të ndodhë që ato të dështojnë e të mos plotësohen të gjitha. Për pasojë, ata që kanë për detyrë të ofrojnë shërbime sociale ndaj qytetarëve individualë dhe komuniteteve, vihen shpesh në rolin e rrobaqepësit që thirret për të riparuar “rrjetën e grisur sociale” të komuniteteve të veçanta. Por si do të mundin ta bëjnë një gjë të tillë pa përdorur një trajtim preferencial (sipas rastit) për disa (individë, grupe, lagje banimi) pa bërë dallime dhe pa diskriminuar të tjerët? Përgjigja për një pyetje të tillë mbetet e paqartë dhe varion nga fakti se si duhet, madje nëse duhet ofruar një shërbim i kërkuar.

Këndvështrimi ligjor dhe dy hipotezat e këndvështrimit politik mbi rolin e policisë në shoqëri evidentojnë tri tipe të mundëshme të marrëdhënieve polici-komunitet.

Modeli politik i referohet marrëdhënieve polici-komunitet, të cilat janë të mbarsura me probleme të trajtimit preferencial, diskriminim dhe korrupsion.

Modeli ligjor që bazohet mbi supozimin se influencat politike mbi policinë ndikojnë për keq në marrëdhëniet e policisë me komunitetin duke i shfityruar në marrëdhënie preferenciale e diskriminuese. Për këtë arsye marrëdhëniet me komunitetin dhe qytetarët duhet të jenë të strukturura, të institucionalizuara dhe burokratike.

Modeli i policimit komunitar bazohet mbi aritjen e mirëbesimit dhe përkrahjes publike nga ana e policisë duke e bërë atë më të përgjegjshme, të gatëshme dhe të orientuar ndaj nevojave të individëve dhe grupeve të qytetarëve, pa u angazhuar në trajtime preferenciale, paragjyquese dhe diskriminuese.

1.1.7. Luftëtar antikrim apo punonjës i shërbimit publik?

Debati nëse policia duhet të merret vetëm me luftën kundër krimin apo duhet edhe të ofrojë gjithashtu edhe shërbime publike influencon në vnedosjen e prioriteteve që duhet të kenë veprimtaritë dhe strategjitë e policisë, mbi tipin e personelit që duhet përzgjedhur, mbi mënyrat si duhet trainuar e shkolluar ky personel dhe në stilet (mënyrat se si kuptohet e perceptohet deytra) e policimt që do të kenë punonjësit.

Punonjësit e policisë që e konsiderojnë veten si **luftëtarë antikrim** besojnë se krimi është pasojë dhe funksion i përzgjedhjes së vetdijshme të bërë nga kriminelët dhe detyra e tyre është të mbajnë nën kontroll, të gjurmojnë, të zbulojnë dhe të ndalojnë shkelësit e ligjit.

Punonjësit që e konsiderojnë veten si **punonjës të shërbimit publik** besojnë se krimi është një rezultat i një numuri faktorësh (jo vetëm personalë) dhe se ka edhe mjaft mundësi të tjera për të kryer detyrat e policisë duke u përfshirë në veprimtari të tilla si parandalimi i krimit përmes edukimit dhe bashkëpunimit me komunitetin për të zvogëluar nivelet e krimit. Orientimi i shërbimit publik priret të arrijë objektivat e policisë përmes përfshirjes së komunitetit dhe bashkëpunimit me të dhe është këndvështrimi më pak agresiv dhe më pak autoritarist i policimit.

Natyrisht, sidoqë në praktikë nuk ka stile të pastra, vetëm **luftëtarë antikrim** apo vetëm **punonjës të shërbimit publik**, besohet se punonjësit e policisë janë, ose së paku duhet të jenë nën influencën e njerit apo tjetrit këndvështrim mbi rolin e policisë në komunitet. Shpesh pritjet e rolit varen nga burimi.

Disa komunitete, lagje apo grupe shhoqërore mund të presin që punonjësit e policisë të jenë luftëtarë antikrim, ndërsa disa të tjera dëshirojnë që ai të lozë rolin e punonjësit të shërbimit publik. Gjithashtu vetë punonjësit e policisë ta konsiderojnë veten e tyre më shpesh si luftëtarë antikrim sesa si punonjës socialë. Përpjekjet për të zgjidhur këtë debat kanë rezultuar në një numur kërkimesh shkencore mbi detyrat dhe veprimtarinë e policisë.

Duke filluar diku aty nga vitet '60, përkrahësit e pikpamjes mbi një rol të policisë më të theksuar si një shërbim publik, argumentojnë se punonjësit e policisë shpenzojnë një kohë më të pakët për të reguar realisht ndaj krimit, në krahasim me aktivitetet e tjera. Ky pohim vjen si rezultat i një numuri studimesh të zhvilluara në përpjekje për të kategorizuar aktivitetet e policisë, si zbatimi i ligjit; lufta kundër krimit; shërbimet publike dhe plotësimi i dokumentacionit (hartim i raporteve, plotësimi i dosjeve procedurale). Sidoqë nga studimet u arrit në përfundime kontradiktore përse i përket kategorizimit të aktiviteteve – psh nëse duhet që veprimet e patrullimit në përgjigje të një thirrje për prishje të rendit, por që nuk rezultojnë me shoqërimin apo ndalimin e askujt për vepra penale, duhen kategorizuar si aktivitete antikrim apo si shërbime – në drejtim të identifikimit të kohës së shpenzuar nga punonjësit e policisë për veprime dhe aktivitete të ndryshme, ishin të dobishme për konkluzionet që arritën.

1.1.8. Proaktiv apo Reagues?

Veprimet proaktive të policisë theksojnë aspektin e iniciativës të punonjësit apo sektorit të policisë. Nga ana tjetër veprimi reagues është më i përqëndruar tek reagimi ndaj një problemi, kur qytetarët paraqesin një kërkesë të specifike për ndihmë. Vendosja e një gjobe, shoqërimi i një të dyshuari, ndalimi i një të kërkuari, arrestimi në falgrancë i një keqbërësi apo kriminelin janë veprime proaktive. Përpunimi i një plani masash për të reaguar (disa herë kjo quhet pa të drejtë parandalim) ndaj një krimi apo ndaj një problemi, duke e penguar atë të ndodhë, është veprim proaktiv. Planet dhe veprimet kurth nën koperturë janë po aq proaktive sa edhe mbajtja nën mbikqyrje të dyshuarit me karriera kriminale apo e atyre që lënë shkollën dhe bredhin rrugëve duke bërë vjedhje të vogla xhепash ose grabitje. Përgjigja dhe reagimi ndaj problemeve specifike që bazohen në kërkesat e qytetarëve dhe ndjekja e tyre deri në fund janë veprime reaguese.

Ajo që e bën problematik veprimin proaktiv të policisë, është fakti se ai e paraqet policinë me një pamje bezdisëse përballë komunitetit; pasi ajo mund të iniciojë veprime, të marrë kontakte dhe mund të “shqetësojë” banorët, pa pyetur përfaqësuesit, liderët dhe njerëzit e interesuar në komunitet. Nga ana tjetër disa veprime proaktive (veprimet proaktive, të fshehta e të drejtuara ndaj personave konkretë të gjurmimit e zbulimit të krimit) përmbajnë rrezikshmëri potenciale për respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve, pasi bartin mundësi për abuzim me detyrën. Megjithatë, një shtet demokratik e ligjor e mban nën kontroll dhe vendos kufizime ligjore për të shmangur abuzimet e keqkuptimet me veprimin proaktiv, ai përsëri mbetet problematik.

Sa më demokratik të jetë sistemi ligjor, aq më shumë natyrë reaguese ka mobilizimi ligjor.

Sa më shumë ngushtohet pushteti qëndror, sa më shumë marrin rëndësi të drejtat dhe interesat e qytetarëve, aq më shumë ndodh që qytetarët të vendosin se në cilat raste duhet të ndërhyjë ligji dhe polici si përfaqësues i tij.

Cila është më afër demokracisë nga këto dy mënyra dhe këndvështrime të veprimit policor: një forcë policore para së gjithash reaguese apo një forcë policore në thelb proaktive? Megjithatë eliminimi i të gjithë veprimeve proaktive (psh vënia e gjobave, veprimet dhe operacionet për kapjen e personave shumë të kërkuar dhe me mandate arresti, operacionet kundër trafikëve të paligjshme dhe krimit të organizuar) nuk ka gjasa të ndodhë, është e mundur të kufizohen në numur cënimet e jetës private dhe të drejtave të tjera themelore të qytetarëve, me iniciativën e policisë dhe pa miratimin e organeve kompetente. Është mjaft e rëndësishme të dallohet e të veçohet shkalla në të cilën policia vepron me metoda proaktive në përgjigje të nevojave dhe të pritjeve të komunitetit, nga përdorimi i këtyre metodave si pasojë e çështjeve dhe shqetësimeve që ka policia. Në disa raste, profesionalizmi i policisë është parë e shihet i lidhur me të qenit proaktiv. Një gjë, megjithatë është shumë e qartë, sa më proaktive të paraqitet policia, aq më “bezdisës” perceptohen punonjësit e saj nga qytetarët, dhe sa më shumë ata të duken të tillë në sytë e qytetarëve, aq më i madh është risku për punonjësit e policisë, për qytetarët dhe për vetë demokracinë.

Me qëllim që të arrihet në një konkluzion mbi rolin e policisë dhe në përpjekje për t’i dhënë një përgjigje debatit rreth këtij roli, policia duhet të integrojë tërë diversitetin dhe shumëllojshmërinë e pritjeve sociale të rolit të saj, në procesin e identifikimit, të përcaktimit dhe të klasifikimit të vlerave, qëllimeve e strategjive të veta.

- **Vlerat, qëllimet dhe strategjitë**

Vlerat janë vizione, cilësi e standarde themelore, të dëshiruara e të pranuar gjerësisht nga qytetarët, shoqëria dhe ligji, që duhet të udhëheqin policinë e punonjësit e saj gjatë ushtrimit të maturisë në vendimmarrje. Vlerat e policisë janë gjithashtu pikat e referencës mbi të cilat përcaktohen misioni, qëllimet dhe objektivat se si do të përdoren resurset njerëzore e materiale, si do të përcaktohen strategjitë afatshkurtesë e afatgjata dhe si do të jetë sjellja në punë e punonjësve të policisë. Për ta ilustruar një ndikim të tillë të mundshëm mbi rolin e policisë në një shoqëri demokratike, në tabelën më poshtë janë paraqitur dy grupe vlerash themelore. Lista e grupimit të parë priret ta përshkruajë punën policore si një veprimtari ligjzbatuese të përqëndruar kryesisht tek lufta kundër krimit dhe që kërkon punojës policie të tipit “luftëtar antikrim”, me një komponent legalistik në marrëdhëniet me komunitetin. Lista e dytë sugjeron një punonjës policie që shërben më shumë si punonjës të shërbimit publik, sesa si “luftëtar antikrim” dhe një polici që vihet në mbështetje të përmirësimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve polici-komunitet.

Tabela: Vlerat e policisë në shoqërinë demokratike

<ul style="list-style-type: none"> ● Vlerat e orientuara tek shtrëngimi ligjor (<i>policimi profesionist</i>) <ol style="list-style-type: none"> 1. Autoriteti i policisë bazohet tek ligji dhe objektivi i saj primar është zbatimi i ligjit. 2. Komuniteti duhet t'i japë policisë përkrahjen e nevojshme për të zbatuar ligjin. 3. Reagimi i punonjësve të policisë ndaj thirrjeve dhe urdhërve të shërbimit ka prioritet të lartë dhe ndaj çdo urdhëri të marrë duhet reaguar sa më shpejt që të jetë e mundur. 4. Problemet sociale dhe shqetësimet e komunitetit nuk janë përgjegjësi e policisë, përderisa ato nuk përbëjnë kërcënim për rendin publik apo nuk shkelin ligjin penal. 5. Punonjësit e policisë, si ekspertë, janë më të mirët për të përcaktuar prioritetet dhe strategjitë e kontrollit të krimit.
<ul style="list-style-type: none"> ● Vlerat e orientuara drejt komunitetit (<i>policimi komunitar</i>) <ol style="list-style-type: none"> 1. Policia do ta përfshijë komunitetin në të gjitha ato aktivitete dhe veprimtari të saj (edhe gjatë hartimit të strategjive dhe linjave të përgjithshme të veprimit), të cilat prekin e kanë të bëjnë me përmirsimin e cilësisë së jetës së përbashkët komunitare. 2. Policia beson se strategjitë e saj duhet të mbrojnë e të zhvillojnë vlerat. 3. Policia duhet të strukturojë kryerjen e shërbimeve ndaj komunitetit, që të forcojë anët pozitive të zonave të banuara dhe të shfrytëzojë zellin e banorëve për të bashkëpunuar. 4. Punonjësit e policisë duhet të kenë informimin e përshtetshëm për çështjet, që kanë të bëjnë me efektivitetin, cilësinë dhe sadsifaksionin e punës së tyre.

Ndryshe nga vlerat, që janë më të përgjithshme dhe të shtrira në kohë, qëllimet e objektivat janë konkrete në atë që përmbajnë në drejtim të resurseve, atributëve dhe përgjegjësive. Qëllimet përfaqësojnë zbrëthimin dhe diferencimin e detajuar të mandatit ligjor të policisë sipas shërbimeve dhe sektorëve. Por të përdorura si këndvështrime dhe si “stacionet e fundit ku duhet shkuar”, ato ofrojnë një përkufizim të rolit të policisë në shoqëri, si lista e gjërave, të cilat duhet t'i bëjë policia, për të justifikuar eksistencën e vet dhe si lista e pritjeve të qytetarëve ndaj policisë së tyre. Tabela më poshtë, jo sipas ndonjë kriteri të përcaktuar paraprakisht, paraqet disa nga këto qëllime të mundëshme, duke krahasuar së paku tri listime qëllimesh të bëra ① nga fusha e kërkimit shkencor, ② nga fusha e rregullimit normativ ndërkombëtar dhe ③ nga fusha e rregullimit normativ të veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

Tabela: Krahasimi midis objektivave të pritëshme teorike, objektivave të policimit demokratik të shpallura në Kodin Europian të Etikës Policore dhe detyrave institucionale të Policisë së Shtetit		
Sipas një studimi të vitit 2002	Sipas kodit Europian të Etikës së Policisë	Detyrat institucionale të Policisë së Shtetit
<p><i>Shoqëria pret nga policia:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parandalim të krimit 2. Reduktim të frikës nga krimi 3. Mbajtje të rendit dhe qetësisë publike 4. Mbrojtje të jetës së personave dhe pronës 5. Zbatim të ligjeve 6. Zbulim të krimit 7. Arrestim të shkelësve të ligjit 8. Kontroll dhe mbikqyrje të qarkullimit të mjeteve e njerëzve 9. Përgjegjshmëri dhe gatishmëri ndaj nevojave të komunitetit 	<p><i>Qëllimet e policisë në një shoqëri demokratike të udhëhequr nga shteti ligjor:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ruajë qetësinë publike, ligjin dhe rendin në shoqëri; 2. Të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara, veçanërisht, në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut; 3. Të parandalojnë dhe të luftojë krimin; 4. Të zbulojë krimin; 	<p><i>Detyrat institucionale:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a) Mbron rendin dhe sigurinë publike. b) Mbron ushtrimin e lirive dhe të të drejtave të personit. c) Merr masa për parandalimin dhe për zbulimin e krimeve. ç) Kontrollon kufijtë shtetërorë të RSh. d) Mbikëqyr qarkullimin rrugor. dh) Siguron personalitetet e larta të vendit. e) Ruan institucionet dhe pronat publike.

<p>10. Mbrojtje të të drejtave themelore të individit</p> <p>11. Shërbime publike plotësuese, sipas emergjencës së problemeve</p>	<p>5. Të kryejë funksione të ndihmës dhe shërbimeve për publikun.</p>	<p>ë) Garanton zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore, që e ngarkojnë me detyra.</p> <p>f) Ndihton në raste fatkeqësish.</p>
---	---	---

Hapi i dytë, që hidhet pasi përcaktohen qëllimet, është identifikimi i rrugëve, mënyrave dhe mjeteve që do të përdoren për të arritur plotësimin me sa më shumë efektivitet të tyre. Hartimi i strategjive përbën një veprimtari të konceptualizuar për të përfshirë në një mënyrë sa më të gjerë në hapsirë dhe në kohë punën për realizimin e qëllimeve dhe që presupozohet të kenë një impakt domethënës në qëndrimet dhe sjelljet e punonjësve të policisë. Policimi demokratik i ndërton strategjitë e veta mbi katër përbërës themelore: ① zbatimi i ligjit, ② prezenca në publik, ③ edukimi i publikut dhe ④ ndërtimi i partnershipit me komunitetin.

1. **Zbatimi i ligjit** (*policimi profesionist*) nga policia kanë të bëjnë me ndërtimin e një veprimtarie që i referohet dhe zbaton kërkesat dhe aplikon sanksionet e ligjeve të shtetit (psh, ndalimi e shoqërimi i personave të dyshuar, shtrëngimi për respektimin e orareve dhe liçencave nga bizneset private, përcjellja e kërkesave për t'u paraqitur në gjyq të qytetarëve, vendosja e gjobave, dhënia e mbështetjes për inspektoriatet shtetërore të kontrollit dhe policive të tjera për ekzekutimin e vendimeve, ndjekja e procedurave për gjurmimet dhe zbulimet e autorëve të veprave penale, bërja e ndalimeve dhe arrestimeve).
2. **Prezenca në publik** (*policimi minimal*) së policisë kanë të bëjnë me praninë e dukshme të policisë, me identifikueshmërinë e saj në komunitet dhe në mjediset publike, nëpërmjet uniformave të posaçme sipas shërbimeve, nëpërmjet patrullimit me automjete me shënja të posaçme identifikuese si makina të policisë (targa me mbishkrimin "Policia", me fenelina, blice, me ngjyrën blu tipike) etj,. Ashtu si strategjitë e shtrëngimit ligjor, edhe strategjitë e prezencës bazohen në idenë se problemi rreth pasojave që mund të ketë një person kur bie në dorën e policisë përcakton sjelljen kriminale.
3. **Edukimi i qytetarëve nga policia** (*policimi problemor dhe policimi proaktiv*) nënkuptojnë transmetimin tek qytetarët nga ekspertët e policisë e njohurive dhe aftësive për të shmangur viktimizimin e tyre. Nxitja dhe orientimi i viktimave dhe personave të pambrojtur për të përdorur njohuri dhe aftësi të tilla e ka burimin tek shqetësimi i këtyre kategorive qytetarësh lidhur me "frikën nga krimi" dhe nga pasojat që mund të kenë nëse bien viktimë e krimit. Mjaft polici përdorin "Akademitë Publike të Policisë", për të trainuar qytetarët rreth këtyre çështjeve. Në to transmetohen njohuri praktike për të mos rënë viktimë e krimit ose aftësohen në vetmbrojtje për t'u rezistuar sulmeve fizike. Edhe kriminelët potencialë, të dënuarit për vepra penale apo personat me të kaluar kriminale nuk mbeten jashtë vëmëndjes së këtyre strategjive. Për ta, edukimi përqëndrohet edhe në bërjen thirrje për kthimin tek sjelljet e moralëshme e ligjore, edhe në drejtim të sqarimit rreth pasojave të mundëshme të sjelljeve kriminale jo vetëm prej tyre, por edhe për qytetarët që bëhen viktima të tyre (shëmbull i një progami të tillë mund të jetë programi që i vendos së bashku shkelësit e ligjit penal dhe viktimat e tyre për të diskutuar rreth dëmeve që janë shkaktuar.
4. **Ndërtimi i partnershipit me komunitetet** (*policimi komunitar*). Kur përdoren strategji të tilla, krahas matricës së programeve të drejtpërdrejta për ndërtimin e partnershipit polici-komunitet, të domosdoshëm për të implementuar filozofinë e policimit komunitar, policia bën përpjekje me anëtarët e komuniteteve për të përmirësuar dhe riorientuar kontrollin social informal në komunitet. Ajo i realizon strategji të tilla duke përfshirë banorët në një shumëllojshmëri aktiviteteve organizative (asociacione polici-qytetarë, komitete konsultative qytetare, projekte për gjelbërimin, pastrimin dhe sistemimin e mjediseve publike në lagje e blloqe banimi, projekte për ndriçimin dhe sistemimin e rrugëve brenda lagjeve etj..) dhe në aktivitete rekreative (psh. festime të përbashkëta të fesatve të banorëve, aktivitete të

përbashkëta sportive, organizim të kampionateve sportive në lagje dhe zona banimi me sponsorizim të policisë etj.,).

Krahas gjallërimit të jetës komunitare, këto aktivitete nxitisin banorët për të qënë më të interesuar rreth problemeve të përbashkëta dhe më aktivë për të marrë pjesë në ndihmë të policisë në zgjidhjen e tyre. Në një shoqëri që ka prirje të individualizojë dhe t'i ndrydhë qytetarët brenda "mureve" të pronës private (për shkak të zhvillimeve demografike dhe zhvendosjeve të popullsisë drejt zonave urbane dhe të prirjeve për t'iu larguar praktikave kolektivistike të së kaluarës totalitare), ndërtimi dhe nxitja e një sensi të tillë të komunitetit, mund të ketë një ndikim mjaft pozitiv në procesin e shoqërizimit të brezit të ri dhe të sjelljeve të banorëve. Ato bëhen më mikpritës ndaj punonjësve të policisë gjatë kryerjes së detyrave, por njëkohësisht më vigjilentë dhe të interesuar për problemet e lagjes së tyre, për të mos gabuar apo për të mos u viktimizuar.

Policia, gjatë plotësimit të mandatit të saj shoqëror, i përdor të gjitha këto strategji. Ajo që duhet theksuar është nevoja për vendosjen e një balance të qëndrueshme institucionale në përdorimin e tyre. Dy strategjitë e para (*shtrengimi ligjor dhe prezenca*) janë më tepër bezdisëse dhe ndëshkuese në sytë e qytetarëve dhe theksimi i tyre, në dëm të strategjive të tjera, do t'i bënte ata të ndjeheshin të fyer apo do t'i zëmëronte. Mbajtja e një balance midis strategjive do të thotë që efektet negative të dy strategjive të para, të neutralizohen nga efektet që shkaktojnë dy strategjitë e tjera. Më në fund, problemi më i rëndësishëm është si të kombnohen këto strategji, për të pasur rendimentet e dëshiruara në reduktimin e niveleve të krimit, zbulimin dhe dorëzimin para drejtësisë të autorëve të veprave penale, duke mbajtur në nivelet e nevojshme mirëbesimin, përkrahjen dhe bashkëpunimin e qytetarëve. Kur kjo arrihet me sukses, punonjësit e policisë, veprojnë në një mjedis normal pune, për zbatimin e ligjit (*aplikimi i shtetit ligjor*), nuk kryejnë veprime preferenciale e diskriminuese (tregohen vlerat e vërteta të profesionalizmit) dhe minimizohen konfliktet demokraci-polici (arrihet përmbushja e pritjeve të rolit të policisë në shoqërinë demokratike).

○ Ndërtimi i mirëbesimit në procesin e demokratizimit

Policia është fillimi, është "porta" që hap sistemin e drejtësisë penale. Ajo kryen një sërë shërbimesh e funksionesh: patrullimin dhe kontrollin e territorit; gjurmimin dhe zbulimin e krimit; ndalimin, arrestimin dhe çuarjen para drejtësisë të autorëve të veprave penale. Ajo, gjithashtu, merr përsipër disa veprime në mbështetje të zbatimit të vendimeve të pushtetit gjyqsor, si psh, ndalimin e të akuzuarve për krim, merr pjesë në veprimet që kryejnë organe të tjera të shtetit që kanë nevojë për mbështjetjen e saj, jep dhe administron disa lloje liçencash për aktivitete private dhe publike etj. Megjithëse, në fakt, policia ka funksione të ndryshme në sisteme të ndryshme të drejtësisë penale, në fund të fundit, në shumicën e vendeve demokratike (përfshi edhe sistemin shqiptar të drejtësisë penale), policimi paraqitet si një përzjerje e funksioneve parandaluese, administrative dhe represive.

Policia, zakonisht konsiderohet e para agjensi e drejtësisë penale, me të cilën qytetarët marrin kontakt, dhe prej këtyre kontakteve, ata shpesh krijojnë e formojnë opinionet e tyre rreth sistemit në tërësi. Gjithashtu është vështirë të gjesh ndonjë agjensi tjetër të administratës publike apo të gjyqsorit, që të jetë kaq shumë nën shqyrtimin dhe vëmëndjen e vazhdueshme publike, mediatike e politike, si dhe objekt debatesh në lidhje me kontrollin e pushteteve të saj; në lidhje me çështjet e jetës private që prek; në lidhje me parandalimin e krimit, me prioritetet e kontrollit dhe të luftës kundër të tij. Shpesh, dështimet dhe gabimet reale apo të perceptuara nga publiku, media e politika, për plotësimin e interesave të komuniteteve, çojnë në zhvillimin e reformave dhe në përpunimit e llojeve alternative të policimit, me ritme më të përshpejtuara, në krahasim me ato të fushave të tjera të jetës publike.

Ky proces vlerësues bazohet ose në përvojat direkte, ose në atë që kërkojnë qytetarët nga policia në veçanti dhe nga sistemi i drejtësisë penale në përgjithësi. Proçesi është, thuajse gjithmonë, një bashkëveprim i brendësuar, (tek të gjithë punonjësit e policisë, qytetarët, gazetarët, politikanët, etj.) midis përjetimeve të përvojave personale dhe pritjeve të rolit social të policisë. Përvoja e kontakteve

me policinë nuk është një “privilegj” vetëm i viktimave të krimit apo i shkelsëve të ligjit. Ajo që luan rol domethënës në krijimin e përshtypjeve dhe të imazhit publik rreth policisë nuk është “frika dhe pasiguria reale” që kanë njerzit nga krimi e çrregullimi e për pasojë mungesa e sadisfacionit nga mbrojtja që garanton policia, por “frika dhe pasiguria” që ata ndjejnë. Studimet tregojnë se qytetarët kanë më tepër frikë nga krimi e çrregullimi, kur ndjenë se situata rreth tyre është e pasigurtë, e paqëndrueshme dhe ata nuk dinë se çfarë të bëjnë e kundër kujt të vetmbrohen apo të kërkojnë ndihmë, sesa kur kërcënohen drejtpërdrejt prej tij dhe kanë të gjitha mundësitë të vetmbrohen ose të kërkojnë ndihmë nga policia.

Eksperienca dhe përjetimet rreth policisë dhe efikasitetit të saj, krijohen nga kontaktet e përditëshme të kategorive të ndryshme të qytetarëve me punonjësit konkretë të policisë: nga vëzhgimet e përditëshme të veprimeve të tyre në mjediset publike, gjatë detyrës dhe në kohën e lirë; nga filmat, letërsia, informacionet dhe lajmet e medias, rreth veprimtarisë së policisë; nga njohuritë dhe historitë mbi përvojat me policinë; të treguara në familje, në takimet dhe bisedat midis miqve dhe në ceremonitë e ndryshme kolektive, në vajtje-ardhjet midis fqinjëve etj. Pa dyshim, viktimizimi kriminal ka më tepër mundësi të krijojnë e të përcjellin përshtypje mbresëlënëse, rreth efikasitetit ose inefikasitetit të policisë. Për shkak të pozicionit të veçantë dhe delikat që kanë, përshtypjet e përcjella nga viktimat, ose prej të afërmeve të tyre, për punonjës të veçantë të policisë mund të çojnë në lindjen e një paragjykimi të përgjithësuar për të gjithë policinë.

1.1.9. Njoftimi dhe informimi i policisë nga qytetarët

“Panorama policore” mbi krimin ndërtohet mbi bazën e sasisë, llojshmërisë dhe asaj që njih policia me sektorët e saj të specializuar rreth gjëndjes dhe nivelit të kriminalitetit në zona dhe fushta të caktuara të veprimtarisë shoqërore. Nëse kjo panoramë do të jetë e njëjtë apo do të ketë diferenca nga “panorama reale” e krimit dhe kriminalitetit, kjo varet nga prirja dhe tendenca e natyrshme e qytetarëve për ta informuar policinë rreth krimeve. Tabloja reale e gjëndjes kriminale formohet nga rastet që informojnë dhe denoncojnë qytetarët, duke i shtuar ato që policia i konstaton vetë dhe nga krimet që nuk përfshihen në “panoramën policore” të publikuar, për shkaqe specifike të gjurmimit, të hetimit, për shkaqe teknike, proceduriale, sociale dhe për politikë penale. Nga ana tjetër në tablon reale, luan rol të rëndësishëm edhe llojshmëria e variacioneve, volumi, shpeshtësia dhe tipi i veprimeve kriminale sipas zonave të banuara, sipas llojit të veprimtarisë shoqërore që viktimizon krimi dhe sipas shkallës së përfshirjes së këtyre të dhënave në mjetet e administrimit të të dhënave nga policia.

Në literaturën sociologjike dhe kriminologjike, përmendet dhe sillen argumenta rreth teorisë së “ajsbergut” në lidhje me ndodhshmërinë dhe marrjen dijeni të policisë rreth tij. Sipas saj, një lloj si tek ajsbergu, krimi i duket “mbi ujë” (njihet, konstatohet, denoncohet, evidentohet në gjendjen e flagrancës, apo kërcënon vetë punonjësin e policisë) rreth 1/6 e sasisë totale të krimeve të ndodhura në njësinë e kohës. Një nga shkaqet, pse nuk rregjistrohet në polici e gjithë tabloja reale e kriminalitetit, është se çdo shkelës kriminal i ligjit i shmanget kontaktit fizik me policinë. Në një eksperiment të zhvilluar në Kansas Siti, SHBA, që zgjati dy vjet, u vërtetua se shtimi apo zvogëlimi i numurit, nivelit dhe llojshmërisë së patrullave rutinë, nuk kishte ndikim të dukshëm uljen e nivelit të krimeve të konsideruara tradicionalisht si të parandalueshme nga patrullimi rutinë me turne. U arrit në përfundimin se shtimi i intesitetit të patrullave, bënte që krimi të zhvendosej në zona të tjera me më pak patrullim dhe nuk ndikonte në reduktimin e frikës së banorëve nga krimi.

Nuk ka asgjë befasuese nëse thuhet se tendenca e natyrshme për të evidentuar pamjen reale të “ajsbergut të krimit” dhe për të denoncuar një krim në polici, varet shumë nga rrezikshmëria e tij, nga frika që shkakton dhe nga fakti nëse është i dukshëm apo jo. Por, informimi në polici dhe denoncimi ndikohet edhe nga mjaft faktorë të tjerë: nga mosbesimi i përgjithshëm që mund të ketë publiku dhe qytetarët grupeve të caktuara ndaj policisë; nga përvojat e mëparshme personale të informimit dhe denoncimit; nga përvoja e të tjerëve me policinë dhe nga opinioni i krijuar për punonjës konkretë të policisë; nga pritjet e ndryshme që kanë grupe e kategori të ndryshme qytetarësh; nga faktorë të lidhur

me përvoja delikate të viktimizimit; nga ekzistenca e alternativave të tjera të përballimit të krimit (alternativa e vetgjqësisë, hakmarrja, pajtimi, shpagimi e kompensimi imediat i dëmit të shkaktuar etj.); nga marrëdhëniet që ka viktima me kriminelin, marrëdhëniet që ka kriminelin me punonjës të policisë; nga karakteri e niveli “i intimitetit” të çështjes, etj.

Niveli i raportimit, informimi e denoncimi i krimit në polici, ndryshon sipas rastit konkret kriminal. Kjo shpjegon pse vjedhjet e makinave janë shpesh rastet kriminale më të raportuarat dhe pse vrasjet janë më të dokumentuarat në krahasim me çdo krim tjetër, ndërkohë që, të tilla si krimi i orgaizuar, trafiket ilegale, korrupsioni, mitmarrja, krimet seksuale, mashtrimet, janë më pak të raportuara e të denoncuar. Tipik është rasti i abuzimit seksual me dhunë dhe mungesa e vullnetit gati total të viktimave (për shkak të paragjyqimeve, tabuve dhe të riviktimizimit moral që mund të pësojë ajo si rezultat i qëndrimeve shoqërore dhe për shkak të shok-ut psikologjik në të cilin ndodhet) për të denoncuar përdhunuesit. Nga kërkimet dhe tudimet e kryera arrithet në përfundimin se niveli i raportimit dhe denoncimi i krimit nga qytetarët në polici ka të bëjë me nivelin, ashpërsinë, frekuncën dhe llojin e veprimtarisë kriminale në shoqëri pavarësisht nga faktorët e mësipërm ose pikërisht kjo mund të jetë baza mbi të cilën nisin të influencojnë faktorët e mësipërm. Cila është zgjidhja e këtij problemi? Si mund të arrihet që qytetarët të informojnë dhe të denoncojnë krimet dhe shkeljet e ligjit në polici? Përvoja e çdo punonjësi policie dhe kërkimet e shumta të bëra në shkencat e luftës kundër krimit dëshmon se çdo veprim kriminal, edhe më i fshehti, më i sofistikuari dhe më i organizuari ndodh në praninë e individëve (dëshimtarët okularë), viktima është gjithashtu e pranishme, të afërmit e viktimës marrin dijeni, dëshimtarë të rastësishëm ka gjithmonë në mjediset publike urbane - në fund të fundit “asgjë nuk mund të kalojë pa u vënë re”. Si të merret ky informacion nga policia? Policia ka përpunuar e përpunon gjithfarë metodash e teknikash për ta zbuluar krimin, por pa komunitetin, pa qytetarët, pa ata që “shohin çdo gjë që ndodh”, krimi vetëm mund të mbahet nën kontroll. Detyra më e rëndësishme është parandalimi i krimit dhe i çrregullimit. Policimi komunitar synon pikërisht këtë.

2. Policimi komunitar

Forcimi prirjeve brenda komuniteteve të veçanta dhe shoqërisë në përgjithësi, për të marrë pjesë në luftën kundër krimit dhe çrregullimit, ka ecur e po ecën paralel me prirjen e policisë, për të pranuar faktin se taktikat tradicionale të luftës kundër krimit vetëm nga policia, kanë një impakt të kufizuar në kontrollin e tij. Policimi komunitar është një sintezë e këtyre lëvizjeve.

Bazë, për një strategji të suksesëshme të policimit komunitar, është krijimi i lidhjeve të ngushta polici-komunitet, marrja përsipër e detyrimeve reciproke për të bashkëpunuar dhe përfitimi i përbashkët. Policimi komunitar konsiston në arranzhimin e dy komponentëve bazë që plotësojnë njeri-tjetrin, ①partnershipi komunitar dhe ②zgjidhja e problemeve. Për të ndërtuar partnershipin komunitar, policislë i duhet të krijojë marrëdhënie pozitive me komunitetin, duhet të përfshijë komunitetin në kërkimin e rrugëve më të mira për parandalimin dhe kontrollin e krimit dhe, më tej, duhet të bashkojë forcat (si në një skuadër) dhe burimet e veta me ato të komunitetit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve më urgjente të pjesëtarëve të komunitetit. Zgjidhja e problemit është procesi përmes të cilit identifikohen shqetësimet specifike sipas komuniteteve dhe përcaktohen mjetet e mënyrat e përshtatëshme të kurimit dhe reduktimit të tyre.

Ideja e policimit komunitar, nuk lë të kuptohet aspak se në të policia ka më pak se zakonisht autoritet dhe atribut apo se prej tij nënçmohet detyra e saj primare e mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit. Megjithatë, ndërhyrja në sistemin e policimit, për ta bërë më të specializuar dhe shfrytëzimi i resurseve të komunitetit, më së paku, kërkon që policia të lehtësohet nga disa detyra të saj. Nëpunësit dhe të zgjedhurit e qeverisjes vendore, agjencitë sociale, shkollat, organizatat fetare, grupet e biznesit – të gjithë ata që jetojnë dhe punojnë në komunitet, duhet të kenë rolin e tyre dhe të vendosin një “tullë” në këtë sipërmarrje të përbashkët – të ndajnë përgjegjësitë për të gjetur zgjidhje që funksionojnë për tu adresuar tek problemet që dëmtojnë sigurinë, jetën dhe pronën në komunitet..

a. Koncepti “komunitet”

Qëllimi i policimit komunitar është reduktimi i nivelit të krimit dhe çrregullimit përmes egzaminimit të

kujdesëshëm të karakteristikave të problemit në zonat e banuara (lagje dhe bloqe banimi) dhe aplikimi i metodave të përshtatshme kurative, problemzgjdhëse. “Komuniteti” në lidhje me konceptin e kontrollit të territorit nga policia, nënkupton një zonë të vogël të banuar dhe me kufij të qartë gjeografikë. Tradicionalisht policia organizohet në mënyrë që, me punonjësit e saj me uniformë (dhe

Ç’quajmë “Komunitet”

Një bashkëjetesë individësh, grupesh, organizatash dhe sistemesh të gjera shoqërore, të rregulluara sipas një gjeografie dhe një rendi social normativ të paracaktuar (me një sfond kulturor, me një sistem të caktuar vlerash dhe simbolesh, me një sistem të kodifikuar normash e ligjesh, me një hierarki të arranzhuar statusesh sociale dhe me një dramaturgjë të përcaktuar rolesh), që garanton plotësimin e nevojave sociale dhe siguron kryerjen e një numri të domosdoshëm funksionesh të përbashkëta të jetës vendore, si:

- ❶ Funksioni i shoqërizimit;
- ❷ Funksioni i kontrollit social;
- ❸ Funksioni prodhim-shpërndarje-konsum;
- ❹ Funksioni i pjesëmarrjes sociale;
- ❺ Funksioni i përkrahjes reciproke

pa uniformë) të përshtatet, sa të jetë e mundur më shumë, me veçoritë specifike gjeografike e sociale të lagjeve dhe zonave të banimit, për të kryer shërbime sa më efikente në ndihmë të banorëve.

Në raport me kuptimin gjeografik të komunitetit, punonjësit e policisë në zonë, janë të parët që kryejnë shërbime ndaj qytetarëve dhe që kanë kontaktet më të shpeshta me ta. Në kuadrin e aplikimit të programeve të policimit komunitar, këta mbulojnë pjesën më të madhe të nevojave të përditëshme të policimit. Për këtë arsye, ata duhet të ndihmohen, jo vetëm nga eprorët e tyre, nga njësitë e specializuara të policisë, por edhe nga strukturat shtetërore dhe shoqërore. Nivelet e larta të drejtimit dhe stafet komanduesë të policisë, në këto përpjekje kanë përgjegjësinë të garantojnë mbështetjen e gjithë institucionit dhe burimeve të tij, për shërbimet e policimit komunitar.

Efektiviteti dhe efienca e policimit komunitar varet shumë nga optimizimi i kontakteve pozitive midis punonjësve të policisë së rendit, të inspektorëve të policisë të lagjes dhe pjestarëve të komunitetit. Kontrolli me automjete i territorit është vetëm një metodë patrullimi, në programet e policimit komunitar, dhe nuk ka ndonjë lidhje thelbësore me domethënien e tij. Policia, krahas patrullimit me makina (kur komuniteti gjeografik ka shtrirje të madhe territoriale) plotësohet, mbështetet ose kombinohet edhe me patrullimin me këmbë, me biçikleta etj.

Një nga metodat e përhapura, që lidhet drejtpërdrejt me qëllimin e policimit komunitar është decentralizimi i përqëndrimit të kontrollit të territorit me ministacione (posta) policie, të cilat synojnë ta afrojnë punonjësën e policisë tek komuniteti. Prania e përherëshme në mjedisin gjeografik të komunitetit, organizimi i takimeve publike me banorët dhe krijimi i forumeve të përbashkëta me ta (psh komitetet konsultative) u jep mundësi të dy palëve (punonjësve të policisë dhe banorëve) të thithin bashkërisht, ashtu si ajrin, problemet dhe shqetëimet reciproke dhe së bashku të kërkojnë mënyrat më të mira për t’i përballuar me sukses.

Një kusht i rëndësishëm i këtij policimi komunitar është caktimi dhe mbajtja e qëndrueshmërisë së grupeve policore të kontrollit të territorit. Duke shërbyer për një kohë të gjatë me turne dhe grupe patrullimi, nga njera anë punonjësit e policisë do të jenë figura familjare dhe të afërta për banorët dhe nga ana tjetër do të fitojnë një sens më të fortë të vetdijes dhe përgjegjësisë për problemet që ka komuniteti dhe që duhet të kujdesen ditë-për-ditë. Kjo rritje e pranisë së policisë në mjediset e banuara, përbën hapin dhe lëvizjen fillestare të stabilizimit të mirëbesimit publik dhe shërben për të zvogëluar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë nga krimi dhe çrregullimet tek pjestarët e komunitetit. Për pasojë, krijimi i një klime të tillë bashkëpunimi dhe gatishmërie rrit ndjeshëm sigurinë dhe qetësinë e banorëve. Frika nga krimi duhet të reduktohet qysh më parë, nëse duam që pjestarët e komunitetit të jenë pjesëmarrës aktivë në policim. Njerëzit nuk reagojnë nëse ndjejnë se nga këto veprime do të vihej në rrezik siguria dhe jeta e tyre.

Megjithse shërbimet që policia i ofron shoqërisë në përgjithësi dhe komuniteteve në veçanti, janë të

organizuara sipas kritereve gjeografike, komuniteti mund të përfshijë brenda vetes një diversitet të gjerë kulturash, vlerash dhe problemesh, veçanërisht në zonat urbane (qytetëse). Komuniteti përbëhet nga më shumë elementë sesa një qeverisje e vetme lokale apo vetëm nga banorët e një lagje. Institucionet e kultit, shkollat, spitalet, grupet sociale, agjensitë private dhe publike dhe të gjithë ata qytetarë që punojnë në një zonë të caktuar administrative, janë antarë vitalë të komunitetit. Më tej akoma, edhe ata qytetarë që vizitojnë zonën e banuar për qëllime kulturore (vizita tek të afërmit, për festa dhe ngjarje), për qëllime argëtimi (vizita në vende turistike, plazhe, kinema, diskoteka, koncerte etj), që kryejnë shërbimet e tyre sociale ose private në hapësirat urbane, janë gjithashtu të interesuar për çështjet e sigurisë dhe të qetësisë në ato zona. Përfshirja e këtyre “komuniteteve të interesit” në përpjekjet e policisë për të përballuar problemet e krimit dhe të çrregullimit, i zgjeron mjaft burimet bazë të saj në komunitet.

Ashtu si komunitetet gjeografike, edhe “komunitetet e grupeve të interesit” kanë probleme e prioritete që ndryshojnë nga njeri tek tjetri: disa janë të qëndrueshëm dhe formohen mbi baza etnokulturore, profesionale, mbi një histori apo të kaluar të përbashkët, mbi bazën e besimeve fetare apo politike, mbi bazat e lidhjeve të biznesit etj. Të tjerët formohen dhe riformohen mbi bazën e problemeve të reja, të cilave u drejtohen bashkërisht për t’i zgjidhur. Nëngrupet e interesit brenda komuniteteve mund të jenë në konflikte ose të kenë mosmarrëveshje midis tyre, disa herë edhe të dhunëshme. Grindjet, mosmarrëveshjet e konfliktet brendakomunitare janë mjaft të shpeshta në qendrat e mëdha urbane (qytetëse), sidomos në periudhat e ndryshimeve demografike dhe zhvendosjeve të popullsisë nga fshati drejt rrethinave të qyteteve të mëdha.

Këto interesa shumëfishe dhe shpesh konfliktuale, kërkojnë që punonjësit e policisë që veprojnë dhe shërbejnë në zona të tilla jo vetëm të kenë aftësitë dhe paisjet e duhura për të mbajtur rendin e qetësinë dhe për të zbatuar ligjin, por edhe aftësi të mira si mediatorë dhe pajtues të konflikteve. Nga ana tjetër kërkesat që i bëhen policisë nga një prej komuniteteve të interesit mund të bjerë ndesh dhe të shkelë interesat dhe të drejtat e një komuniteti tjetër interesash: një grup komunitar (psh komuniteti i gazetarëve) mund t’u kundërvihet disa taktikave të përdorura nga policia për të kontrolluar me masa energjike sjelljet kolektive në protestat publike, ngaqë mendon se ato mund të çojnë në praktika diskriminuese dhe paragjyquese, ndërkohë që protestat e dhunëshme, të shndëruara shpesh herë edhe në trazira urbane, çënojnë pronat dhe pasuritë e komunitetit të tregëtarëve apo prishin rendin e qetësinë e banorëve të tjerë.

Policia duhet jo vetëm të mbrojë të drejtat e grupeve që protestojnë, por ajo gjithashtu duhet të bashkëveprojë me të gjithë pjestarët e komunitetit, për t’i përfshirë në gjetjen e mënyrave dhe rrugëve të përshtatëshme që jo vetëm të realizojnë të drejtat e tyre të protestës, por edhe të mbrohet rendi e qetësia e tërë zonës së banuar nga bashkësia e komuniteteve të interesit. Për ta bërë të suksesëshëm dhe efikas këtë proces, pjestarët e komunitetit përcjellin tek strukturat zyrtare të policisë pikpamjet dhe sugjerimet e tyre dhe mbështesin përpjekjet e përfaqësuesve të saj në vendosjen e autoritetit të ligjit në atë zonë. Kjo garanton jo vetëm një pjesmarrje të gjerë të komunitetit dhe të qytetarëve në këtë proces, por ndihmon për të mbajtur një nivel të pranueshëm të rendit dhe qetësisë. Nga ana e saj, policia inkurajon çdo prirje dhe ofertë për bashkëpunim nga kushdoqoftë në komunitet, që ndihmon në mbajtjen në ekuilibër të interesave kolektive të të gjithë qytetarëve me të drejtat personale të çdo individi.

Konfliktet brenda komuniteteve janë sa të rëndësishme, aq dhe të zakonëshme; sa shkaktojnë probleme të mbarëvajtës së jetës, aq edhe ndodhin për shkaqe nga më të rëndomtë. Policia dhe punonjësit e saj duhet ta njohin mirë këtë ekuacion, për të ndërtuar lidhje të domosdoshme bashkëpunuese në mbajtjen e rendit, në garantimin e ndjenjës së sigurisë dhe në kontrollin e krimit. Kjo marrëdhënie duhet të jetë e qëndrueshme, e vazhdueshme dhe të përfshijë brenda vetes të gjithë komponentët e një komuniteti duke e qëndëruar rreth çështjeve themelore të sigurisë publike dhe të përmirësimit të cilësisë së jetës së përbashkët. Çelësi, për të manaxhuar këtë detyrë të vështirë, është mirëbesimi i ndërsjellë.

1.1.10. Komponenti 1- Partnershipi komunitar

Vendosja dhe mbajtja e mirëbesimit të ndërsjelltë polici-komunitet është objektivi qëndror i komponentit të parë të policimit komunitar – i partnershipit me komunitetin. Tashmë policia e një mirë nevojën e bashkëpunimit me komunitetin. Përvoja më e përparuar dhe studimet e shumta kanë treguar se në luftën kundër krimeve të rënda, madje edhe kundër krimit të organizuar, informacionet që vijnë nga qytetarët pjestarë të komunitetit rreth veprimeve kriminale kanë qënë gjithmonë një ndihmë e madhe në arritjen e suksesit të policisë. Për këtë arsye policia jo vetëm e inkurajon një prurje të tillë, por në kuadrin e partnershipit i edukon qytetarët si të dallojnë dhe të përzgjedhin informacioni më relevant dhe të dobishëm. Ajo bën këtë në një larmi programesh dhe metodash, që fillojnë nga bisedat e takimet me grupe banorësh, me pjesmarrje në ngjarje të rëndësishme dhe në festa civile, duke punuar me agjensitë e përkrahjes sociale dhe të shëndetit publik, deri tek pjesmarrja e përfshirja e punonjësve dhe specialistëve të saj në programet edukative-argëtuese për fëmijët dhe të rinjtë nëpër shkolla. Sipas problemeve të komunitetit, duke bashkëpunuar edhe me shoqata e organizata jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e përmirësimit të cilësisë së jetës së përbashkët (psh me OJF-të), policia cakton punonjës ose ngre njësi speciale të saj, për të ndihmuar komunitetin me shërbime të posaçme të ndërhyrjes në kriza. Sa ndryshojnë këto përpjekje bashkëpunuese të policisë, nga veprimet që ajo ka kryer zakonisht për të bërë detyrën? Dallimi më themelor është se, në policimin komunitar, policia dhe punonjësit e saj bëhen pjesë integrale e mënyrës së jetesës së komunitetit dhe komuniteti e ndihmon atë në përcaktimin e prioritetëve të së ardhmes dhe në shpërndarjen e burimeve. Ky dallim është substancial dhe përfshin brenda vetes objektivat, qëllimet dhe angazhimet bazë të policisë.

Partnershipi me komunitetin nënkupton adoptimin nga policia të një këndvështrimi të punës së vet (të policimit) që i tejkalon thekset standarde të zbatimit të ligjit. Ky lloj zgjerimi i botkuptimit dhe pamjes njih dhe pranon vlerën e veprimeve policore që kontribuojnë në përmirësimin e mbarëvajtjes së punësve dhe të rregullit edhe në një zonë të vetme banimi (ashtu siç e perceptojnë banorët e saj). Veprime të tilla mund të përfshijnë një gamë shërbimesh policore që duket se është më e gjerë se veprimet e zakonshme, apo që shkon ndesh me prirjen për ta lehtësuar policinë nga disa shërbime dhe për ta angazhuar më tepër me luftën kundër krimit: dhënia e ndihmës në raste aksidentesh ose për viktimat e krimit, dhënie e ndihmës së parë në raste emergjencash shëndetësore, dhënie e ndihmës për të zgjidhur e pajtuar konfliktet familjare dhe në lagje (psh, në raste të dhunës brenda familjes, në grindjet e mosmarrëveshjet qiradhënës-qiramarrës, në konfliktet e pronës, në rastet e ngacmimeve racore etj), puna me banorët dhe bizneset lokale për të përmirësuar kushtet e jetesës në blloqet dhe qendrat e banimit (pastrimet e mjediseve të përbashkëta, ndriçimi i rrugëve të brendëshme, sigurimin e shtëpive, për vetmbrojtjen nga viktimizimi dhe grabitjet etj), kontrolli i trafikut të këmbësorëve dhe mjeteve, kryerja e shërbimeve sociale të emergjencës dhe këshillimit për personat në rrezik (psh adoleshentët që lasgohen nga shtëpia, për të pastrehët, personat e intoksikuar dhe përdorues të drogës, për të sëmurët mendorë), mbrojtja e ushtrimit të të drejtave kushtetuese (psh,garantimi i të drejtës së fjalës dhe opinionit, mbrojtja e mitingjeve të ligjshme nga kërcënimet e jashtëme dhe bezdisjet e kundërshtarëve) dhe prezantimi prej punonjësve të policisë i një modeli të sjelljes qytetare e morale (gatishmëria për të ndihmuar qytetarët në nevojë, respekti për të gjithë njerëzit, ndershmëria, drejtësia dhe paanshmëria).


Ashtu si Policimi Komunitar, edhe ndërtimi i imazhit pozitiv dhe mirëbesimit të publikut, nuk është produkt, por proces i gjithanëshëm, i pandërprerë dhe sipas karakteristikave specifike të komuniteteve të veçanta.

Sido që disa mund të konsiderohen si veprime të pazakonta për një punonjës policie, shërbime të tilla janë të dobishme për të ndërtuar ura të qëndrueshme e të ndërsjellta të mirëbesimit dhe një imazh publik pozitiv. Pa këtë mirëbesim, policia e ka të vështirë (në mos të pamundur) të kryejë detyrat e saj kryesore në luftën me krimin dhe çrregullimin. Besimi i publikut është çelsi që i hap derën policisë ndaj informacionit të çmueshëm të qytetarëve, për të shkuar tek zgjidhja dhe prandalimi i krimit, që e furnizon me mbështetjen e domosdoshme qytetare në masat e mbajtjes nën kontroll të krimit dhe do

të rriste ndjeshëm pranueshmërinë publike të punonjësit të policisë në komunitet. Kjo nuk mund të arrihet vetëm nga punonjës të veçantë apo nga specialistët e marrëdhënieve me publikun, por tërë piramida e organizatës policore, nga maja deri në bazë, duhet të përfshihet në procesin e bashkëpunimit me komunitetin, për të përmirësuar nivelet e sigurisë dhe rendit. Ndërtimi i mirëbesimit nuk është, gjithashtu, një çështje që zgjidhet “brenda një nate”; ai kërkon përpjekje të vazhdueshme, të pandërprera dhe energjike. Më tej akoma, ai duhet arritur para se policia dhe strukturat e saj të vlerësojnë nevojat e komunitetit dhe të ndërtojë rrjetën e lidhjeve komunitare që do t’i garantojnë mbështetjen e qytetarëve.

Vënia në lëvizje dhe aktivizimi i mbështetjes komunitare nuk është një proces që zhvillohet në vijë të drejtë. Ai kërkon përdorimin e këndvështrimeve dhe metodave të ndryshme, për komunitete të ndryshme. Kështu, vendosja dhe arritja e bashkëpunimit polici-komunitet është më e lehtë në komunitetet e përbëra nga pjestarë të klasave të mesme dhe të pasura të shoqërisë, në krahasim me ato që përbëhen nga shtresat e varfëra dhe të marginalizuara të shoqërisë, në të cilat mungesa e besimit ndaj policisë ka një histori kontaktesh të pakëndëshme. Ka gjithashtu dallime midis komuniteteve gjeografike me homogjenitet kulturor siç janë komunitetet rurale apo lagjet me banorë autoktonë në zonat urbane, në të cilat policia dhe strukturat e saj të specializuara e kanë më të lehtë të gjejnë partnerët lokalë, në krahasim me zonat multikulturore të periferisë së qyteteve të mëdha, në të cilat banorët e ardhur rrishtaz kanë lidhje të pakta, ndërkohë që institucionet bazë komunitare nuk janë krijuar e konsoliduar në atë shkallë sa të lozin rolin e partnerit me policinë. Në lagje të tilla, lidhjet sociale komunitare dobësohen (madje pengohen) edhe për shkak të përhapjes dhe terrenit të favorshëm që gjen krimi dhe çrregullimi. Ndërtimi i lidhjeve të bashkëpunimit në to, ka nevojë të paraprihet nga ndihma që duhet të japë policia në rindërtimin e këtyre lidhjeve të dobësuar në dy drejtime kryesore: ①përmes masave energjike të luftës kundër krimit dhe çrregullimit dhe ② përmes përkrahjes, mbështetjes dhe mbrojtjes së veprimtarive të institucioneve sociale bazë në këto komunitete (psh, të familjeve, institucioneve të kultit, shkollave etj). Duke u zhvendosur drejt policimit komunitar, policia, përveç detyreve të veta ligjore, luan edhe rolin e katalizatorit dhe lehtësuesit të zhvillimit të komunitetit.

Figura paraqet një sistem i marrëdhënieve dhe i reagimit policor tradicional, që ka si karakteristikë kontaktet e kufizuara të punonjësve të policisë vetëm me "klientët tradicionalë" të policisë: "shkelësit e ligjit" dhe lidhjet institucionale me



organe të tjera të zbatimit të ligjit penal. Për këtë arsye veprimet e policisë kufizohen tek patrullimi i vendeve publike, reagimi ndaj thirrjeve të qytetarëve që kërkojnë ndihmë, ndalimi dhe arrestimi i autorëve të veprave penale, dhe mbrojtja dhe rivendosja e rendit.

Sidoqë figura paraqet një këndvështrim të kufizuar, madje të idealizuar teorik, sepse policia nuk operon e izoluar plotësisht nga shërbimet sociale dhe nga përfaqësuesit e tjerë të komunitetit, ajo dëshmon se në policimin tradicional mungon bashkëpunimi i institucionalizuar me partnerët lokalë dhe me qytetarët që i binden ligjit, ose më së paku lidhje të tilla janë sporadike, të paqëndrueshme dhe rastësore (vetëm kur partnerët lokalë dhe qytetarët që respektojnë ligjin e thërrasin për ndihmë).

Figura përbri paraqet modelin e një organizimi të ri policor, që vepron sipas një sistemi të gjerë lidhjesh të qëndrueshme institucionale me agjensitë publike e private, me asociacionet vullnetare dhe me banorët dhe që i zhvillon këto lidhje në të dukshme dhe llogaridhënëse kundrejt qytetarëve jo vetëm në rastet kur policia ndalon ose arreston dikë, që ka shkelur ligjin (për disa qytetarë bërja e një ndalimi apo arrestimi për shkeljen e ligjit, presupozon gjithçka që ata presin të shohin prej policisë), por edhe në situata normale e në veprimtari të përbashkëta (duke u shndëruar në një komponent integral të komunitetit).


Linja lidhëse dyfishë midis policisë dhe qytetarëve që shkelin ligjin, nënkupton rëndësinë që ka marrëdhënia mes tyre në kohën e shkeljes së ligjit e më pas. Filozofia e veçantë dhe domethënia e një modeli të tillë të hapur, por më obligator, shpalos brenda konceptit të policimit komunitar edhe ndërtimin e një rrjeti lidhjesh sociale të domosdoshme, për trajtimin e shkelësve të ligjit, për t'i ndihmuar të riciklohen në shoqëri dhe jo thjesht për t'i kapur e dërguar para trupit gjykues, që të marrin ndëshkimin e merituar.

Modeli shërben si dekor për të ilustruar idene e bashkëpunimit dhe për të sistemuar nocionin e "qytetarëve-police dhe policëve-qytarë, që programojnë e zhvillojnë veprimtari të përbashkëta për të prodhuar siguri dhe qetësi publike".

1.1.11. Komponenti 2- Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve është një term i gjerë, që nënkupton shumë më tepër sesa një eliminim apo paradalimin të thjeshtë të krimit. Ky komponent themelor i policimit komunitar bazohet në supozimin se "krimi dhe çrregullimi mund të reduktohen me sukses në zonat e vogla të banuara me anën e një studimi të kujdesëshëm të karakteristikave të problemit në atë zonë dhe të aplikimit të burimeve të përshtatshme" dhe mbi supozimin se "qytetarët i përzgjedhin alternativat e tyre mbi bazën e mundësive që u paraqiten, mbi bazën e karakteristikave imediate fizike dhe sociale të zonës ku banojnë. Duke manipuluar me këta faktorë, njerëzit do të kenë më pak prirje për të vepruar në mënyra agresive dhe të paligjësme"

Procesi i zgjidhjes së problemit shpjegohet duke ju referuar teorisë që qëndron prapa policimit problemor. Ajo është mjaft e thjeshtë: janë rrethanat dhe kushtet bazë që i krijojnë problemet. Këto kushte e rrethana mund të përfshijnë karakteristikat e njerëzve që marrin pjesë në një ngjarje (shkelset e ligjit, viktimat e mundëshme etj), mjedisi dhe sfondi social në të cilin hyjnë në bashkëveprim dhe marrëdhënie njerëzit, mjedisi fizik dhe mënyrat me të cilat publiku dhe opinioni publik i trajton këto kushte dhe rrethana. Një problem që krijohet nga këto kushte e rrethana mund të çojë në një ose disa ngjarje e shkelje të ligjit. Këto shkelje, sado që rrjedhin nga të njëjtat kushte apo rrethana mund të duken sikur janë të ndryshme nga njera tjetra apo sikur nuk kanë lidhje me njera tjetrën. Për shëmbull, kushtet sociale dhe fizike të një kompleks të dëmtuar dhe të pabanueshëm apartamentesh mund të nxisin grabitje, veprime të rrugaçerisë dhe vandalizmit, ngacmime dhe kanosje ndaj kalimtarëve prej adoleshentëve poterehijj dhe keqbërje të tjera. Këto shkelje të ligjit, për disa prej të cilave mund të



marrë dijeni edhe policia, janë simptomat e problemit dhe do të vazhdojnë përderisa problemi që i shkakton nuk do të zgjidhet.

Një nga përfundimet më të rëndësishme të kësaj teorie është se përdorimi me sukses i saj nga policia, kërkon një përfshirje sa më të gjerë dhe të vetdijëshme të komunitetit. Nga njera anë përcaktimi i shkaqeve të krimit, varen në një masë të madhe nga njohja në thellësi e komunitetit dhe e kushteve të tij dhe zgjidhja e përbashkët e problemeve nga ana tjetër, jo vetëm përmirësojnë jetën e qytetarëve, por forcojnë besimin e ndërsjelltë, lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe çon në njohjen e fushave të tjera të dobisë së përbashkët. Proçesi problemzgjdhës, ashtu si partnerhipi komunitar, është vetgjallërues.

Që proçesi të funksionojë me sukses i duhet kushtuar vëmendja e nevojëshme dhe duhet njohur bazueshmëria ligjore e shqetësimeve të komunitetit. Grupet e banorëve dhe punonjësit e policisë nuk janë gjithmonë dakord lidhur me faktin se cili problem do të jetë prioritar. Psh, policia mund të jetë e mendimit se grabitjet me dhunë janë problemi më shqetësues i një komuniteti të veçantë, ndërkohë që banorët e tij mund të konsiderojnë si shqetësim numur një: të pastrehët që flenë nëpër korridorët e pallateve, vjedhësit e kapakëve të puseta në tortuare, thyerjen e xhamave në rrugë, hedhjen e mbeturinave nga dritaret e pallateve apo ata që kërkojnë nëpër kazanët e plehrave dhe që i shpërndajnë ato andej-këndej.

Për pasojë, përveç punës që duhet të bëjë policia për tu marrë me problemet e krimeve dhe shkeljeve të rënda të rendit, në atë zonë apo edhe më gjerë, policimi komunitar kërkon që punonjësit e policisë t'i kushtojnë vëmendjen e duhur edhe shqetësimeve specifike që kanë komunitetet, ashtu siç i perceptojnë banorët, ndërkohë që inkurajon qytetarët të ndihmojnë policinë të zgjidhë problemet që e shqetësojnë.

Natyra e problemeve të komunitetit ndryshon shumë dhe përfshin një shumëllojshmëri ngjarjesh të lidhura me faktorë si gjeografia, koha, viktimat, grupet e autorëve të krimeve dhe nga mjedisi. Nga anatjetër këto probleme mund të jenë specifike për një zonë të vogël të komunitetit, për të gjithë komunitetin ose për një numur të madhe komunitetesh. Disa probleme nga këto shqetësuese mund të jenë:

- Rritja e pazakontë e numurit të grabitjeve në një zonë të banuar apo në autobuzat urbanë të një linje të caktuar, krijojnë një atmosferë ankthi dhe frike tek qytetarët edhe në zona të tjera
- Rritja e numurit të lypsarëve dhe hyrja e tyre nëpër lokale, krijojnë frikë në komunitetet e biznesit.
- Prania e prostitutave nëpër parkime, lulishte dhe ndërtesa të braktitura, apo nëpër rrugët e brendshme të blloqeve të banimit është gjithmonë një shqetësim për banorët dhe familjarët.
- Prania e të rinjve që mbildhen rregullisht dhe lozin nëpër sheshet e lagjeve duke bërë zhurmë e potere gjer në orët e vona të natës apo që ngrejnë pa masë volumin e kasetofonëve të makinave.
- Prania në komunitet e individëve që u bien në qafë dhe provokojnë banorët kur janë në gjëndje të dehur apo janë të sëmurë mendorë.
- Prania e shpërndarësve të drogës në afërsitë e shkollave në orët e pushimeve apo e të rinjve që ngacmojnë vajzat e shkollës përbën shqetësim të vazdueshëm për këto komunitete.

Në policimin komunitar, proçesi i zgjidhjes së problemeve varet edhe nga policia, edhe nga komuniteti. Ky proçes përfshin:

- **Eliminimi tërësisht të problemit.** Ky tip zgjidhje është zakonisht i kufizuar në problemet e çrregullimit. Si shëmbull mund të sillen eliminimi i ngjeshjeve të trafikut duke vendosur shenja rrugore dhe duke prishur apo rehabilituar ndërtesat e braktitura që mund të ushqejnë një atmosferë nxitëse për krimet.
- **Reduktimi i frekuencës dhe numurit** të shfaqjeve të problemit. Shpërndarja e drogës dhe problemet që e shoqërojnë si plaçkitjet apo dhunën në grupet e të rinjve do të zvogëlohen nëse komuniteti bashkëpunon me policinë për të ndërtuar dhe vënë në efikasitet qendrat e

këshillimit dhe të rehabilitimit. Një zgjidhje më e qëndrueshme mund të jetë intensifikimi i edukimit “stop drogës” në shkolla, në institucionet e kultit dhe në spitale nga punonjës të specializuar të policisë dhe ekspertë të tjerë të fushës.

- **Zvogëlimin e shkallës së dëmtimit** nga aksidentet dhe aktet kriminale. Përshëmbull, policia mund tu mësojë punonjësve në dyqane e magazina si të veprojnë gjatë një grabitje, që të shmangin plagosjen apo vrasjen nga grabitësit, ose këshillon femrat komunitetit (në lagje, në shkolla etj) për mënyrat e minimizimit të mundësive për të mbetur të vrara ose të dëmtuara seriozisht, nëse i sulmojnë për t’i grabitur apo përdhunuar.
- **Përmirësimin e trajtimit të problemeve.** Policia duhet të bëjë përpjekje për t’i trajtuar njerëzit në mënyrë humane, (psh., të tregojë ndjeshmëri dhe dhëmshuri ndaj viktimave të grabitjeve dhe përdhunimeve, duke kërkuar mënyrat më të mira të trajtimit të traumave të tyre, të rrisë efektivitetin e saj në trajtimin e adoleshentëve që largohen nga shtëpia, të përdoruesve të drogës, të personave që drejtojnë automjetet në gjendje të dehur etj, duke bashkëpunuar ngushte me agjensitë e tjera të specializuara).
- **Manipulimin e faktorëve mjedisorë për të dekurajuar sjelljet kriminale.** Kjo formë problemzgjdhëse, mund të përfshijë gjer përpjekjet e policisë për të ndikuar në organet e pushtetit vendor për të përmirësuar ndirçimin e rrugëve brenda lagjeve, për të pastruar zonat me bimësi të dendur të egër, të rregullojë shkurrnjat nëpër periferitë publike dhe të plumbosë ndërtesat boshe.

Ka po aq shumë zgjidhje sa edhe problemet. Ato variojnë nga masat më të thjeshta, e më pak të shtrenjta deri tek më komplekset dhe afatgjata që kërkojnë investime të konsiderueshme në drejtim të stafit, përgatitjes së tij dhe në burimet që do të përdoren. Zgjidhja e problemeve nuk mund të arihet me të ashtuquajturat “modele dhe procedura standarde”, sepse ajo është e kufizuar vetëm brenda caqeve të imagjinatës, krijimtarisë, këmbënguljes dhe entuziazmit të atyre që përfshihen në proces. Policimi komunitar lejon arritjen e zgjidhjeve sipas “masave trupore” të çdo komuniteti. Sipas tij, zgjidhja më e mirë është ajo që kënaq qytetarët, që përmirëson mënyrën e tyre të bashkëjetesës, që zvogëlon ankthin dhe frikën e tyre dhe që çon në përmirësimin e rendit, që forcon lidhjet midis antarëve të komunitetit dhe policisë dhe minimizon nevojën e veprimeve shtrënguese e detyruese mbi ta. Shëmbulli më poshtë përshkruan një zgjidhje të tillë:

- ⇒ Një inspektor policie i lagjes dhe patrulla e policisë ndeshin me fenomenin e grabitjes me dhunë të dyqaneve, në orët e natës. Gjatë trajtimit të disa rasteve, u zbulua se në ato dyqane, faktori që nxiste më tepër grabitësit ishte se kasat ku mbaheshin paratë nuk mund të shiheshin dot nga rruga ose për shkak të vendosjes së tyre ose sepse se nga brenda vitrinave kishte shumë postera reklamash që pengonin të shikohej nga jashtë, çfarë ndodhte brenda këtyre dyqaneve. Punonjësit e policisë, sido që nuk mund të identifikonin dot autorët ose shkaqet e vërteta të krimit, identifikuan kushtet që lehtësonin kryerjen e krimeve të tilla, dhe duke rekomanduar ndryshimet që duhet të bënin pronarët, ndihmuan edhe me masa të tjera, për të zvogëluar numurin e grabitjeve.
- ⇒ Për të identifikuar problemin, punonjësit e policisë dhe drejtuesit e tyre biseduan me pronarët, me shitësit, me pjesëtarë të tjerë të komunitetit të biznesit dhe me banorët. Ajo që u arrit të kuptohej lidhur me shkaqet, shqetësimi i truar nga policia, sugjerimet për banorët dhe pronarët dhe masat e tjera policore, patën një ndikim të dukshëm në uljen e numurit të grabitjeve në të ardhmen, por dhe në kontribuan për të forcuar lidhjet midis policisë dhe komunitetit.

Të gjitha nivelet e strukturës organizative të policisë duhet të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, në vartësi të qëllimit, të rëndësisë dhe të shtrirjes së problemit. Përshëmbull, gjetja e një zgjidhje për rastet mjaft të përhapura të keqtrajtimit dhe plagosjes së grave nga bashkëshortët, mund të kërkojë përfshirjen e disa niveleve të hierarkisë së policisë në një juridiksion të caktuar. Inspektori i policisë i lagjes apo inspektorët e policisë kriminale mund të evidentojnë se keqtrajtimet dhe plagosjet kanë ardhur si pasojë e problemeve familjare dhe e tepërimit me alkollin nga autorët, veçanërisht në klubet e natës dhe lokalet e paligjëshme. Drejtuesit e policisë dhe oficerët e policisë gjyqësore mund të përpiqen bashkë me banorët për të gjetur mënyrat e mbylljes të lokaleve të paligjëshme dhe të vendosjes së orareve për pijetoret në bashkëpunim me pushtetin lokal. Nga ana tjetër, për autorët e veprave të tilla penale mund të ketë nevojë t'i nënështrohen programeve të kurimit dhe rehabilitimit të tyre nga agjensitë e specializuara. Ndërkaq, drejtuesit e lartë të policisë vendor dhe ata të pushtetit lokal mund të organizojnë takime dhe konferenca me grupet e grave, me shoqatat e tyre dhe me agjensitë e përkrahjes sociale duke krijuar mundësi për viktimat që të jetojnë përkohësisht në qendra të specializuara të trajtimit të viktimave të torturës ose të banojnë përkohësisht bashkë me fëmijët e tyre larg bashkëshortëve që i keqtrajtojnë. Po ashtu, nga banorët e komunitetit mund të jepet kontribut duke krijuar kushte banimi për to, në ndërtesa të braktisura apo të rikuperuara bashkarisht.

Të gjitha nivelet e strukturës së policisë duhet të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve, në vartësi të qëllimit, të rëndësisë dhe shtrirjes së çështjes që shqetëson komunitetin konkret.

Policimi komunitar vendos thekse të reja lidhur me pengimin e shkaqeve të sjelljeve të paligjëshme dhe kriminale, duke iu drejtuar problemeve në nivelet bazë të tyre. Duke rritur kohën e kontakteve të punonjësve të policisë me qytetarët në mjediset e banuara, në kuadrin e policimit komunitar, nxitet

Punonjësit e policisë që punojnë në programet e "Policimit komunitar" duhet të trainohen të kenë njohje të mirë të lagjes dhe banorëve të saj. Qytetarët inkurajohen të bashkëbisedojnë me policët dhe policët të orvaten të ndërtojnë raporte të atilla që qytetarët të jenë të predispozuar të bashkëpunojnë.

Qëllimi është që përmes sigurimit të mbështetjes nga publiku, kuptimit dhe njohjes së mirë të komunitetit ku shërben, ekipi të bëhet efikas në mbajtjen nën kontroll të kriminit dhe çrregullimit. Ky qëllim bazohet në konkluzionin: Sa më e fortë të jetë ndjenja e frikës nga krimi dhe pasiguria qytetare, aq më i keq është imazhi i policisë në publik, aq më të lënë pas dore dhe pa mbrojtje ndjehen qytetarët.

dhe inkurajohet përdorimi i numurit 129, dhe patrullave "shqiponja" vetëm për rastet e vërteta të emergjencës kriminale (konvencional apo të organizuar).

Kjo kërkon bashkëpunimin, përkrahjen dhe mirëkuptimin e komunitetit. Për t'ia arritur një mbështetje të tillë, punonjësit e policisë instruktojnë banorët lidhur me natyrën e një ngjarje urgjente dhe për alternativat e tjera të zgjidhjes së problemeve urgjente. Këto alternativa jo vetëm i paraqiten dhe i shpjegohen komunitetit, por kërkohet mirëkuptimi dhe miratimi i tyre. Atyre u bëhet e ditur se policia dhe punonjësit e saj përgjegjës do të reagojnë me përgjegjësi shpejtësi për ngjarjet dhe kërkesat e tyre urgjente, dhe se reduktimi i thirrjeve për urgjenca përmes 129, do të llesonte punonjësit e policisë për të kaluar më shumë kohë sëbashku me ta dhe për t'i përdorur me efikasitet taksat e tyre.

3. Policimi komunitar, si reagim strategjik ndaj krizës së modelit të policimit

Përfundimet e arritura nga studimet dhe përpjekjet e bëra për të përpunuar e ndërtuar një model policor "të bazuar tek komuniteti" në fundin e viteve '70 dhe në fillimin e viteve '80, në shumicën e vendeve demokratike nxitën për ndryshime e reforma në të gjitha policitë e vendeve që aspirojnë për demokraci. Disa standarde të formuluar për të shpjeguar dhe aplikuar projektet e këtij policimi të ri, të cilat bazohen në përfundimet teorike janë:

4. Policimi komunitar është një filozofi e re veprimi, që bazohet tek respektimi dhe mbrojtja e lirive të individit.

5. Policimi komunitar kërkon që i gjithë personeli i policisë të synojë për të gjetur rrugët e duhura që të përkthejnë këtë filozofi të re në praktikën e tij të punës.
6. Policimi komunitar kërkon një tip të ri polici, të ndryshëm jo vetem nga koncepti se "Policia është zanat i kamxhikut", por dhe nga tipi i policit "ushtar-burokrat". Ai ka nevojë për "policë, që mendojnë si qytetarë, dhe për qytetarë, që kujdesen për bashkësinë e tyre si policë".
7. Polici komunitar punon me grupet e komunitetit, që i binden ligjtim, për të kërkuar sëbashku zgjidhje të reja për shqetësimet që kanë qytetarët në to.
8. Policimi komunitar nxit krijimin e marrëdhënieve dinamike e të shumëllojshme midis qytetarëve dhe policisë.
9. Ai forcon dimensionin proaktiv në veprimtarinë e policisë, pa rënë në njëanshmëri, paragjykim dhe diskriminim të qytetarëve.
10. Ai ka për qëllim të mbrojë segmentet më vulnerable, të pafuqishmit dhe të pambrojturit në komunitete, duke balancuar aftësitë humane të punonjësve të policisë me risitë teknologjike.
11. Ai duhet të implementohet dhe të integrojë tërë forcat e një agjencie apo reparti policor duke u shndëruar në një këndvështrim strategjik që luan një rol kurcial në jetën e brendshme të tyre.
12. Ai e ve theksin mbi decentralizimin dhe delegimin e kompetencave të policisë duke u shndëruar nga një strukturë burokratike e ngurtë, me hierarki të centralizuar, drejt një strukture të hapur, dinamike, demokratike dhe të decentralizuar.

Policimi komunitar, nuk është thjesht një taktikë që duhet aplikuar ose jo në përputhje me rrethanat dhe problemet, por është një mënyrë re të menduari rreth rolit të policisë në shoqëri, një plan koherent dhe koheziv organizativ, me anën e të cilit sektorët e policisë modifikohen për të plotësuar nevojat specifike.

E përbashkëta në veprimet reformuese dhe që e bën policimin komunitar të tejkalojë caqet taktike të kontaktit me qytetarët është: **përgjegjshmëria** dhe **llogaridhënia** reciproke polic-komunitet, **artikulli** i vlerave të orientuara drejt qytetarëve, **decentralizimi** i autoritetit, **vendimarrja e përbashkët** polici-komunitet dhe **forcimi i autoritetit** të policit në sytë e qytetarëve.

a. Policimi me ekipe

Policimi me ekipe ishte reagimi i parë ndaj nevojës për një ndryshim në modelet e policimit dhe të përshtatjes me kushtet e reja sociale që lindën mbas transformimeve që pësoi shoqëria perëndimore dhe amerikane mbas lëvizjeve studentore të viteve '60-70. Ai synonte të zhvendoste mënyrën tradicionale drejt mbajtjes nën kontroll të krimit, përmes marrëdhënieve më të mira të policisë me qytetarët. Programi përfshinte elementin e stabilitetit gjeografik të patrullave, ndërveprimin maksimal midis anëtarëve të ekipit dhe komunikimin e pandërprerë me komunitetin.

Gjatë një vëzhgimi, në një nga qendrat pilot, një grua tregonte se tani qytetarët, kur shohin një punonjës policie, që patrullon në lagje, të thonë:

Ai është "polici i tyre".

Ky është një ndryshim i madh në imazhin publik të policisë. E njëjta gjë ndodh edhe tek policët, kur thonë për qytetarët:

Këta janë "njerëzit tanë".

Kjo është esenca e policimit demokratik dhe e policisë si një "shërbim publik".

1. Programi e zhvendoste fokusin tradicional të policisë nga trajtimi i shkelësve të ligjit, drejt një strategjie që i kushton kujdes më të madh trajtimit të viktimave. Punonjësit e policisë në mënyrë sistematike dhe të panifikuar marrin kontakte me viktimat për shqetësimet dhe problemet, në të cilat mund të ndërhyjë polica me mbështetje më të kualifikuar apo për të marrë informacion shtesë për çështjen që i ka viktimizuar.
2. Komponent tjetër ishte ndërtimi i "grupeve reguese komunitare." (komitetet konsultative polici-komunitet) Policët trainoheshin si të shkojnë në lagje dhe si të kontaktonin dhe të kërkonin mbështetjen e banorëve, duke i sensibilizur rreth çështjeve që lidheshin me cilësinë e jetës së

qetë të tyre.

3. U përpunua një sistem informimi që u siguronte banorëve informacionin e nevojshëm burimor (nga policia dhe organet e zbatimit të ligjit) rreth krimeve në komunitetin e tyre. Qëllimi ishte të shmangeshin keqkuptimet, përfytyrimet e gabuara ose të shtrembëra mbi realitetin e gjendjes së kriminalitetit, që mund të lindin tek qytetarët, kur ata e marrin informacionin nga burime dytësore si kronikat e zeza të shtypit, nga qytetarët e tjerë ose nga “rrjetat e merimangës” së thashethemeve. Opinioni i krijuar nga rrugët dytësore mund të jetë aq i fortë, sa që çdo informacion i mëvonshëm burimor rreth nivelit dhe statistikave zyrtare të gjendjes së kriminalitetit, nga publiku do të përkthehej si një përpjekje e policisë për të fshehur të vërtetën, ose si paaftësi të saj për të njohur gjendjen. Çdo muaj banorët furnizoheshin me informacione dhe me këshilla parandaluese. Prodhoen dhe shfaqen në mediat lokale videokaseta, fletëpalosje “kujtesë” për qytetarët si të mbrohen nga krimi dhe shpallje publike me listën e detajuar të krimeve të ndodhura në lagje.

Një polici inteligjente, e zgjuar dhe e vetëdijshme për rolin e saj social, vlerëson me kujdes llojet, shpërndarjen dhe prirjet e ngjarjeve, për të cilat ka informacion dhe orvatet të sulmojë me forcat e mjetet e saj, shkaqet e jo simptomat. P.sh., kur vërehet se në një masë realitvisht të madhe, vjedhjet me thyerje të dyqaneve ose magazinave, bëhen në orët e vona të natës, policia merret me problemin, pra me identifikim e faktorit-shkak “që lehtëson” vjedhjet në këto orare dhe merr masa të pengojë veprimin e këtij faktori-shkak

4. Një tjetër zhvillim tjetër ishte ngritja e qendrave apo ministacioneve policore të komunitetit, që siguronin një shumëllojshmëri shërbimesh duke u bazuar në nevoja të veçanta të komunitetit. Qendrat u vendosën në zona gjeografikisht të vogla me rreth 2000-3000 banorë dhe të arritshme nga banorët e lagjes. Qëllimi ishte, që policët të presnin qytetarët, të mbanin shënim ankesat e tyre, të jepnin këshilla, informacione mbi parandalimin e krimit e të ndihmonin banorët për zgjidhjen e kërkesave dhe problemeve duke sensibilizuar shërbimet e tjera publike.
5. Programi i ndërveprimit pozitiv polici – komunitet. Drejtuesi i policisë organizon e zhvillon takime me të gjithë liderët e lagjeve, kryesisht me kryetarët e shoqatave civile, pronarët e bizneseve, klerikët etj.

Nga këto takime me përfaqësuesit, qytetarëve u jepet mundësia të bashkëbisedojnë me drejtuesin e policisë, për problemet që kanë dhe t’i kërkojnë të përdorë burimet e veta njerëzore e materiale për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre.

Po ashtu, çdo muaj edhe policët e ekipit të lagjes merrnin pjesë në mbledhjet e shoqatave të lagjes sa më gjatë të ishte e mundur. Në këtë formë kontakti qëllimi ishte, që edhe sikur të qëndronin vetëm disa minuta, policët dhe populli të njihnin njeri-tjetrin. Më tepër se një mjet për të zgjidhur problemet, kjo teknikë komunikimi ballë për ballë, së bashku me kërkesat ndaj shefit, ka funksionin e një shkolle të hapur, ku policët dhe komuniteti mësojnë të njohin dhe bashkëveprojnë me njeri-tjetrin. për qëllimet e përbashkëta.

b. Policimi problemor

Që policia të reformojë mënyrën si e shikon punën që kryen, duke adoptuar këndvështrimin e ri, të **“Policimit të orientuar drejt problemeve.”** Sipas këtij orientimi drejtuesit e policisë është më e dobishme ta përqëndrojnë më pak vëmendjen ndaj ngjarjeve e incidenteve të veçanta apo simptomave të problemeve dhe të tregojnë më tepër interes për shkaqet e ankesave, për t’i eliminuar që ato të mos përsëriten. Reagimi tradicional i policisë ndaj ankesave ose thirrjeve të qytetarëve për ndihmë, shpesh

Thelbi i efikasitetit të policimit komunitar konsiston në uljen e numrit, llojshmërisë dhe ashpërsisë së krimit me përpjekje të përbashkëta parandaluese; në zvogëlimin e frikës nga krimi, duke reaguar në kohë ndaj shqetësimeve të qytetarëve; zbatim efektiv të ligjit në një kooperim të ngushtë polici-qytetarë

ngjan me mjekun që kuron simptomat e një sëmundjeje dhe jo vetë sëmundjen.

Duke punuar me tregtarët dhe banorët e komunitetit, policia nxit përmirësimin e masave të tyre të sigurisë, ndikon në zvogëlimin sasinë e parave “gjëndje”, që janë “karem” për vjedhësit duke rritur prezencën (në numur dhe nivele patrullimi) në zonat më problematike.

Çrregullimi, krimi dhe çdo gjë tjetër, për të cilën thirren të ndërhyjnë policët, ndodhin brenda rrethanave të zakonshme sociale. Në vartësi të natyrës së tyre, këto rrethana kanë aftësinë të rrisin ose të zvogëlojnë mundësinë për të ndodhur ngjarjet e mësipërme. Lagjet e pandriçuara dhe një popullatë e terrorizuar nga frika e krimit e pasiguria, inkurajojnë vandalët e grabitqarët, ndërsa paisja e lagjes me një sistem të mirë ndriçimi dhe organizimi i komunitetit i dekurajon kriminelët.

Ky policim është i mundshëm, por jo i lehtë për t’u realizuar. Një orientim i tillë institucional kërkon një transformim radikal të bazave të punës së policisë dhe, si hap të parë, ndryshime të thella në cilësinë e rekrutimit dhe tranimin e policëve, oficerëve dhe drejtuesve të policisë. Institucionet nuk mund të ndryshohen brenda një nate. Ato kërkojnë kohë dhe përpjekje për kapërximin e pengesave e kufizimeve që imponon realiteti brenda dhe jashtë. Është e rëndësishme, që kjo të njihet dhe të pranohet nëse dikush synon të ndryshojë një institucion në themel, sepse pa qartësimin e përmirësimeve në vlera mund të krijohet vetëm një iluzion i progresit, ndërsa institucioni mbetet po ai. Dy ndryshimet më të rëndësishme në ngritjen e nivelit të personelit, gjer në atë shkallë sa të jenë të aftë të plotësojnë detyrat e këtij stili të ri të policimit do të ishin: a) ndryshime në kriteret e pranimit, trainimit dhe arsimimit; b) zhvendosja e theksit nga përgjegjësia ligjore dhe disiplinore në punë, drejt përgjegjësisë, llogaridhënies dhe respektimit të vlerave etike në detyrë.

c. Policimi i orientuar tek komuniteti, “Policimi Komunitar”

Tentativa e tretë, e mbiquajtur edhe si “*revolucioni i qetë në polici*”, nuk është retush për t’i mbuluar rrudhat e plakjes, por një rilindje e policisë, në një formë të freskët, më dinamike, efçente dhe të aftë për të përballuar sfidat; një shërbim me sytë e drejtuar nga komuniteti.

E parë në raport me luftën kundër krimit, duket “binjak” me policimin problemor. Policimi komunitar është në shumë kuptime një policim i orientuar sipas problemeve, por me sens të kundërt. Policimi komunitar bazohet në mirëbesimin dhe ndihmën që jep komuniteti në përcaktimin e problemeve dhe ndërtimin e praktikave të policimit dhe prioriteteve të tij. Ai më tepër sesa parandalim dhe mbajtje nën kontroll e krimit, synon t’i bëjë policët dhe komunitetin partnerë të ngushtë. Sipas tij niveli i krimit dhe i çrregullimit zvogëlohet në përpjestim të drejtë me përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.

Policimi komunitar është filozofia e një policimi plotësisht në shërbim të komunitetit, të personalizuar aq sa të njëjtët punonjës të policisë, që veprojnë në të njëjtat hapësira komunitare, mbi baza permanente dhe të decentralizuara, punojnë në një partnership proaktiv me qytetarët për të identifikuar dhe zgjidhur bashkërisht problemet

⇒ **Policimi komunitar e bën policinë më llogaridhënëse dhe efikase**

Krimi është një problem social kompleks që nuk mund të zgjidhet nga një agjenci e vetme. Kur ne arrijmë të kuptojmë kompleksitetin e krimit, gjithashtu arrijmë të njohim edhe faktin se policia dhe punonjësit e saj nuk janë të vetmit që përgjigjen për arritjen e kësaj zgjidhjeje. Arrijmë kështu në konkluzionin se është e padrejtë që t’i kërkohej një punonjësi apo një sektori të vetëm të policisë, që të përgjigjen për nivelin e krimit. Në këtë rast përballemi me dilemën se kujt i duhet caktuar një përgjegjësi e tillë. Për fat të keq, këndvështrimi tradicionalist i mbajtjes në kontroll të krimit investohet, në të gjitha përpjekjet e veta antikrim, tek policia duke i kërkuar të luajë rolin e “luftëtarit antikrim”.

Policimi komunitar orvatet t’i adresohet krimit, pa e tepëruar në përpjekjet e veta. Problemi i krimit në rastin konkret copëtohet në pjesë të vogla të manaxhueshme dhe punonjësit e policisë bëhen përgjegjës për hapësira të vogla gjeografike dhe projekte të realizueshme prej tyre. Duke e ngushtuar

në këtë mënyrë këndvështrimin e detyrës së mbajtjes nën kontroll të krimit, mund të identifikohen edhe çrregullimet më të vogla që i japin punonjësit më tepër kapacitete proaktive jo ndaj shkeljeve të ligjit apo të krimeve të ndodhura, si taktikë reagimi, por si strategji parandaluese, që e kalon iniciativën në dorën e policisë.

Nga ana tjetër fokusi tek parandalimi proaktiv, jep shance të mjaftueshme për të matur progresin në zgjidhjen e problemeve. Duke u fokusuar tek evidentimi i simptomave të problemeve përmes informacionit të mirëbesimit, polici bashkëpunon me publikun, në vend ta shohë si një kundërshtar.

Duke u fokusuar tek problemet sociale dhe çrregullimet konkrete dhe gjetja e mënyrave të zgjidhjes së tyre sëbashku me komunitetin, sjell si pasojë zvogëlimin e kushteve kriminogjene. Në këtë proces bashkëveprimi dhe partnerhipi punonjësi i policisë bëhet gjithnjë e më efektiv si “luftëtar antikrim”.

⇒ **Punonjësit e përfshirë në policimin komunitar mbeten sërish brenda caqeve të misionit të tyre**

Në një rast një punonjës policie u caktua të punonte nën koperturë në një projekt të antidrogës. Mbas tre muajsh, ai tregonte se në gjirin e atyre që prodhonin dhe shpërndanin drogën kishte mjaft njerëz të mirë. Disa menduan se ky punonjës e kishte humbur sensin e tij të misionit, si punonjës i policisë.

Në kundërshtim me këtë perceptim, punonjësi i policisë nën koperturë mund të mos e kishte humbur me të vërtetë sensin e misionit të vet. Ai kishte mësuar atë që dinë tashmë mjaft punonjës policie të policimit komunitar. Mjaft qytetarë, në raport me mjedisin ku jetojnë, janë njerëz të mirë. Për fat të keq, disa punonjës policie dhe drejtuesit e tyre i shohin qytetarët si kundërshtarë. Këta lloj punonjësish janë të kushtëzuar nga metodat tradicionale policore që i ekspozojnë punonjësit vetëm ndaj një segmenti të popullsisë – të dyshuarve, viktimave dhe fatkeqësive të tyre, viktimave që kontribuojnë për viktimizimin e tyre. Policimi komunitar u jep punonjësve të policisë shansin të bashkëveprojnë dhe bashkëlidhen me qytetarët në situata pa kriza. Gjatë këtyre kontakteve ata takojnë një numur të madh dhe një shumëllojshmëri njerëzish. Takojnë dhe njohin mjaft njerëz të mirë të komuniteteve dhe grupeve ku jetojnë e zhvillojnë aktivitetet e tyre.

⇒ **Policimi komunitar nuk i bën qytetarët të ndërvarur nga policia**

Në një rast, duke telefonuar në polici, një grua kërkonte ndihmë pasi frigoriferi i saj po punonte më shpejt se zakonisht dhe pyeste si ta rregullonte atë. Për mjaft njerëz, sa më shumë bëni për ta, aq më tepër ata bëhen të varur prej jush. Policia nuk ka aq kohë sa të merret me të gjitha nevojat dhe problemet që kanë qytetarët.

Në fillim të aplikimit të kësaj filozofie të re shërbimi njerëzit mund të bëhen me të vërtetë të varur nga punonjësi i policimit komunitar. Kjo shtrun në mënyrë imediate nevojën që ky punonjës të njohë dhe të organizojë gjithë rrjetin e vet të mbështetjes. Natyrisht që ai nuk mund t'i kryejë të gjitha shërbimet i vetëm. Punonjësi i policisë duhet të jetë miku i qytetarëve. Është e zakonshme që dikush që i është prishur një pajisje shtëpiake, të pyesë miqtë e tij, për t'i rekomanduar një shërbim riparimi. Ka pak të ngjarë t'ja kërkojë këtë një të panjohuri. Kur arrihet kjo me punonjës të policisë mund të thuhet se është arritur mirëbesimi i kërkuar midis komunitetit dhe policisë. Ajo që ç'ka është e domosdoshme, është krijimi i një atmosfere ku qytetarët të bëjnë më tepër për veten e tyre.

d. Dallime midis policimit komunitar, policimit me ekipe dhe policimit problemor

1.1.12. Policimit komunitar - Policimi me ekipe

Policimi me ekipe është produkt i lëvizjes profesionaliste reformatore të quajtur “policimi strategjik”. Thelbin e kësaj lëvizjeje e përbën filozofia e luftës kundër krimit, që e vendos theksin tek përmirësimi i efikasitetit, i rendimentit, i kapaciteteve dhe i aftësive tekniko-teknologjike të policisë e punonjësve të saj. Duke u bazuar tek konceptet e teorive të manaxhimit shkencor, ai fokusohet tek përmirësimi i efikasitetit me anën e rritjes së rendimentit. Ndërsa policimi komunitar edhe pse mbron realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tilla, ka ndryshime të thella.

Koncepti i policimit me ekipe është në thelb defektiv. Problemi i defektit të tij nis nga fakti se policia është e paaftë të kontrollojë dhe të reduktojë e vetme krimin. Veprimet policore rallë kanë një marrëdhënie shkak-pasojë me nivelin e krimit dhe të kriminalitetit në shoqëri. Studimet dëshmojnë se taktikat antikrim (parandaluese apo luftuese), në rastet më të mira kanë arritur ta zhvendosin krimin nga një zonë në tjetrën apo kanë zvogëluar frikën qytetare nga krimi, por ndikojnë pak në shkallën dhe përmasat e ndodhshmërisë së tij. Politë dhe punonjësit e tyre, nga natyra, janë aktorë relativisht të dobët në mjedisin social që prodhon krim. Kjo lidhet edhe me faktin se policia dhe strukturat e saj trajtojnë vetëm një pjesë të rasteve kriminale në krahasim me krimet që ndodhin në realitet. Për shkaqe objektive dhe subjektive, shumica e krimeve nuk raportohen apo nuk konstatohen në polici, (Për ta ilustruar një dukuri të tillë më sipër përdorëm termin “teoria e ajzbergut” në kontrollin e krimit nga policia”), dhe kjo tërheq vëmendjen se “loja e shifrave” me statistikën rreth zbardhjes së rasteve kriminale nga policia, në rastin më të mirë e vendos policinë në qëndër të presioneve shoqërore për luftën kundër tij, duke kërkuar prej saj, më tepër nga sa mund të arrijë realisht.

Policia dhe punonjësit e saj janë vetëm një pjesë e procesit të luftës kundër krimit. Policia dhe veprimet e saj janë dhe duhen menduar si mjete. Mjetet janë instrumenta të dobishme dhe të domosdoshme për të arritur qëllimet dhe objektivat. Cilësia e mjetit është e rëndësishme vetëm në kontekstin e mjeteve dhe materjaleve të tjera të domosdoshme. Kjo do të thotë se vetëm blerja apo ndërtimi i një çekiçi të kushtueshëm dhe me cilësi të lartë, nuk garanton dhe nuk mjafton për të ndërtuar një shtëpi cilësore. Mjetet e punës dhe materialet duhet të përdoren me mjeshtëri sëbashku që të mund të kemi rezultate cilësore.

Policimi me ekipe është një taktikë që synon të ndihmojë policinë të realizojë luftën tradicionale kundër krimit me më tepër efikasitet. Ai fokusohet, por nuk ja arrin të jetë llogaridhënës sa duhet. Ai mund të jetë efikas për disa përpjekje problemzgjidhëse.

Policimi komunitar synon të bashkojë në një dhe të bëjë të funksionojnë së bashku të gjitha burimet e komunitetit në përpjekje të përbashkëta për mbajtjen nën kontroll të krimit. Policimi me ekipe mund të përmbajë përpjekje për tu konsultuar e bashkëpunuar me komunitetin, por ai nuk e arrin dot partnershipin me komunitetin. Kjo sepse nuk mund të përfshijë dot plotësisht të gjitha burimet krim-luftuese të komunitetit.

Filozofia ku bazohet policimi me ekipe është ajo kërkimit të ekspertizës policore në një marrëdhënie paternaliste me publikun. Policimi komunitar, nga ana tjetër, është i projektuar të realizojë dhe të mbajë krimin nën kontroll me anën e përpjekjeve bashkëvepruese.

1.1.13. Policimi komunitar - Policimi problemor

Diferenca midis policimit problemor dhe atij komunitar konsiston në rolin e publikut:

- a) Në policimin problemor është polici ai që përcakton problemet dhe përcakton strategjitë e zgjidhjes. Publiku shërben vetëm si burim informacioni ose si burim verifikimi për problemet që identifikon policia.
- b) Në policimin komunitar, policia përpiqet të verë në lëvizje grupet e qytetarëve ose ndërmerr hapa konkrete për përfshirjen e komunitetit në grupe të vullnetarëve që bashkëpunojnë me policinë për të identifikuar nevojat e problemet. Policia punon me ta për t'i zgjidhur dhe verifikuar eficientë e rezultateve. Grupet e qytetarëve të organizuar janë një prioritet i dukshëm për policimin komunitar. Kjo është premisa që një polica të kërkojë mjete të tjera për të vlerësuar veten për kontributin që jep në përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat e banuara dhe të mos krahasohet vetëm me statistikën e krimit.
- c) Një dallim tjetër midis tyre është se policimi problemor presupozon një theks më të madh mbi reformat në shërbimet e policisë kriminale dhe efikasitetin organizativ të tyre, kurse

policimi komunitar ka theks më të fortë në shërbimet e patrullimit, të zhdërvjellët, të kualifikuar dhe parandaluese.

Policimi komunitar është në fund të fundit një sistem vlerash dhe një ndryshim për të përshtatur policimin, si një nga veprimtaritë më të vjetra shoqërore, me kërkesat e reja të një epoke në ndryshim. Sistemi i vlerave etike të policimit demokratik duhet të rrënjosen në thelbin e kulturës organizative të policisë dhe duhet të zënë vendin kryesor në objektivat e saj, në linjat e përgjithëshme strategjike, në proritetet dhe në veprimet e personelit të policisë.

Besimet më të rëndësishme janë ato që qëndrojnë në themelet e misionit dhe qëllimeve të policisë. Ato e pajisin policinë e shtetit me arsyen e vet të egzistencës, si për ata jashtë edhe për ata brenda saj dhe me justifikimin për të kërkuar për investime dhe mbështetjen e nevojshme financiare për të përmbushur detyrat e veta ligjore. Vlerat influencojnë vendimet administrative dhe organike; ato forcojnë koherencën dhe parashikueshmërinë e veprimeve të drejtimit qëndror dhe të reagimit të punonjësve ndaj këtyre vendimeve. Për pasojë, vlerat ndihmojnë në marrjen e vendimeve dhe në veprimet e duhura nga punonjësit e të gjitha rangjeve në përputhje të plotë me atë që pritet prej tyre.

Menaxhimi i një organizate pa përcaktuar misionin dhe objektiva të qarta, paraqitet i penguar dhe i çoroditur, si një anija që lundron në oqean pa busull dhe pa destinacion. Për drejtuesit nuk ka një vizion të qartë se si t'i orientojë forcat e veta të punës, njerëzore, materjale dhe financiare për një një koordinim efektiv të këtyre burimeve. Misioni është stacioni i fundit ose qëllimi, që duhet arritur me përpjekjet e drejtuesve dhe të punonjësve të policisë.

Formulimi i qartë i misionit dhe i objektivave e pajis policinë me linja orientimi dhe ndihmon që vlerat të transformohen në veprime dhe sjellje të përshtatshme. Duke u zhvendosur drejt policimit komunitar, ku përpjekjet për të zgjidhur problemet ndahen midis policisë, qeverisjes vendore dhe komunitetit, përcaktimi i qartë dhe i sigurtë i vlerave merr një rëndësi të veçantë në transferimin e ndërsjelltë të përgjegjësive, në arritjen e mbështetjes dhe mobilizimin e burimeve të komunitetit. Policimi komunitar mbështetet fort në artikullimin e vlerave të policisë në atë mënyrë që të mishërojnë përfshirjen e qytetarëve në çështjet që prekin drejtpërdrejt sigurinë, qetësinë dhe jetën e tyre të përbashkët. Modeli kulturor i policisë për pasojë modifikohet që jo vetëm të pranojë vlerat dhe nevojën e përfshirjes së komunitetit, por ta manaxhojë dhe organizojë punën e policisë në mënyrë që ajo të jetë konsekuente dhe në përputhje me besime të tilla.

1.1.14. Parimet e Policimit Komunitar

- **Filozofi pune dhe strategji organizative**

Policimi komunitar është njëkohësisht filozofi (një mënyrë të menduari, një botkuptim) dhe një strategji organizative (një mënyrë për të vënë në jetë filozofinë), e cila u jep mundësi policisë dhe komunitetit të punojnë ngushtë së bashku për të vënë në veprim mënyra krijuese të zgjidhjes së problemeve të krimin, të drogës, të frikës dhe pasigurisë nga krimi, të çrregullimit ambjental dhe social (që nga zgaravitja nëpër mure deri tek grumbullimet dhe protestat e paligjshme), të prishjes së qetësisë nëpër lagje dhe më gjerë të problemeve të lidhura me cilësinë e përgjithëshme të jetës në bashkësi. Kjo

Objektivat e policisë

1. Qëllimet kryesore të policisë në një shoqëri demokratike të qeverisur nga Shteti Ligjor janë:
 - Të ruajë qetësinë publike, ligjin dhe rendin;
 - Të mbrojë e respektojë të liritë themelore të njeriut të sanksionuara, veçanërisht, në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut;
 - Të parandalojë dhe luftojë krimin;
 - Të zbulojë krimin;
 - Të kryejë funksionet e ndihmës dhe shërbimeve.

“Kodi Eurpian i Etikës së Policisë”.
Rekomandimi Rec (2001)

filozofi mbështetet tek besimi se njerëzit e meritojnë përfshirjen brenda proçeit të policimit, në këmbim të pjesmarrjes dhe mbështetjes që i japin policisë. Ajo, gjithashtu, bazohet në besimin se zgjidhjet e problemeve të sotme të komunitetit kërkojnë zhbllokimin e marrëdhënieve midis policisë dhe komunitetit, me qëllim që të gjejnë mënyra të reja e krijuese për të trajtuar e për t'iu drejtuar sëbashku shqetësimeve të qytetarëve, duke dalë përtej fokusit të ngushtë të luftës kundër ngjarjeve të veçuara kriminale.

- **Angazhim për të lejuar në praktikë përfshirjen e komunitetit**

Kërkesa e parë e strategjisë organizative të policimit komunitar është që çdo punonjës policie, i çdo rangu apo funksioni, të kërkojë mënyrat më të mira për ta përkthyer në praktikë të filozofisë të përpjestimit të përgjegjësive. Kjo ka të bëjë me bërjen e një ndryshimi dhe reforme të lehtë por të sofistikuar, që do t'i mundësonte kujtdo në komistariat të kuptonte nevojën për t'u përqëndruar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit në mënyrë krijuese dhe shpesh duke përfshirë në proçesin e policimit jo vetëm qytetarët e edukuar, por edhe ata për të cilët ka dyshime. Policimi komunitar nënkupton reformimin e komisariatit në mënyrë të atillë që lejon një autonomi më të madhe (më shumë liri për të vendosur me iniciativë) të punonjësve të policisë të terrenit, ç'ka do të thotë edhe më tepër respekt ndaj gjykimieve të tyre si ekspertë dhe profesionistë. Policimi komunitar influencon edhe brenda komunitetit, sepse kërkon që qytetarët të ndajnë midis tyre të drejtat dhe përgjegjësitë, sidomos në drejtim të identifikimit, prioriteteve dhe zgjidhjes së problemeve, si partnerë të institucionalizuar të policisë.

- **Policim i decentralizuar dhe i personalizuar**

Për ta vënë me të vërtetë në jetë policimin komunitar, njësitë vendore të policisë së shtetit duhet të krijojnë dhe të formojnë një tip të ri punonjësi policie të terrenit, i cili do të vepronte si një person i drejtpërdrejtë kontakti, midis policisë dhe komunitetit (një nga rrugët do të ishte rimodelimi i rolit të inspektorit të policisë së lagjes). Duke tejkaluar konceptin e punonjësit ekspert të policisë, që vepron brenda mureve të komisariatit, policimi komunitar synon të zbllokojë marrëdhëniet e izolimit të policisë dhe nxjerrjes së punonjësve të saj nga makinat apo nga vartësia e thirrjeve në radio, duke i shtyrë drejt mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët, të cilve u shërbejnë, në një territor kontrolli të përcaktuar qartë. Në fund të fundit, të gjithë punonjësit e policisë duhet të vënë në jetë këndvështrimin e policimit komunitar.

- **Problemzgjidhje proaktive e menjëherëshme dhe afatgjatë**

Roli i gjerë i punonjësve të policisë në policimin komunitar ka nevojë për kontakte të vazhdueshme dhe të qëndrueshme me qytetarët që respektojnë ligjin, për të studiuar në mënyrë krijuese zgjidhje të reja për shqetësimet që kanë. Si përfaqësues të zbatimit të ligjit, punonjësit e policisë, edhe brenda modeleve të policimit komunitar, kanë për detyrë të reagojnë, nëse kërkohet ndërhyrja e tyre apo të bëjnë shoqërime, ndalime dhe arrestime të personave që shkelin ligjin, por ata gjithashtu kanë detyrë ta kapërcejnë këtë fokus të ngushtë, duke përpunuar dhe mbykqyruar një iniciativë afatgjatë që lejon të gjithë përbërësit e komunitetit të marrin pjesë në përpjekjet e përbashkëta për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Si një "Avokat popull" në miniaturë, punonjësi i policimit komunitar, vepron si një hallkë lidhëse midis agjensive të tjera publike e private që mund të ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve konkrete.

- **Etika, ligjëshmëria, përgjegjshmëria dhe mirëbesimi**

Në thelb policimi komunitar nënkupton një marrëveshje të re midis policisë dhe qytetarëve të cilëve ajo u shërben, të atillë që ofron shpresa reale në kapërximin e apatisë dhe indiferentizmin qytetar dhe që kufizon çdo impuls emocional të vigjilentizmit personal dhe të vetgjqësisë. Kjo marrëdhënie e re, e bazuar mbi besimin dhe respektin e ndërsjelltë, nënkupton edhe marrjen e rolit të katalizatorit, për të nxitur dhe bindur qytetarët "kundërsharë" e të dyshuar që të pranojnë përgjegjësitë e tyre për përmirësimin e jetës në bashkësinë ku bëjnë pjesë, bashkë me familjet e tyre. Policimi komunitar nënkupton që të gjithë qytetarët duhet të merren më tepër për të zgjidhur

shqetësimet e tyre të vogla (duke u ndihmuar dhe këshilluar nga policia), Në shkëmbim të këtij angazhimi, policia do të jetë më e çliruar të merret me gjetjen e zgjidhjeve afatgjata dhe për problemet e përbashkëta më të rëndësishme për të gjithë, duke inkurajuar respektin dhe llogaridhënien e ndërsjelltë.

- **Zgjerim i mandatit të policisë**

Policimi komunitar, i shton rolin tradicional reagues të policisë, një element vital proaktiv, duke e shndëruar në një shërbim policor me spektër të gjerë. Si e vetmja agjensi e kontrollit social, që qëndron e hapur 24 orëve në ditë, gjatë shtatë ditëve të javës, policia duhet të mbajë vazhdimisht të freskët dhe në intesitetin e duhur aftësinë për të reaguar menjëherë dhe me energji ndaj situatave me kriza të rendit dhe ngjarjeve kriminale. Përpos këtij koncepti tradicional, policimi komunitar e zgjeron rolin e policisë në shoqëri, në mënyrë që ajo të ketë ndikim më të madh në bërjen sot të ndryshimeve në komunitet, që do të çojnë në mbajtjen e premtimit: për t'i bërë më të sigurta, më të qeta dhe më tërheqëse për të jetuar, nesër

- **Ndihma ndaj personave që janë në nevojë**

Policimi komunitar e vë theksin dukshëm tek studimi dhe gjetja e mënyrave të reja për të mbrojtur dhe përmirësuar jetën e personave që kanë nevojë për trajtim të veçantë dhe janë pa mbrojtje: të miturit, të rinjtë, gratë, të moshuarit, minoritetet, të varfërit, të paaftët, të pastrehët, refugjatët etj. Kjo nënvizon edhe përvetësimin, edhe zgjerimin e qëllimit të mëparshëm të parandalimit të krimit dhe të marrëdhënieve me komunitetin.

- **Shpirt krijues në praktikë dhe përkrahje**

Policimi komunitar ngre në shkallën më të lartë përdorimin e mençur të risive teknologjike. Ai bazohet mbi besimin se asgjë nuk mund të zëvendësojë rezultatet që arrijnë punonjësit e policisë të përkushtuar, kur bashkëbisedojnë dhe bashkëpunojnë sëbashku me qytatrat. Policimi komunitar e investon besimin e vet tek ata që shërbejnë në vijën e parë, duke u bazuar në kombinimin e aftësive vendimmarëse, maturisë profesionale, mënçurisë dhe përvojës së tyre, që i japin formë mënyrave të reja të zgjidhjes së shqetësimeve të qytetarëve.

- **Ndryshim brenda policisë**

Policimi komunitar duhet të bëhet një mënyrë të menduari dhe të vepruari tërësore, e cila përfshin këdo në një komisarjat, me punonjës policie të gjithanshëm, që janë të aftë mendërisht dhe teknikisht të ndërtojnë urat e bashkëpunimit mbi hendekun që ekziston mes policisë dhe qytatëve. Filozofia dhe strategjia e policimit komunitar luan rol të rëndësishëm edhe brenda policisë, nëpërmjet sjelljes tek ajo të informacionit real mbi ndërgjegjshmërinë e qytetarëve, mbi problemet që i shqetësojnë dhe përmes përkrahjes që i jep komuniteti policisë për arritjen e objektivave të përgjithëshme. Në momentin që policimi komunitar pranohet nga policia si një strategji afatgjatë, të gjithë duhet të mobilizohen ta vënë në praktikë. Puna e gjithanëshme për pranimin, ndërtimin dhe vënien në jetë të policimit komunitar, sikurse dëshmon përvoja e zbatuar, kërkon pak a shumë 10 ose 15 vjet.

- **Ndërtimi i së ardhmes së përbashkët me komunitetin**

Policimi komunitar nënkupton një shërbim policor të decentralizuar, të personalizuar sipas komuniteteve. Kjo filozofi nënkupton dhe përfshin si pjesë integrale konkluzionin se policia nuk mund ta imponojë nga jashtë rendin nëpër komunitete, por qytetarët duhet të inkurajohen dhe të edukohen të mendojnë se policia është një burim që ata mund ta përdorin në ndihmë të tyre për të zgjidhur problemet që i shqetësojnë si bashkësi. Ai nuk është një taktikë, e cila mund të zbatohet dhe pastaj të lihet mënjanë, por është një filozofi dhe një strategji e re që prodhon elasticitetin e nevojshëm për të plotësuar me efikasitet nevojat dhe përparësitë e komuniteteve, ndërkohë që ato ndryshojnë vazhdimisht, nga koha në kohë.

13. Si të aplikohet

Ndryshimet transformuese në kohën e sotme janë gjithmonë komplekse, afatgjata, plot sfida dhe kërkojnë drejtuesë policie krijuesë dhe me iniciative për të përshpejtuar e drejtuar përpjekjet e të tjerëve. Bazuar në eksperiencën, kalimi drejt policimit komunitar mund të jetë i suksesshëm vetëm kur manaxhohet mirë dhe me kujdesin e duhur.

Kur vizioni i policimit demokratik aplikohet siç duhet, përmirësimi i efikasitetit të mbajtjes nën kontroll dhe prarandalimi i krimit, dhe mbajtja e rendit publik, vijnë si rezultat i angazhimit në këtë problem të mekanizmave dhe instucioneve zyrtare të kontrollit social.

Mund të bëhet analogji me procesin e monitorimit nga ana e sistemeve elektronike të qarkullimit për automjetet. Një sistem orientimi efektiv ka një numur karakteristikash:

Së pari, ka një sistem drejtimi që përcakton pikën e nisjes dhe të mbërritjes të udhëtimit, me qëllim që të kalojmë nga pozicioni momental (*status quo* e policimit tradicional) në një destinacion të ri e të panjohur alternativ (policimi komunitar)

Së dyti, sistemi i drejtimit përcakton rrugët për të arritur në destinacion (zakonisht nuk ka një alternativë të vetme, që të tregojë se cila është rruga më e mirë).

Së treti, sistemi monitoron lëvizjen dhe siguron informacion deri në minutën e fundit, duke sugjeruar rrugë të tjera alternative për të kaluar.

Së katërti, sistemi i orientimit është i adaptueshëm për nevojat në ndryshim (ne mund të ndërrojmë mendje për të shkuar drejt një destinacioni tjetër ose të ndalojmë për t'u çlodhur diku, deri sa të vendosim: do të ecim në rrugën e nisur apo do të vazhdojmë një rrugë që e njohim?)

E rëndësishme është ndërtimi i një guide, që do të shërbejë si orientim për ndryshimin drejt policimit komunitar. Për të qenë sa më të frutshëm, na duhen vizione dhe qëllime të qarta për destinacionin, vullnet për të qenë elastik e të aftë për t'u përballur me sfidat që dalin gjatë rrugës.

Drejtimesit të policisë i duhen tri gjëra kryesore për ta ndërtuar këtë guidë.

- Kuptim i fazave që duhen kaluar për të realizuar ndryshimin organizativ
- Kuptim i elementëve që do të ndryshojnë drejt policimit komunitar.
- Njohje dhe evidentim i sfidave kryesore që përballemi në përpjekjet për ndryshim.

Policimi komunitar nis me ndryshimin dhe adaptimin e procedurave që aplikohen për të vënë në veprim metodat e reja të punës. Këto ndryshime kalojnë nëpër disa faza të përcaktuara.

Modeli i mëposhtëm shërben si një kornizë për përcaktimin e procesit të ndryshimit dhe për të ndihmuar orientimin në këtë proces.

Modeli përmban 6 faza:

Faza 1. Njohja e terrenit dhe problemeve- është hapi i parë i çdo përpjekje për ndryshim. Kjo është një nevojë që bazohet tek kurioziteti dhe kërkon të hetohet me intensitet çdo alternativë e mundëshme. Brenda kësaj faze ka tri komponentë:

- Interesi** është karburanti që ndez kureshtjen. Ai është pika e parë që identifikon një drejtues të suksesëshëm
- Vetdijshmëria** – marrja dijëni për numurin e varianteve të mundëshme dhe pajisja me informacion të bollshëm për të bërë zgjedhjen më të mirë.
- Marrja e vendimit**- përfundon fazën dhe kërkon të peshohet i gjithë informacioni i disponueshëm.

Faza 2. Përkushtimi-drejtuesi vendos të bëjë ndryshimin dhe ja paraqet organizates. Ky grup ben vleresimin e kostove dhe perfitimeve të ndjekjes së alternativës dhe merr vendime nëse do të vazhdohet ose jo. Kjo faze përfshin një para-planifikim, një pike të dytë të vendimarrjes dhe

njekohesisht percjell sensin e urgjences. Faza e paraplanifikimit eshte faze rigoroze ku grupi grumbullon nje informacion te qarte mbi perpjekjen per ndryshim (psh policimi komunitar).

Ndryshe nga faza e pare, grumbullimi i informacionit duhet te jete teper intensiv. Pastaj merret nje vendim formal per t'u perkushtuar ne procesin e ndryshimit. Me pas grupi hedh idete ne gjithe organizaten dhe fillon krijimi i momentit per perpjekjen per ndryshim. Organizates i jepet nje pershkrim baze i asaj ku konsiston ndryshimi per te ecur perpara.

Faza 3. Planifikimi-eshte nje perpjekje e gjere per te artikuluar qellimet e ndryshimit dhe përpunimin e nje strategjie per arritjen e objektivave. Ne kete proces duhet te perfaqesohen gjithe hallkat e organizates. Zakonisht krijohet nje grup drejtimi per pershpejtim. Ne planifikim futet dhe identifikimi i vizionit dhe qellimeve per organizaten, zhvillimi i treguesve te suksesit, hartimi i plan veprimeve dhe grumbullimi i te dhenave.

- a. **Misioni** duhet te jete nje pershkrim konciz i te ardhmes se organizates.
- b. **Qellimet** dhe objektivat, duhet të jenë të vështira por të realizueshme. Nga këto qëllime dhe objektivat, policia dhe punonjësit e saj do të përcaktojnë treguesit me të cilat do të matet puna dhe efikasiteti i tyre. Hap tjetër pas planifikimit është hartimi i planeve të veprimit. Në këtë fazë maten treguesit e suksesit para zbatimit të planeve (gjendja përpara), për ta krahasuar më pas me të dhënat që do të grumbullohen nga veprimet konkrete të studimit të ecursisë në praktikë.

Faza 4. Zbatimi i projektit është komponenti më i dukshëm i procesit të ndryshimit dhe përfshin venien në jetë të planeve të veprimit, fazë ndërmjetëse të shqyrtimit dhe analizës dhe riorganizimit e përpjekjes për ndryshim. Hapi i parë është zbatimi i plan-veprimeve. Gjate kesaj faze duhet mbajtur lart morali i grupeve të punës për të përblluar pengesat e hasura gjatë punës së bërë.

Faza 5. Monitorimi dhe rishqyrtimi - eshte sistemi formal per vleresimin e perpjekjes per ndryshim dhe rishikim i fazes se planifikimit ne procesin e ndryshimit.

Kjo fazë mat progresin e bërë, identifikon vështirësitë dhe dhe rishikon qëllimet dhe zhvillon plane të reja veprimi. Progresi matet me vlerësimin e treguesve të suksesit të matura para implementimit me qëllimet. Vështirësitë analizohen dhe kapërreh en permes një procesi të dyanshëm:

- a) Identifikimi i mangësive dhe diferencës midis qëllimeve dhe gjendjes aktuale.
- b) Identifikimi i shkaqeve të mangësive e pengesave. Kur konstatohet se ato shkaktohen nga pritje jorealiste, atëherë modifikohen dhe ndryshohen qëllimet.

Faza 6. Institucionalizimi është faza finale e procesit të ndryshimit dhe fillon kur procedurat, linjat e përgjithëshme të veprimit dhe sistemet që u shfaqën si rezultat i përpjekjeve të bëra për ndryshim, zëvendësojnë zyrtarisht mënyrat dhe metodat e vjetra të të menduarit dhe të veprimit.

Kjo fazë përfshin modifikime dhe reformimin e sistemeve, përvetësim dhe unifikim të sjelljeve të reja dhe pajisje me njohuritë e nevojëshme konceptuale. Zhevendosja drejt policimit komunitar ndodh nëse reformat në strukturë (*rolet, përgjegjësitë, besueshmëria, format e komunikimit*), manaxhimi i sistemeve operuese (*buxheti*) dhe përmirësimi i sistemit të burimeve njerëzore (*shpërblimet, përzgjedhja, trainimet*) janë të pranishme në përpjekjen për ndryshim. Unifikimi ndodh kur mendësitë dhe linjat e vjetra të vepimit, zëvendësohen me sisteme, mënyra të menduari të reja, që funksionojnë si procedura zyrtare standarde.

Modelet tradicionale të policimit fokusohen mbi drejtuesin si një komandues ekspert brenda një hierarkie organizative tepër të kontrolluar, kurse policimi komunitar kërkon nga drejtuesit të zhvendosen nga figura tradicionale e autokratit komandues, drejt një figure manaxheriale të gjithanëshme, që lejon hapësira më të mëdha zonash përgjigjësie, një pushtet më të gjerë të ekspertit dhe një theks të fortë të punës në grup.